

SIGURIA E GAZETAREVE NË INTERNET

Udhëzues burimesh #SOFJO

SIGURIA E GAZETAREVE NË INTERNET

Udhëzues burimesh #SOFJO

Autorë:	Dr. Silvia Chocarro Sarah Clarke Paulina Gutiérrez Judy Taing
Redaktor:	Kristin Olson
Zyrtar projekti:	Julia Haas
Rishikim nga kolegët:	Barbora Bukovska
Redaktorët e përmbytjes:	Elisabeth Witchel Ton van den Brandt Laura Vidal Sebastian Denton
Dizjener dhe artist:	Peno Mishoyan

Ky publikim është kontraktuar në vitin 2020 nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave. Ai është pjesë e projektit “Siguria e gazetareve në internet”, ose #SOFJO.

Pikëpamjet, gjetjet, interpretimet, rekomandimet dhe konkluzionet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë medoemos pozicionin zyrtar të OSBE-së dhe/ose Shteteve pjesëmarrëse të saj.

© 2020 Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Mediave të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Wallnerstrasse 6

A-1010 Vienna, Austria

Tel.: +43-1 514 36 68 00

E-mail: pm-fom@osce.org

<https://www.osce.org/fom/safety-female-journalists-online>

ISBN: 978-3-903128-98-9

SIGURIA E GAZETAREVE NË INTERNET

Udhëzues burimesh #SOFJO

Përmbajtja

Parathënie: Vlerësim i gjendjes aktuale dhe e ardhmja	5
Përmbledhje: Një qasje e përbashkët dhe 40 veprime të propozuara	11
Hyrje: Kërcënimi ndaj gjithsecilit kërkon veprim nga gjithsecili	25
Pasqyrë: Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që përcaktojnë sigurinë e gazetareve në internet	35
Shndërroji fjalët në vepër: Çfarë mund të bëjnë aktorët kryesorë	51
1. Dega ekzekutive e qeverisë: Zbatimi i politikave dhe praktikave për rritjen e sigurisë së gazetareve	57
2. Dega ekzekutive e qeverisë: Miratimi ose përshtatja e kornizave për një mjedis më të sigurt në internet dhe jashtë internetit	81
3. Gjyqësori: Sigurimi i qasjes në drejtësi dhe dhënia fund mosndëshkueshmërisë	95
4. Agjencitë e zbatimit të ligjit: Avancimi i metodave për mbrojtje dhe hetime efektive	111
5. Organizatat ndërqeveritare: Nga vendosja e standardeve deri te ndihma për Shtetet	127
6. Ndërmjetësit e internetit: Respektimi i të drejtave të gazetareve dhe promovimi i sigurisë në internet	143
7. Mediat: Mbrojtja e gazetarëve fillon në vendin e punës	163
8. Organizatat e gazetarëve dhe organet vetërregulluese: Organizimi i veprimit kolektiv dhe kodeve të sjelljes	181
9. Organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore: Mobilizimi, hulumtimi dhe ndarja e praktikave të mira	197
10. Gazetarët dhe punonjësit e medias: Prioritizimi i vetëmbrojtjes dhe mbështetjes nga kolegët	215
Mbi autorët	223
Shtojcë: Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve	225

Parathënie

Vlerësim i gjendjes
aktuale dhe e ardhmja

Parathënie

Vlerësim i gjendjes aktuale dhe e ardhmja

Në vitin 2015, e alarmuar nga numri në rritje i raportimeve për sulme në internet ndaj gazetarëve dhe punonjëseve gra të mediave, Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias (PLM) të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) filloi një diskutim mbi trajtimin e ngacmimeve në internet me bazë gjinore të gazetarëve. Këto biseda nxitën fillimin e projektit “Siguria e gazetarëve në internet”, ose #SOFJO.¹

Gjatë pesë viteve të para të projektit #SOFJO, PLM mbrojti diversitetin gjinor brenda gazetarisë në shumë mënyra. Në funksionin e tyre të paralajmërimit të hershëm, përfaqësues të njëpasnjëshëm u kushtuan vëmendje të veçantë grave gazetare. Ata promovuan perspektivat e gazetarëve me qëllim që t’i mbështesin Shtetet në zbatimin e zotimeve të tyre ndërkombëtare. Ky udhëzues burimesh përbën hapin e radhës, duke ndihmuar Shtetet në transformimin e zotimeve të tyre në praktikë.

› **Një vend i errët**

Gjatë vazhdës së projektit #SOFJO, Zyra e PLM-së, së bashku me aktorë të ndryshëm, ka zhvilluar iniciativa inovative dhe të qëndrueshme, përfshirë politika e rekomandime konkrete për të gjithë aktorët përkatës, përfshirë qeveritë, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile. Projekti u bë platformë e njohur për vetëdijësim, hartimin e strategjive kolektive dhe ndarjen e mjeteve e burimeve për gazetarët e synuara. Konferencat, takimet e mbyllura në grupe dhe fushata e komunikimit në media sociale #SOFJO ndihmuar për të krijuar një rrjet mbështetjeje në përbërje të qeverive, organizatave të medias, akademisë dhe aktorëve të shoqërisë civile nga të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Publikime të ndryshme, përfshirë këtu hulumtimin dhe rekomandimet e paraqitura në botimin e vitit 2016 “Luftimi i abuzimit të gazetareve në internet”², Komunikatën e vitit 2019 mbi pluralizmin e mediave, sigurinë e gazetareve dhe ruajtjen e zërave të marginalizuar në internet³, dhe botimin e vitit 2019 “Përgjigjet ligjore për ngacmimin dhe abuzimin e gazetareve në internet”⁴, bashkëprodhim i Institutit Ndërkombëtar të Shtypit (INSH), kanë rritur të kuptuarit e shoqërisë të shumë sfidave dhe rrugëve të mundshme përpara.

Zyra e PLM, në bashkëpunim me INSH, prodhoi një dokumentar me titull “Një vend i errët”.⁵ Gazetarët që janë cak i ngacmimeve dhe abuzimeve në internet mund ta gjejnë veten vërtetë në “vend shumë të errët”, siç ceket në film nga gazetarja e njohur Arzu Geybulla nga Azerbajxhani. Dokumentari ndan përvojat e gazetareve që kanë përjetuar ngacmime dhe abuzime të tilla në internet. Veç kësaj, juristët, menaxherët e mediave, specialistët

e teknologjisë dhe ekspertët gjinorë i përshkruajnë implikimet negative për diversitetin e mediave dhe rrezikun e vetëcensurës. Dokumentari është shfaqur dhe vazhdon të shfaqet publikisht në tërë rajonin e OSBE-së dhe më gjerë. Shfaqjet e filmit shpeshherë janë përcjellur me diskutime të fuqishme në panel në përpjekje për ta rritur ndërgjegjësimin dhe për të frymëzuar ndryshime.

Tani është koha për ta ndërmarrë hapin tjetër. Zyra e PLM e ka hartuar këtë udhëzues gjithëpërfshirës burimesh #SOFJO për t’u ndihmuar aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë me udhëzime për përmirësimin e sigurisë së gazetareve në internet. Ky udhëzues synon të plotësojë hendekun midis teorisë dhe realizimit të sigurisë në internet për gratë gazetare.



Praktikat e mira të paraqitura në këtë udhëzues janë shembuj të mënyrave në të cilat mund të realizohen standardet dhe zotimet ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve. Udhëzuesi i burimeve #SOFJO paraqet një qasje sistematike për aktorët qendrorë për krijimin e një mjedisi pozitiv për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve.

Ta shënojmë kohën në vijim me veprime kolektive ashtu që gratë gazetare të mund të punojnë pa frikë, pa ngacmim dhe pa dhunë. Është koha për vepra, jo fjalë.

Zyra e PLM u shpreh falënderime të thella të gjithë atyre që kontribuuan në këtë hulumtim, veçanërisht Silvia Chocarro, e cila ishte autore e tekstit së bashku me Sarah Clarke, Paulina Gutiérrez dhe Judy Taing. Në fund, dua të falënderoj stafin e Zyrës që kontriboi në redaktim dhe botim, në veçanti Kristin Olson, Julia Haas, Ton van den Brandt dhe Sebastian Denton.

29 tetor 2020



Jürgen Heissel,
*Drejtor, Zyra e Përfaqësuesit të
OSBE-së për Liri të Mediave*

Shënime fundore

- 1 Safety of Female Journalists Online (#SOFJO) project of the Office of the OSCE RFoM, <https://www.osce.org/fom/sofjo>.
- 2 “New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists”, OSCE RFoM, 17 September 2015, <https://www.osce.org/files/f/documents/4/1/193556.pdf>.
- 3 OSCE RFoM, Communiqué No. 1/2019, “Media Pluralism, Safety of Female Journalists and Safeguarding Marginalized Voices Online”, 29 February 2019, <https://www.osce.org/files/2019-02-21%20SOFJO%20Communique.pdf>.
- 4 Scott Griffen (ed.), “Legal Responses to Online Harassment and Abuse of Journalists: Perspectives from Finland, France and Ireland”, OSCE RFoM and IPI, 7 March 2019, <https://www.osce.org/files/f/documents/8/9/413549.pdf>.
- 5 OSCE RFoM, ‘A Dark Place: A SOFJO Documentary’ Trailer, 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/410423>.

Përmbledhje

Një qasje e përbashkët dhe
40 veprime të propozuara

Përmbledhje

Një qasje e përbashkët dhe 40 veprime të propozuara


Siguria e gazetareve në internet ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e demokracive tona dhe në të drejtën e shoqërisë për të pasur pluralitet informacioni. Ky udhëzues burimesh #SOFJO ofron përgjigje për hendeqet që ekzistojnë në adresimin e sigurisë së gazetareve në internet.

Në vijimësi të punës në kuadër të projektit #SOFJO nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave, ky udhëzues burimesh synon t'u ndihmojë Shteteve dhe t'u sigurojë udhëzime gjithë aktorëve përkatës, përfshirë aktorët joshitetërorë, në të gjithë rajonin e OSBE-së, që t'i adresojnë ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj gazetareve.

Pas një prezantimi të shkurtër të problemit dhe listimit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që mbështesin sigurinë e gazetareve në internet, janë propozuar të zbatohen 40 veprime me një qasje të përbashkët. Këto veprime të propozuara janë shoqëruar me shembuj dhe burime përkatëse.

› Një qasje e përbashkët e përgjegjshme gjinore

Të gjitha veprimet e propozuara në udhëzuesin e burimeve #SOFJO duhet të zbatohen me qasje të përgjegjshme gjinore. Kjo përfshin: pikënisje me të kuptuarit e kushteve të ndryshme që ndikojnë në punën dhe jetën e burave dhe grave nga radhët e grupeve të ndryshme në shoqëri; përpilim aktiv të të dhënave dhe informatave të zbërthyer; sigurim të proceseve me pjesëmarrje dhe me shumë aktorë; punët e nevojshme të kenë burime të duhura, planifikim dhe vlerësim; si dhe të sigurohet që masat që synojnë mbrojtjen e gazetareve të mos i cenojnë të drejtat e tyre themelore.



Dega ekzekutive e qeverisjes

Zbatimi i politikave dhe praktikave për rritjen e sigurisë së gazetareve

Veprimet e propozuara

1. Të hartohet një plan kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve që adreson kushtet specifike për gazetaret;
2. Të aplikohen masa mbrojtëse të përgjegjshme gjinore;
3. Të mblidhen të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve për t'i informuar politikat dhe hulumtimet, si dhe për t'i mbështetur fushatat e ndërgjegjësimit që synojnë angazhimin e vendimmarrësve dhe opinionit publik;
4. Të raportohet për sigurinë e gazetarëve tek mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe të integrohet kjo çështje në politikën e jashtme.




Dega legislative e qeverisjes

Të miratohen ose përshtaten kornizat për një mjedis më të sigurt në internet dhe jashtë tij

Veprimet e propozuara

1. Të rishikohen dhe, po të jetë e nevojshme, të plotësohen e ndryshohen ose të miratohen ligje për të promovuar një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve;
2. Të sigurohet se legjislacioni që adreson ngacmimin dhe abuzimin në internet ndaj gazetarëve të mos minojë të drejtën për lirinë e shprehjes.




Gjyqësori

Sigurimi i qasjes në drejtësi dhe dhënia fund pandëshkueshmërisë

Veprimet e propozuara

1. Të ketë vetëdijesim për çështjet gjinore në të gjithë sistemin gjyqësor,
2. meqë kjo është thelbësore për mbrojtjen e gazetareve;
3. Të rritet ekspertiza e personelit gjyqësor për çështjet e lirisë së shprehjes, sigurisë së gazetarëve dhe ngacimit e abuzimit në internet dhe jashtë tij;
4. Të zbatohen dhe promovohen praktikat më të mira në qasjen në drejtësi, dënime dhe mjete juridike;
5. Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut të angazhohen në çështjen e sigurisë së gazetarëve.



Agjencitë e zbatimit të ligjit

Përmirësimi i metodave për mbrojtje dhe hetime efektive

Veprimet e propozuara

1. Të avancohet trajnimi i autoriteteve ligjzbatuese lidhur me çështjet e sigurisë së gazetarëve në internet me një qasje të përgjegjshme gjinore;
2. Të rishikohet dhe përmirësohet trajtimi i çështjeve gjinore në vlerësimet e rrezikshmërisë për kërcënime e ngacmime;
3. Të përforcohen protokollat, metodat dhe procedurat e hetimit të krimeve ndaj gazetarëve dhe lirisë së shprehjes;
4. Të avancohet dialogu dhe bashkërendimi për sigurinë e gazetarëve midis autoriteteve të zbatimit të ligjit, mediave dhe shoqërisë civile.




Organizatat ndërqeveritare

Nga vendosja e standardeve deri te ndihma për Shtetet

Veprimet e propozuara

1. Të integrohen qasjet me ndjeshmëri gjinore brenda standardeve dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut lidhur me sigurinë e gazetarëve;
2. Mbështetje për Shtetet në adresimin e mangësive në zbatim të standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve;
3. Ndihmë në rritjen e të dhënave dhe hulumtimeve që të shërbejnë si bazë për nismat për sigurinë e gazetarëve në internet;
4. T'i jepet përparësi bashkëpunimit dhe bashkërendimit të palëve për të shtresuar ndikimin e duhur.



Ndërmjetësit në internet

Respektimi i të drejtave të gazetareve dhe promovimi i sigurisë në internet

Veprimet e propozuara

1. Të respektohen standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për lirinë e shprehjes, privatësinë, pjesëmarrjen dhe mosdiskriminimin në politikë dhe praktikë;
2. Të sigurohet që politikat për redaktimin e përmbajtjeve të jenë të qarta, transparente dhe të qasshme për përdoruesit, si dhe që përdoruesit të jenë të vetëdijshëm për mënyrën se si redaktohet përmbajtja, çfarë përbën ngacmim dhe abuzim në internet, si dhe si ta raportojnë atë;
3. Të zbatohen qasje të përqendruara tek përdoruesit, si dhe pa bazë në diskriminim, në të gjitha veprimtaritë;
4. Të trajtohet largimi i përmbajtjeve dhe kërkesat e përdoruesve për të dhëna me transparencë dhe konsistencë;
5. Të promovohet roli i grave në gazetari.



Mediat

Mbrojtja e gazetarëve fillon
që në vendin e punës

Veprimet e propozuara

1. Të përmirësohet kultura e vendit të punës me politika gjithëpërfshirëse si për sigurinë edhe për gjininë;
2. Të sigurohet mbështetje dhe trajnim për gazetarët të cilët përballen me ngacmime dhe abuzime në internet;
3. Të hartohen udhëzime për komunitete të përgjegjshme ndaj gjinisë për platforma interaktive në internet;
4. Të monitorohet dhe dokumentohet abuzimi dhe ngacmimi në internet i gazetarëve, përfshirë profesionistët e pavarur;



Organizatat e gazetarëve dhe organet vetërregulluese

Organizimi i veprimit kolektiv dhe kodeve të sjelljes

Veprimet e propozuara

1. Të shtohen veprimet dhe avokimi kolektiv për të përmirësuar sigurinë dhe kushtet e tjera të punës për gazetaret;
2. Të konsolidohen kapacitetet përmes rrjeteve mes kolegëve, trajnimeve dhe mbështetjes tjetër praktike;
3. Të dokumentohen sulmet dhe informatat të përdoren për ndërgjegjësimin e aktorëve kryesorë;
4. Të promovohet përfshirja e çështjeve të sigurisë dhe barazisë gjinore në punën e organeve vetërregulluese.



Organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore

Mobilizimi, hulumtimi dhe ndarja e praktikave të mira

Veprimet e propozuara

1. Të shtohen të dhënat, njohuritë dhe vetëdijesimi i aktorëve kyçë dhe shoqërisë në përgjithësi mbi ngacmimin dhe abuzimin me bazë gjinore në internet;
2. Të bashkohen forcat për të avancuar zbatimin e standardeve të sigurisë dhe kushteve të tjera të punës për gazetaret në nivel kombëtar;
3. Të zhvillohen trajnime dhe materiale edukuese për mbrojtje gjithpërfshirëse;
4. Të integrohet siguria e gazetarëve dhe barazisë gjinore në aktivitetet e edukimit dhe trajnimit për gazetari.



Gazetarët dhe punonjësit e mediave

Prioritizimi i vetëmbrojtjes dhe mbështetjes nga kolegët

Veprimet e propozuara

1. Të monitorohet dhe vlerësohet peizazhi i rrezikut për gazetaret;
2. Të praktikohet një qasje gjithpërfshirëse ndaj sigurisë, duke përfshirë sigurinë fizike, ligjore, psikosociale dhe atë digjitale;
3. Të dokumentohen dhe raportohen kërcënimet dhe sulmet;
4. Të mbështeten kolegët që përballen me abuzime dhe ngacmime në internet, dhe ata që janë në rrezik më të lartë të përjetojnë sulme të tilla;
5. Informim më i madh mbi format e mundshme të mbështetjes, përfshirë mekanizmat ligjorë.

DEGA LEGJISLATIVE
E QEVERISJES



DEGA EKZEKUTIVE E
QEVERISJES



GJYQËSORI




MEDIAT



AGJENCITË E
ZBATIMIT TË LIGJIT

#SOFJO



NDËRMJETËSIT
E INTERNETIT



ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE
DHE INSTITUCIONET ARSIMORE

GAZETARËT DHE
PUNONJËSIT E
MEDIAS



ORGANIZATAT E
GAZETARËVE DHE
ORGANET VETËR-
REGULLUESE



ORGANIZATAT
NDËRQEVERTARE

Hyrje

Hyrje

Kërcënimi ndaj gjithsecilit kërkon veprim nga gjithsecili

“Sonte, ata do të të përdhunojnë”.

“A nuk ka ndonjë shok trim që t’ia shuajë zjarrin kësaj kurve të zjarrtë?”

“A e di dikush në ç’ vend jeton ajo ose cilat vende i viziton rregullisht?”

“Jam ty mendu me te **, si paralajmërim për tjerat.”¹

Këta janë vetëm ca shembuj të postimeve në media sociale që u janë drejtuar gazetares², e që për fat të keq dhe alarmant nuk janë raste të izoluar. Gjashtëdhjetë e tre për qind e gazetares janë kërcënuar ose ngacmuar në ndonjë moment në internet vetëm sepse kanë bërë punën e tyre.³ Sipas një sondazhi të realizuar nga “The Guardian”, gratë gazetare kanë katër herë më shumë të ngjarë të përjetojnë këso lloj sulmesh sesa kolegët e tyre burra.⁴

Për shumicën e gazetares në mbarë botën, ngacmimi dhe abuzimi në internet është shndërruar në rrezik të madh profesional, kërcënim për aftësinë e tyre që ta bëjnë punën e tyre, duke shkelur kështu të drejtën e tyre për liri të shprehjes dhe duke penguar qasjen e lirë dhe të hapur në informacion të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë. “Kam menduar që t’i mbyll tërësisht llogaritë në mediat sociale”, thotë redaktorja politike e BBC, Laura Kuenssberg, në dokumentarin “Një vend i errët” të realizuar nga Përfaqësuesi për Lirinë e Medias (PLM) në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Shtypit, “por pastaj, ata që mbesin atje, që dëshirojnë informacion, gjë që është gjëja më e rëndësishme për mua, atëherë ata humbin, dhe pastaj edhe unë humbas.”

Të gjithë gazetarët anembanë globit po përballen me një rritje të kërcënimeve dhe dhunës si rezultat i punës së tyre.⁵ Shumë shpesh, çmimi i raportimit të së vërtetës vjen në formë të kërcënimeve, përcjelljes, sulmeve, arrestimeve e ndalimeve arbitrare dhe, në rastet më të rënda, zhdukjes me forcë ose vrasjes. Qeveritë dhe aktorët e tjerë të fuqishëm vazhdojnë t'i heshtin ata që u kërkojnë llogari, në një përpjekje për t'i shpëtuar vëzhgimit dhe për ta shtypur disidencën.⁶

Gratë gazetare përballen me rrezik të shtuar, veçanërisht për shkak të gjinisë së tyre. Askund nuk është kjo më e qartë dhe e dukshme sesa në ngacmimet dhe abuzimet me bazë gjinore në internet. Manifestimet e ngacmimit dhe abuzimit në internet ndryshojnë, nga kërcënime të drejtpërdrejta ose të tërthorta me dhunë fizike ose seksuale, mesazhe fyese dhe ngacmime të targetuara (shpeshherë në formë të “grumbullimit”, pra, ku shumë kryerës koordinohen kundër një individi), deri te shkeljet e privatësisë (si ndjekja, ndarja jokonsensuale e imazheve intime dhe “doksing”, që është publikimi i informacionit privat, si adresa e shtëpisë së personit).⁷ Secila prej tyre mund të jetë e përcaktuar ndryshe në legjislacionin vendor ose në rekomandimet e organeve rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Aktorë të tjerë në këtë fushë, siç janë kompanitë e mediave sociale dhe akademikët, kanë gjithashtu prodhuar leksikun e tyre për ta konceptuar këtë dukuri.⁸ Përderisa nuk ka terminologji të dakorduar universalisht, ky udhëzues burimesh përdorë termin “ngacmim dhe abuzim në internet” si term i përgjithshëm për të mbuluar llojet e sjelljeve të përshkruara më lart.

Ndonëse në shënjestër të ngacmimeve dhe abuzimeve në internet janë si burrat ashtu dhe gratë gazetare, forma dhe shpeshësia e sulmeve me të cilat përballen gratë janë veçanërisht shqetësuese,⁹ duke shtyrë shumë gra gazetare që ta kufizojnë punën e tyre ose ta mendojnë largimin nga profesioni. Sipas një studimi global, rreth 40 për qind e grave gazetare

kanë deklaruar të kenë shmangur raportimin e artikujve të caktuar si rezultat i ngacmimeve në internet.¹⁰ Dhuna ndaj grave gazetare nuk ndodh në vakum, porse është e ndërlidhur qenësisht me mënyrën se si gratë nënshtrohen në shoqëritë patriarkale dhe me faktorët shoqëruar që minojnë barazinë gjinore, siç janë hendeqet e pagave, përjashtimi nga proceset e vendimmarrjes, si dhe barra edhe më e madhe e kujdesit familjar të papaguar. Shpesh, gazetaret bëhen cak i sulmeve kur kanë vizibilitet të madh dhe flasin haptas në punën e tyre, veçanërisht kur sfidojnë normat gjinore dhe stereotipat gjinorë.¹¹ Gratë gazetare përballen me sulme jo vetëm nga ata që përpiqen t'i heshtin raportimet e tyre, por edhe nga burimet dhe kolegët, madje edhe nga anëtarët e familjes. Në shumë raste, ato nuk janë të sigurta madje as në hapësirat ku do duhej të ishin të mbrojtura, siç janë redaksitë e tyre.¹²

Është e qartë se lloji i kërcënimeve dhe sulmeve me të cilat përballen gazetarët dhe ndikimi që kanë këto kërcënime dhe sulme janë shpeshherë të lidhur me dhe ndryshojnë në varësi të gjinisë dhe faktorëve të tjerë, si raca dhe etnia, feja ose besimi, orientimi seksual, moshja dhe grupi social.¹³ Faktorët rëndues janë puna si profesionist i pavarur,¹⁴ ose mbulimi i temave që janë treguar të jenë më të rrezikshme, si korrupsioni,¹⁵ krimi i organizuar,¹⁶ çështjet mjedisore,¹⁷ të drejtat e njeriut dhe, në veçanti, të drejtat e grave, për të mos përmendur rreziqet në mbulimin e situatave të konfliktit.¹⁸ Kuptimi i këtyre dallimeve dhe mënyrës se si gazetarët që u përkasin grupeve të ndryshme mund t'i përjetojnë kërcënimet e caktuara ndryshe nga kolegët e tyre është thelbësor për zhvillimin e masave gjithëpërfshirëse e të krijuara enkas për të parandaluar, mbrojtur dhe korrigjuar sulmet kundër gazetarëve. Fatkeqësisht, shumë ligje, politika publike dhe masa të tjera të miratuara nga Shtetet nuk e kanë këtë dimension gjinor dhe ndërsektorial.

› **Qasje e përgjegjshme gjinore, multisektoriale, për sigurinë e gazetareve në internet**

Qëllimi i këtij udhëzuesi burimesh #SOFJO është që t'u përgjigjet drejtpërsëdrejti hendeqeve që ekzistojnë në adresimin e sigurisë së gazetareve në internet. Gjatë dekadës së fundit, ka pasur progres premtues në mesin e aktorëve të ndryshëm në kuptimin dhe integrimin e qasjeve gjinore në përpjekjet për të promovuar sigurinë e gazetarëve. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut gjithnjë e më shumë kërkojnë një qasje të përgjegjshme gjinore për sigurinë e gazetarëve dhe tani ka më shumë hulumtime mbi çështjen e sulmeve ndaj gazetareve, përfshirë ngacmimet dhe abuzimet me të cilat ato përballen gjithnjë e më shumë në internet. Në nivel kombëtar, mund të shihet se mediat dhe grupet e shoqërisë civile po investojnë më shumë energji në zhvillimin e mjeteve dhe programeve për gazetaret që të adresojnë dhe parandalojnë ngacmimet dhe abuzimet me bazë gjinore në internet.

Sidoqoftë, nevojitet angazhim edhe më i madh. Trajtimi i ngacmimeve dhe abuzimeve me bazë gjinore në internet, si dhe i çështjes së dhunës ndaj gazetareve në përgjithësi, duhet të përfshijë fushata ndërgjegjësimi publik për përmirësimin e normave shoqërore dhe barazisë në vendin e punës, duke siguruar gjithashtu që zëri i grave të dëgjohet më shumë në të gjitha mediat, veçanërisht në çështjet që kryesisht iu atribuohen burrave, siç është politika. Nevojitet një qasje multisektoriale që angazhon degë të ndryshme të qeverisë, organe ndërkombëtare dhe rajonale, mediat, ndërmjetës të internetit dhe aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile. Është me rëndësi që gazetaret, përfshirë ato që kanë përjetuar sulme në internet, të angazhohen në zhvillimin e qasjeve dhe zgjidhjeve për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj gazetareve. Natyrisht, çdo mbështetje e ofruar për gazetaret duhet të vijë me pëlqimin e tyre të qartë.

Ky udhëzues burimesh mëton të identifikojë rrugën konkrete për aktorë të ndryshëm në forcimin e sigurisë së grave gazetare në internet duke aplikuar një perspektivë gjithëpërfshirëse. Udhëzuesi përmban dhjetë kapituj, secili kushtuar një akteri të veçantë. Secili kapitull paraqet një sërë veprimesh të propozuara për masat për adresimin e ngacmimit dhe abuzimit me bazë gjinore në internet, vijuar me shembuj të masave ekzistuese dhe një listë të burimeve të dobishme.

Ky udhëzues burimesh nuk mëton të jetë studim shterues i tërë punës në këtë çështje, si dhe nuk liston të gjithë hapat specifike që duhet të ndërmerren. Qëllimi i tij është të mbështesë aftësinë e aktorëve në identifikimin e hendeqeve të tyre dhe të ofrojë informata plotësuese që mund të mbështesin krijimin ose përmirësimin e mjeteve ose nismave për trajtimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj grave gazetare.

Për aktorët shtetërorë, ky udhëzues burimesh paraqet hapat dhe konsideratat që ekzekutivi, legjislativi, gjyqësori dhe agjencitë e zbatimit të ligjit mund t'i ndërmarrin. Këto veprime të propozuara përfshijnë rishikime dhe reforma legjislative, hartimin e planeve kombëtare të veprimit dhe ndërtimin e dialogut. Udhëzuesi gjithashtu propozon masa për integrimin e qasjes së përgjegjshme gjinore në të gjitha institucionet shtetërore, organet hetuese dhe mekanizmat për siguri të gazetarëve, si dhe ngritjen e programeve të ndërtimit të kapaciteteve për nëpunësit civilë. Nga pesë kapitujt e parë që mbulojnë aktorët shtetërorë, njëri shpalosë rolin e organeve ndërqeveritare duke nënvizuar qasjet për përmirësimin e standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe zbatimin efektiv të tyre në nivel kombëtar.

Ky udhëzues burimesh vijon me pesë kapituj të tjerë që mbulojnë veprimet e rekomanduara për aktorët joshtetërorë: ndërmjetësit e internetit; mediat; organizatat dhe aktorët e gazetarëve me rol kyç në vetërregullimin e

pavarur; organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore; si dhe gazetarët individualë dhe punonjësit e medias. Masat e rekomanduara përfshijnë: rritjen e kapaciteteve përmes trajnimit në mjete digjitale dhe njohuri juridike; zhvillimin e rrjeteve për mbështetjen e kolegëve dhe burimeve të tjera psikosociale; fuqizimin e vlerësimeve të rrezikut dhe protokolleve për raportimin dhe përgjigjen ndaj ngacmimeve në internet; realizimin e fushatave ndërgjegjësuese; dhe avokimin për barazi në vend të punës. Pjesa dedikuar aktorëve joshtetërorë përcakton gjithashtu mënyrat me të cilat aktorë të ndryshëm mund të përmirësojnë dokumentimin e përgjegjshëm gjinor të sulmeve në internet. Nxitja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit midis aktorëve është rekomandim i përgjithshëm.

Ky udhëzues burimesh përmban një kapitull mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që zbatohen për sigurinë e grave gazetare. Është e rëndësishme që në adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve me bazë gjinore të respektohen të drejtat themelore të njeriut për lirinë e shprehjes dhe privatësisë.

Fatkeqësisht, nuk ka asgjë virtuale të ngacmimit dhe abuzimit ndaj grave gazetare në internet. Ai është problem real që kërkon zgjidhje reale.

Shënime fundore

- 1 Quotes from the documentary “A Dark Place”, produced by the OSCE RFoM, in co-operation with the IPI. For the trailer, see <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/410423>.
- 2 Inclusive of all journalists who identify as women. “Female journalists” and “women journalists” are used interchangeably.
- 3 Michelle Ferrier, Attacks and Harassment The Impact on Female Journalists and Their Reporting, International Women’s Media Foundation, TrollBusters, Washington, 2018 <https://www.iwmf.org/wp-content/uploads/2018/09/Attacks-and-Harassment.pdf>.
- 4 Becky Gardiner et al., “The dark side of Guardian comments”, The Guardian, 12 April 2016, <https://www.theguardian.com/technology/2016/apr/12/the-dark-side-of-guardian-comments>.
- 5 ARTICLE 19, Global Expression Report 2018/19, London, 2019, <https://www.article19.org/xpa-2019/>.
- 6 Ibid
- 7 ARTICLE 19 and ILGA Europe, “Third Party intervention submission in the European Court for Human Rights, Andrea Giuliano and Hungary, App. No. 45305/16”, 2 March 2020, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2020/03/Guiliano-v-Hungary-Submission-2-March-2.pdf>.
- 8 Ibid
- 9 APC, “Online gender-based violence: A submission from the APC to the UN Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences”, 2017, https://www.apc.org/sites/default/files/APCSubmission_UNSR_VAW_GBV_o_o.pdf.
- 10 Op. cit. endnote 3.
- 11 UN General Assembly, Human Rights Council, Report by the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences, “Combating violence against women journalists”, A/HRC/44/52, 2020, <https://undocs.org/en/A/HRC/44/52>.
- 12 Barbara Trionfi and Javier Luque Martinez, “Newsroom Best Practices for Addressing Online Violence against Journalists: Perspectives from Finland, Germany, Poland, Spain and the United Kingdom”, IPI, in co-operation with the OSCE RFoM, June 2019, <https://newsrooms-ontheline.ipi.media/wp-content/uploads/2019/06/IPI-report-online-harassment-06032019.pdf>. Silvia Chocarro, The safety of women journalists: Breaking the cycle of silence and violence. IMS Defending Journalism book series, International Media Support, 2019, <https://www.mediasupport.org/publication/the-safety-of-women-journalists/>.
- 13 Amnesty International, “Toxic Twitter - A toxic place for women”, 2018, <https://www.amnesty.org/en/latest/research/2018/03/online-violence-against-women-chapter-1/#topanchor>.
- 14 Committee to Protect Journalists, “The Best Defense: Threats to journalists’ safety demand fresh approach”, 2017, <https://cpj.org/reports/2017/02/best-defense-threats-safety-journalists-freelance-emergencies-attack-digital/>.
- 15 Transparency International, “The High Costs Journalists Pay When Reporting on Corruption”, 2020, <https://www.transparency.org/en/news/the-high-costs-journalists-pay-when-reporting-on-corruption#>.
- 16 Reporters Without Borders, “Journalists: the bête noire of organized crime”, 2018, https://rsf.org/sites/default/files/en_rapport_mafia_web_o.pdf.
- 17 Reporters Without Borders, “Hostile climate for environmental journalists”, 2015, https://rsf.org/sites/default/files/rapport_environnement_en.pdf.
- 18 Reporters Without Borders, “Women’s rights: forbidden subject”, 2018, https://rsf.org/sites/default/files/womens_rights-forbidden_subject.pdf.

Pasqyrë

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që përcaktojnë sigurinë e gazetareve në internet

Pasqyrë

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që përcaktojnë sigurinë e gazetarëve në internet

Demokracia varet nga aftësia e gazetarëve për ta thënë të vërtetën lirshëm, në mënyrë të barabartë dhe të sigurt, për të bërë hulumtime të abuzimeve dhe korrupsionit, për të kontribuar dhe forcuar debatin dhe dialogun publik, dhe për t'u siguruar njerëzve informacion. Megjithatë, mjedisi i duhur që gazetarët ta luajnë këtë rol vendimtar në shoqëri është duke degraduar kudo në botë, përfshirë në rajonin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Format direkte dhe indirekte të heshtjes së personave janë në rritje, duke përfshirë ngacmimet, kërcënimet dhe dhunën fizike, ligjore, psikologjike dhe në internet.¹ Ky trend mund të ndryshohet vetëm nëse kuadri i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut shndërrohet në politika efektive publike. Meqë gazetarët burra dhe gra vihen në shënjestër dhe ndikohen ndryshe nga dhuna, dhe meqë mënyra se si duhet të trajtohet kjo ndryshon varësisht nga gjinia dhe format e tjera të faktorëve ndërlidhës, është e nevojshme një perspektivë gjinore.

Ky kapitull paraqet shkurtimisht standardet më të rëndësishme ndërkombëtare për lirinë e shprehjes, barazinë dhe mosdiskriminimin ndaj grave dhe për sigurinë e gazetarëve, të cilat duhet të mbështesin politikën dhe praktikën për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve me bazë gjinore.²

› E drejta për liri të shprehjes nuk duhet të jetë viktimë e radhës e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet

Ngacmimi dhe abuzimi në internet minon të drejtën për liri të shprehjes së gazetarit në shënjestër - i cili mund të shtyhet në vetëcensurë si pasojë e shqetësimeve për siguri ose atyre psikologjike - si dhe të

gazetarëve të tjerë, të cilët mund të frikësohen dhe shqetësohen nga hakmarrjet në internet si pasojë e raportimit të tyre. Duke qenë se kjo ndikon negativisht në të drejtën e tërës shoqërisë për qasje në pikëpamje dhe informata të ndryshme, nevojiten masa efektive për t'i luftuar ngacmimet dhe abuzimet në internet. Megjithatë, në të njëjtën kohë, këto masa duhet të ndërmerren duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, për të shmangur shkeljet e mëtejshme të këtyre të drejtave.

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut garantojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, si neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtat e Njeriut,³ dhe neni 19 i [Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike \(PNDKP\)](#).⁴ Traktatet rajonale për të drejtat e njeriut, si [Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#),⁵ gjithashtu artikulojnë këtë të drejtë.

Fusha e së drejtës për liri të shprehjes është e gjerë dhe ka të bëjë me shoqërinë në tërësi. Ajo kërkon që Shtetet t'u garantojnë të gjithëve lirinë për të kërkuar, pranuar dhe dhënë informacion ose ide të çfarëdolloji, pavarësisht kufijve, dhe përmes cilësdo media të përzgjedhur.

Është me rëndësi që Komiteti për të drejtat e njeriut i Kombeve të Bashkuara (KDNJ i OKB), organ në përbërje të ekspertëve të pavarur i ngritur për të monitoruar zbatimin e PNDKP nga shtetet palë, ka pranuar që mbrojtja e lirisë së shprehjes në PNDKP përfshin të gjitha format e mënyrat e të shprehurit elektronik dhe në internet.⁶ Çdo kufizim në format e komunikimit ose të shprehurit të shpërndarë në internet duhet të justifikohet sipas të të njëjtave kritere sikur komunikimet joelektronike ose jashtë internetit, siç përcaktohet më poshtë.⁷

› Ligjshmëria, legjitimiteti, domosdoshmëria dhe proporcionaliteti: Testi trepjesësh për kufizimin e lirisë së shprehjes

Sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, kufizimet e lirisë së shprehjes janë të lejueshme vetëm nëse e kalojnë atë që njihet si testi trepjesësh i ligjshmërisë, legjitimitetit, dhe domosdoshmërisë e proporcionalitetit të përshkruar në nenin 19.3 të PNDCP.⁸

Pjesa e parë e testit, ligjshmëria, i referohet faktit që **kufizimet në lirinë e shprehjes duhet të përcaktohen me ligj**. Këto ligje ose rregullore duhet të jenë të qasshme për publikun dhe të formulohen me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme ashtu që të japin udhëzime të mjaftueshme për ata që janë të ngarkuar me ekzekutimin e tyre, dhe t'u mundësojnë atyre të konstatojnë se cilat shprehje janë të kufizuara dhe cilat jo, për të parandaluar abuzime ose keqpërdorime nga autoritetet.

Kriteri i dytë që duhet të plotësohet nga Shtetet është që **kufizimet në liri të shprehjes duhet t'i shërbejnë një qëllimi legjitim**, i cili, sipas nenit 19.3 të PNDCP, përfshin respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve, ose mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik, shëndetit publik, ose moralit.

Në fund, çdo **kufizim i lirisë së shprehjes duhet të jetë i domosdoshëm dhe proporcional me qëllimin e ndjekur në një shoqëri demokratike**, në veçanti duke vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme midis shprehjes dhe kërcënimit.

Në nenin 20.2, PNDCP përcakton që çdo avokim i urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë duhet të ndalohet me ligj. Në shqyrtimin e tij të vitit 2011 të nenit 19,

Komiteti për të Drejtat e Njeriut i i Kombeve të Bashkuara (KDNJ i OKB) deklaroi se kufizimet sipas nenit 20 të PNDKP duhet gjithashtu të jenë në përputhje me testin tri pjesësh të përcaktuar me nenin 19.3 të PNDKP.⁹

Prandaj, çdo përpjekje për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj gazetareve e që aplikon kufizim direkt ose indirekt të së drejtës për liri të shprehjes duhet të jetë në përputhje me kërkesat e rrepta të testit tri pjesësh.

› E drejta për barazi dhe mosdiskriminim

Ngacmimi dhe abuzimi me bazë gjinore në internet kundër gazetareve mund të shkelë të drejta të tjera të individëve përtej lirisë së shprehjes. Ai kërcënon aftësinë për të marrë pjesë në kushte të barabarta në aktivitetet gazetareske. Gjithashtu, thëllon normat ekzistuese diskriminuese shoqërore dhe stereotipat gjinorë që sfidojnë aftësinë e gazetareve për të vijuar aktivitetin e tyre gazetaresk. Pluralizmi mediatik nuk mund të jetësohet pa gra që janë në gjendje të raportojnë lirshëm dhe sigurt.

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim dhe e drejta për lirinë e shprehjes janë të drejta reciprokisht mbështetëse dhe përforcuese. Këto të drejta do të jenë realizuar vetëm atëherë kur ndërmerren veprime të koordinuara dhe të përqendruara për promovimin e të dyja këtyre të drejtave.

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parasheh barazi dhe mosdiskriminim për të gjithë. Ka detyrime të qarta për Shtetet për të garantuar barazi në gëzimin e të drejtave të njeriut dhe për të ofruar mbrojtje të barabartë me ligj. Parimi i mosdiskriminimit ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë ndaj një personi bazuar në një karakteristikë të mbrojtur, të njohur sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹⁰

Disa dokumente ndërkombëtare pohojnë, sqarojnë dhe zgjerojnë mënyrën se si duhet të zbatohet e drejta për barazi dhe mosdiskriminim ndaj grave. [Konventa për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave](#) (CEDAW), e miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB (AP e OKB) si një lloj e ligji ndërkombëtar për të drejtat e grave, përkufizon diskriminimin ndaj grave si “çdo dallim, përjashtim ose kufizim i bërë në bazë të seksit e që ka efekt ose qëllim të dëmimit ose zhvlerësimit të njohjes, gëzimit ose ushtrimit nga gratë, pavarësisht statusit të tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe grave, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në ndonjë fushë tjetër.”¹¹

Një referencë specifike për gratë gazetare mund të gjendet në [CEDAW Rekomandimi i përgjithshëm nr. 35 mbi dhunën me bazë gjinore](#), që konstaton se praktikat e dëmshme dhe krimet ndaj grave që mbrojnë të drejtat e njeriut, aktivisteve ose gazetareve janë gjithashtu forma të dhunës me bazë gjinore ndaj grave të prekura nga faktorë kulturorë, ideologjikë dhe politikë.¹² Gjithashtu, rekomandimi përcakton që “Palët shtetërore duhet të miratojnë dhe apikojnë masa të ndryshme për të luftuar dhunën me bazë gjinore”.¹³

Në [Deklaratën dhe platformën e veprimit të Pekinit](#), të miratuar nga Shtetet anëtare të OKB-së në vitin 1995, gratë dhe mediat janë njohur në kuadër të 12 fushave kritike të shqetësimit, veçanërisht në lidhje me nevojën për të rritur pjesëmarrjen dhe qasjen e grave në shprehje dhe vendimmarrje në dhe përmes mediave dhe teknologjive të reja të komunikimit, veç tjerash duke adresuar vlerën e një portretizimi të balancuar dhe jo të stereotipizuar të grave në media.¹⁴

Në [Vendimin nr. 4/18 e Këshillit Ministror të OSBE-së mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave](#), Shtetet pjesëmarrëse janë zotuar që të

parandalojnë dhe luftojnë dhunën ndaj grave, e cila aplikohet edhe për gazetaret. Ky vendim pranoi që “gratë e përfshira në aktivitete profesionale me ekspozim publik dhe/ose në interes të shoqërisë, ka më shumë të ngjarë që t’u ekspozohen formave specifike të dhunës ose abuzimit, kërcënimeve dhe ngacmimeve, në lidhje me punën e tyre”. Këto zotime të dakorduara nga të gjitha Shtetet, sigurojnë mes tjerash qasje në drejtësi, si dhe hetim dhe ndjekje efektive penale të kryerësve duke i respektuar të drejtat e tyre për privatësi; duke kontribuar kështu në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës me të cilat përballen gratë; dhe ndërmarrjen e veprimeve për të adresuar abuzimin, kërcënimet dhe ngacmimet, përfshirë përmes teknologjive digjitale.¹⁵

Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Dhunën ndaj Grave, Shkaqet dhe Pasojat e saj, si dhe Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e së Drejtës në Liri të Mendimit dhe Shprehjes u bashkuan në Ditën Ndërkombëtare të Gruas në vitin 2017 për t’u bërë thirrje Shteteve dhe kompanive që ta adresojnë abuzimin me bazë gjinore në internet, duke kërkuar kujdes kundër censurimit. Raportuesit kërkuar përgjigje të bazuara në të drejtat e njeriut për trajtimin e mjediseve që mundësojnë abuzime me të cilat shpeshherë përballen gratë në internet.¹⁶

› **Të drejtat e njeriut jashtë internetit duhet të mbrohen edhe në internet**

Të kuptuarit se si standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut shtrihen në sferën digjitale është jetike për t’i adresuar ngacmimet dhe abuzimet me bazë gjinore në një mënyrë që promovon, jo komprometon, sigurinë e gazetareve.

Në vitin 2013, OKB-ja deklaroi se të gjitha të drejtat e njeriut zbatohen në mënyrë të barabartë në internet. [Rezoluta 32/13 e Këshillit të OKB-së](#)

[për të Drejtat e Njeriut \(KDNJ i OKB\) për promovimin, mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave të njeriut në internet](#) deklaroi se “të njëjtat të drejta që njerëzit i kanë jashtë internetit duhet të mbrohen edhe në internet, veçanërisht liria e shprehjes, e cila është e zbatueshme pavarësisht nga kufijtë dhe përmes çdo medie të përzgjedhur, në përputhje me nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”.¹⁷ Gjithashtu, ajo u bëri thirrje Shteteve që të rrisin qasjen e grave në internet dhe ta mbyllin hendekun gjinor digjital.¹⁸

Teknologjitë e komunikimit kanë shpër në zgjerimin e mjeteve për të gjithë që t’i shprehin mendimet e tyre. Në të njëjtën kohë, këto mjete janë të cenueshme nga mbikëqyrja dhe përgjimi, e që mund t’i rrezikojnë të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtën për komunikim privat. Kjo e drejtë artikullohet në nenin 17 të PNDKP-së, që përcakton se “askush nuk do t’i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare ose të paligjshme në privatësinë, familjen, shtëpinë ose korrespondencën e tij/saj, ose sulmeve të paligjshme ndaj nderit dhe reputacionit të tyre”.¹⁹

Ndonëse standardet e të drejtave të njeriut ofrojnë mbrojtje kundër mbikëqyrjes, megjithatë, ky është një rrezik aktual, veçanërisht për gazetarët të cilët, për shkak të punës së tyre, janë më të prirur të jenë cak i ndërhyrjeve të paligjshme që mund të çojnë në heshtjen e tyre. Për këtë arsye, mjetet e kriptimit dhe anonimiteti janë jetike për të mundësuar ushtrimin e sigurt të së drejtës për liri të shprehjes në epokën digjitale.²⁰ Kufizimet në kriptim dhe anonimitet duhet të limitohen në mënyrë strikte sipas testit tre pjesësh: 1) ligjshmëria, 2) legjitimiteti dhe 3) domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.²¹ [Vendimi i i Këshillit Ministror të OSBE-së nr. 3/18 mbi sigurinë e gazetarëve](#) (në shtojcë) e ka njohur këtë të drejtë, duke u bërë thirrje Shteteve që “të përmbahen nga ndërhyrjet arbitrare ose të paligjshme në përdorimin nga gazetarët të teknologjive të kriptimit dhe anonimitetit dhe të përmbahen nga përdorimi i teknikave të paligjshme ose arbitrare të vëzhgimit”.²²

› Një numër gjithnjë më i madh i standardeve të të drejtave të njeriut promovon sigurinë e gazetarëve

Shoqëritë e hapura, gjithëpërfshirëse dhe demokratike nuk mund të ekzistojnë pa njerëz të informuar. Kur sulmohet gazetaria, sulmohet e drejta për informim e çdo personi. Sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Shtetet kanë detyrimin që të mbrojnë ata që ushtrojnë profesionin e gazetarisë. Numri i dokumenteve ndërkombëtare që përshkruajnë se si duhet bërë kjo është rritur gjatë dekadës së fundit. Këto dokumente njohin kërcënimet me bazë gjinore dhe nevojën për qasje të përgjegjshme gjinore në nivele të ndryshme.

Organet ndërkombëtare kanë ndërtuar një përkufizim në terma funksionale se kush është gazetar në epokën digjitale. [Komenti i përgjithshëm 34](#) i KDNJ të OKB i vitit 2013 përkufizon funksionin e gazetarisë si “funksion që i përket një game të gjerë aktorësh, përfshirë gazetarë dhe analistë profesionistë me orar të plotë, si dhe blogerë dhe persona të tjerë që angazhohen në forma të vetëbotimit në shtyp, në internet ose gjetiu”.²³ Për Këshillin e Evropës, termi “gazetar” i referohet atyre që “kryejnë veprimtari gazetareske ose përmbushin funksione publike të rojes (watchdog)”.²⁴

OKB ka njohur vazhdimisht rëndësinë e forcimit të sigurisë së gazetarëve në vitet e fundit. Në vitin 2012, KDNJ i OKB miratoi [rezolutën e parë mbi sigurinë e gazetarëve](#), duke u bërë thirrje Shteteve që “të promovojnë një mjedis të sigurt dhe pozitiv për gazetarët për ta kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje të padrejtë”,²⁵ përfshirë me anë të masave legjislative, ndërgjegjësimin, monitorimin dhe raportimin, duke dënuar publikisht sulmet, dhe duke dedikuar burimet e nevojshme për hetim dhe ndjekje penale të sulmeve të tilla. Para kësaj rezolute, UNESCO dhe Këshilli i Sigurimit i OKB (KSOKB) kishin miratuar dy tekste mbi çështjen e sigurisë së gazetarëve.²⁶

Pas rezolutës nr. 32/13 të vitit 2012, KDNJ i OKB, Asambleja e Përgjithshme e OKB (APOKB), KS i OKB dhe Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s kanë miratuar mbi dhjetë [rezoluta](#) për sigurinë e gazetareve; disa nga këto rezoluta kanë fokus të veçantë në sigurinë e grave gazetare,²⁷ siç është [Rezoluta 74/157 e APOKB](#) e vitit 2019.²⁸ Rezoluta 45/17 e KDNJ e OKB (2020) në mënyrë specifike u bëri thirrje Shteteve që “të marrin masa për parandalimin e ngacmimeve seksuale dhe formave të tjera të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore” ndaj gazetareve, si në internet ashtu edhe jashtë tij.²⁹ Për më tepër, janë publikuar [raporte të ndryshme të zbatimit](#) të këtyre rezolutave.³⁰ Në veçanti, [raporti i zbatimit të vitit 2017](#) nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së u fokusua në sigurinë e gazetareve.³¹ Në vitin 2020, Raportuesi i Posaçëm i OKB-së mbi Dhunën ndaj Grave, Shkaqet dhe Pasojat e saj, publikoi një raport me fokus në luftimin e dhunës ndaj gazetareve.³²

Në vitin 2012 u hartua dhe miratua strategjia e parë ndërinstitucionale e OKB-së. [Plani i veprimit të OKB-së mbi sigurinë e gazetareve dhe çështjen e pandëshkueshmërisë](#) bën thirrje për një “qasje të ndjeshme gjinore” për sigurinë e gazetareve dhe luftën kundër pandëshkueshmërisë, si dhe ka orientuar punën e OKB-së për këtë çështje në bashkërendim me aktorët e tjerë.³³

Përfshirja e sigurisë së gazetareve në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OBZH) është një tregues tjetër i rëndësisë së tij për të drejtat dhe zhvillimin global të njeriut. OBZH 16 synon të “promovojë shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të sigurojë qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtojë institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”.³⁴ [Treguesi 16.10.1 vlerëson](#) “numrin e vrasjeve, rrëmbimeve, zhdukjeve me forcë, ndalimit arbitrar dhe torturave të gazetareve”.³⁵

Në vitin 2018, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së miratuan vendimin e tyre të parë me fokus në sigurinë e gazetarëve, [Vendimin nr. 3/18 të Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve](#). Ky vendim, i dakorduar me konsensus të të gjitha 57 Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, u bën thirrje këtyre Shteteve pjesëmarrëse që të parandalojnë, mbrojnë dhe ndjekin penalisht sulmet kundër gazetarëve. Përveç kësaj, ai shpreh shqetësim mbi “rreziqet e dallueshme me të cilat ballafaqohen gazetaret në lidhje me punën e tyre, përfshirë përmes teknologjive digjitale”, dhe nënvizon “rëndësinë e garantimit të sigurisë më të lartë të mundshme për to dhe që përjetimet dhe brengat e gazetareve të adresohen në mënyrë efektive”.³⁶ Vendimi u bën gjithashtu thirrje Shteteve që “t’i dënojnë publikisht dhe pa mëdyshje sulmet ndaj gazetareve në lidhje me punën e tyre, siç janë ngacmimi seksual, abuzimi, frikësimi, kërcënimet dhe dhuna, përfshirë përmes teknologjive digjitale”.³⁷ Ndërsa ky është vendimi i parë i OSBE-së me fokus në sigurinë e gazetarëve, ka shumë standarde të OSBE-së për lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe qasjen në informacion³⁸ dhe publikime të ndryshme udhëzuese për sigurinë e gazetarëve.³⁹

› **Bizneset duhet t’i respektojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**

Ndërsa u drejtohet në radhë të parë Shteteve, korniza ndërkombëtare e të drejtave të njeriut vlen edhe për ndërmarrjet afariste, si kompanitë e mediave sociale, që do të thotë se këtyre kompanive u kërkohet të respektojnë të drejtat e njeriut. [Parimet udhëzuese të OKB-së për biznesin dhe të drejtat e njeriut](#) theksojnë se kompanitë kanë përgjegjësinë që “të shmangin shkaktimin ose kontribuimin në ndikimet negative në të drejtat e njeriut përmes aktiviteteve të tyre dhe të adresojnë ndikimet e tilla siç shfaqen”, si dhe të parandalojnë ose zbusin ndikimet negative


në të drejtat e njeriut që janë drejtpërsëdrejti të lidhura me operacionet, produktet ose shërbimet e tyre nga marrëdhëniet e biznesit, edhe nëse ata vetë nuk kanë kontribuar drejtpërsëdrejti në ato ndikime.⁴⁰

Në vitin 2019, Organizata Ndërkombëtare e Punës miratoi [Konventën 190 mbi Dhunën dhe Ngacmimin](#) në mjedis të punës, duke njohur të drejtën e secilit për të punuar pa dhunë dhe ngacmim, përfshirë dhunë dhe ngacmime me bazë gjinore, meqë kjo përbën kërcënim për mundësi të barabarta. Ajo u bën thirrje Shteteve që t'i detyrojnë bizneset t'i përmbahen tolerancës zero për dhunë dhe ngacmime.⁴¹

Shënime fundore

- 1 ARTICLE 19, Global Expression Report 2018/19, London, 2019, <https://www.article19.org/xpa-2019/>.
- 2 For more information on international standards that apply to freedom of expression and women's equality, see ARTICLE 19, Freedom of Expression and Women's Equality: Ensuring Comprehensive Rights Protection. London, 2020.
- 3 UN Universal Declaration of Human Rights, 10 December 1948, <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>.
- 4 UN General Assembly, Resolution 2200A (XXI), International Covenant on Civil and Political Rights, 16 December 1966, entry into force: 23 March 1976, Article 49, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>.
- 5 Council of Europe, European Convention on Human Rights, entry into force: 21 September 1970, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf.
- 6 UN Human Rights Committee, General Comment No. 34, Article 19: Freedoms of opinion and expression, CCPR/C/GC/34, 12 September 2011, paragraph 11, <https://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/gc34.pdf>.
- 7 Ibid
- 8 Op. cit. endnote 4
- 9 .Op. cit. endnote 6, paragraph 50ff.
- 10 UN Human Rights Committee, CCPR General Comment No. 18: Non-discrimination, 10 November 1989, paragraph 6, <https://www.refworld.org/docid/453883fa8.html>
- 11 UN General Assembly, Resolution 34/180, Convention on the Elimination of Discrimination against Women, 18 December 1979, entry into force: 3 September 1981, <https://www.ohchr.org/documents/professionalinterest/cedaw.pdf>. See also "Convention on the Elimination of All Forms of Discriminations against Women", UN Women, <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>.
- 12 Committee on the Elimination of Discrimination against Women, "General recommendation No. 35 on gender-based violence against women, updating general recommendation No. 19", CEDAW/C/GC/35, 14 July 2017 https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/CEDAW_C_GC_35_8267_E.pdf.
- 13 Ibid
- 14 UN, Beijing Declaration and Platform for Action, 15 September 1995, https://www.un.org/en/events/pastevents/pdfs/Beijing_Declaration_and_Platform_for_Action.pdf.
- 15 OSCE, Ministerial Council, Decision No. 4/18, "Preventing and Combating Violence Against Women", 7 December 2018, <https://www.osce.org/chairmanship/406019?download=true>.
- 16 "UN experts urge States and companies to address online gender-based abuse but warn against censorship", UN Office of the High Commissioner for Human Rights, news item, 8 March 2017, <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=21317>.
- 17 UN Human Rights Council, Resolution 32/13, The promotion, protection and enjoyment of human rights on the Internet, A/HRC/RES/32/13, 18 July 2016, <https://undocs.org/A/HRC/RES/32/13>.
- 18 Ibid
- 19 Op. cit. endnote 4.
- 20 UN General Assembly, Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression, A/HRC/29/32, 22 May 2015, <https://undocs.org/A/HRC/29/32>.
- 21 Ibid.
- 22 OSCE, Ministerial Council, Decision No. 3/18, "Safety of Journalists", 7 December 2018, <https://www.osce.org/chairmanship/406538?download=true>.

- 23 Op. cit. endnote 6, paragraph 44.
- 24 Council of Europe, Committee of Ministers “Recommendation of the Committee of Ministers to member States on the protection of journalism and safety of journalists and other media actors”, CM/Rec(2016)4, 13 April 2016 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#_ftn1.
- 25 UN Human Rights Council, Resolution 21/12, “Safety of Journalists”, A/HRC/RES/21/12, 9 October 2012, <https://undocs.org/A/HRC/RES/21/12>.
- 26 UNESCO, Resolution 29, “Condemnation of violence against journalists”, November 1997, <https://en.unesco.org/sites/default/files/resolution29-en.pdf>. UN Security Council, Resolution 1738 (2006), 23 December 2006, <http://unscr.com/en/resolutions/doc/1738>.
- 27 “How can UN resolutions make it safer to be a journalist?”, IFEX news item, 17 November 2017, <https://ifex.org/how-can-un-resolutions-make-it-safer-to-be-a-journalist>.
- 28 United Nations General Assembly Resolution 74/157, “The safety of journalists and the issue of impunity”, adopted on 18 December 2019, <https://undocs.org/A/RES/74/157>.
- 29 UN Human Rights Council, Resolution 45/18, “The safety of journalists”, A/HRC/45/18, 6 October 2020. <https://undocs.org/en/A/HRC/RES/45/18>.
- 30 “Resolutions on journalists’ safety: How does the UN monitor their implementation?”, IFEX news item, 22 December 2017, <https://ifex.org/resolutions-on-journalists-safety-how-does-the-un-monitor-their-implementation/>.
- 31 UN General Assembly, Report of the UN Secretary-General on “The safety of journalists and the issue of impunity”, A/72/290, 4 August 2017 <https://undocs.org/A/72/290>.
- 32 UN Human Rights Council, Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences on Combating violence against women journalists, A/HRC/44/52, 6 May 2020 <https://undocs.org/en/A/HRC/44/52>.
- 33 UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity, UNESCO, CI-12/CONF.202/6, 2012, <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists>.
- 34 UN Sustainable Development Goals (SDGs), SDG 16: Promote peaceful and inclusive societies for sustainable development, provide access to justice for all and build effective, accountable and inclusive institutions at all levels, 2015, <https://sustainabledevelopment.un.org/sdgr6>
- 35 “SDG Indicators Metadata repository”, UN Sustainable Development Goals Statistics Division, <https://unstats.un.org/sdgs/metadata/?Text=&Goal=r6&Target=r6.io>.
- 36 Op. cit. endnote 15.
- 37 Ibid.
- 38 OSCE RFoM, “Commitments: Freedom of the Media, Freedom of Expression, Free Flow of Information, 1975-2017”, 4th edition, 2017, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/99565>.
- 39 OSCE RFoM, Publications, collected: [https://www.osce.org/resources/publications?filters=im_taxonomy_vid_1:\(27\)](https://www.osce.org/resources/publications?filters=im_taxonomy_vid_1:(27)).
- 40 UN Office of the High Commissioner for Human Rights, Guiding Principles on Business and Human Rights, 2011, https://www.ohchr.org/Documents/Publications/GuidingPrinciples-BusinessHR_EN.pdf.
- 41 International Labour Organization, C190-Violence and Harassment Convention, 2019, https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C190.



**Shndërroji fjalët
në vepër**

Shndërroji fjalët në vepër

Çfarë mund të bëjnë aktorët kryesorë

Adresimi i ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj grave gazetare kërkon një qasje shumështrësore me angazhim të shumë aktorëve. Ky kapitull i udhëzuesit të burimeve paraqet hapa të menjëhershëm për aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë për të forcuar sigurinë e gazetareve në internet. Qëllimi është që përpjekjet ekzistuese të përmirësohen, si dhe që aktorët kryesorë të inkurajohen për të ndërmarrë iniciativa të reja. Së bashku, këta hapa formojnë një strukturë të ndërlidhur në të cilën gratë gazetare mund ta vazhdojnë profesionin e tyre në internet në mënyrë më të sigurt.

Dhjetë kapitujt vijues janë të ndarë në dy blloqe, një për Shtetet dhe një për aktorët joshtetërorë. Ky udhëzues burimesh nuk mëton të propozojë një listë shteruese të veprimeve që duhen ndërmarrë për të adresuar gamën e gjerë të ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj gazetareve. Në fakt, udhëzuesi paraqet për secilin akter kyç një përzgjedhje të shkurtër të hapave më të rëndësishëm dhe të arritshëm. Shembuj konkretë, të aplikuar nga aktorë të ndryshëm në vende të ndryshme të botës, ilustrojnë secilin veprim të propozuar. Listën e plotëson një përzgjedhje e burimeve të dobishme.

Siguria e gazetareve në internet nuk mund të adresohet ndaras nga angazhimi për sigurinë e të gjithë gazetarëve, dhe as nuk mund të adresohet pa angazhim më të gjerë për barazi gjinore në shoqëri. E thënë thjesht, siguria e grave në media mund të përmirësohet ndjeshëm duke siguruar që gratë të kenë të drejta të barabarta dhe mundësitë e sigurinë e njëjtë sikurse burrat. Kështu, disa veprime të propozuara përfshijnë integrimin e një qasjeje gjinore në nismat ekzistuese që promovojnë sigurinë e gazetarëve. Veprime të tjera kanë të bëjnë me modifikimin ose përshtatjen e veprimeve ekzistuese për barazi gjinore.

› Qasje e përgjegjshme gjinore

Çdo nismë që synon të trajtojë ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj gazetareve duhet të hartohet me një qasje të përgjegjshme gjinore. Përderisa qasja e ndjeshme gjinore ka të bëjë me të qenit të vetëdijshëm për rolet, normat dhe marrëdhëniet gjinore, qasje e përgjegjshme gjinore do të thotë të marrësh parasysh dhe të veprosh sipas normave, roleve, marrëdhënieve gjinore, dhe si politikave ose masat ndikojnë ndryshe tek burrat dhe gratë. Bëhet fjalë për ndërmarrjen e veprimeve drejt barazisë gjinore.

Duhet të zbatohen dhjetë mënyrat e mëposhtme të punës:

1. Neutraliteti gjinor është verbëri gjinore. Çdo vendim dhe masë, qoftë legjislacon, program trajnimi apo buxhet, apo masë tjetër e tillë, ka efekt të ndryshëm tek njerëz të ndryshëm, përfshirë edhe në varësi të gjinisë së tyre.
2. Gjinia është e ndërlidhur me identitete të tjera. Gjinia, së bashku me moshën, klasën, të ardhurat, etninë, orientimin seksual, fenë, aftësinë e kufizuar, racën dhe faktorë të tjerë si të qenit pjesë e një kulture urbane kundrejt mjedisit rural, përbëjnë kategori të përcaktuara shoqërore që ndërthuren dhe prodhojnë pabarazi të mbivendosura dhe të ndërvarura. Kjo quhet një qasje e ndërthurur dhe është e domosdoshme, meqë jo të gjithë përjetojnë pabarazinë në të njëjtën mënyrë.
3. Adresoni pabarazitë në çdo hap të rrugës. Pabarazitë midis grave dhe burrave, duke përfshirë qasjen asimetrike në pushtet dhe të drejta, duhet të merren parasysh gjatë tërë procesit, duke filluar nga hartimi, planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i legjislaconit, politikave dhe çdo veprim tjetër.

4. Nuk ka të bëjë vetëm me çfarë, por edhe si duhet bërë. Qasja e përgjegjshme gjinore jo vetëm që merr parasysh shkallën në të cilën marrëdhënia mes gjinisë dhe pushtetit ndikon në kontekst, por ngërthen gjithashtu një proces gjithëpërfshirës, pjesëmarrës dhe të respektueshëm që fuqizon dhe promovon barazinë gjinore.
5. Informacioni është thelbësor për krijimin e zgjidhjeve. Të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse për sulmet kundër gazetarëve, të zberthyer sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë ndërsektorial, janë të domosdoshme për të zhvilluar përgjigje të forta të përshtatura në kontekste të ndryshme politike, ekonomike, kulturore dhe sociale.
6. Vazhdoni të dëgjoni zëra të ndryshëm. Për të siguruar që gratë gazetare janë përfshirë në vendimmarrje aktive në lidhje me punën që potencialisht ndikon në jetën e tyre, nevojiten konsulta të gjera dhe transparente, me përfshirje të aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të të gjitha specializimeve e fushave përkatëse.
7. Ndërtoni kapacitete për ndryshim. Trajnimet për qasjet e përgjegjshme gjinore duhet të jenë në dispozicion për të gjithë aktorët e përfshirë në mbrojtjen e gazetarëve. Fokusi duhet të jetë në radhë të parë tek individët që kanë më së shumti mundësi të ushtrojnë ndikim dhe që kanë fuqi të sjellin ndryshim në mënyrë të gjerë dhe të qëndrueshme.
8. Siguroni burime të mjaftueshme. Zotimi për qasje të përgjegjshme gjinore duhet të shkojë përtej fjalëve, me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare të caktuara për zbatimin e këtyre veprimeve.
9. Veproni SMART (mençur). Nismat që adresojnë ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj gazetarëve duhet të përmbajnë qëllime që janë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe me afate

kohore (SMART). Kjo do të promovonte llogaridhënie ndaj barazisë gjinore dhe do të kontribuonte në sistematizimin e mësimave të nxjerra, duke mbështetur kështu progresin drejt veprimeve të përmirësuara në të ardhmen.

10. Masat për mbrojtje të grave duhet të avancojnë, jo të minojnë, të drejtat e tyre themelore. Çdo masë që mund të kufizojë të drejtën e lirisë së shprehjes duhet të përcaktohet me ligj, t'i shërbejë një qëllimi legjitim dhe të jetë e domosdoshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike. Shkurajimi ose kufizimi i veprimtarive profesionale të grave nuk është zgjidhja.



**Dega ekzekutive
e qeverisë**

Veprimet e propozuara

1. Të hartohet një plan kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve që adreson kushtet specifike për gazetaret;
2. Të aplikohen masa mbrojtëse të përgjegjshme gjinore;
3. Të mblidhen të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve për të shërbyer si bazë për politika dhe hulumtime, si dhe për të mbështetur fushata të ndërgjegjësimit për nxitje të angazhimit të vendimmarrësve dhe opinionit publik;
4. Të raportohet për sigurinë e gazetarëve tek mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe të integrohet kjo çështje në politikën e jashtme.

1. Dega ekzekutive e qeverisë

Zbatimi i politikave dhe praktikave për siguri të shtuar për gazetaret

Dega ekzekutive është përgjegjëse për qeverisjen e Shteteve, duke vendosur politika dhe procese për ekzekutimin dhe zbatimin efektiv të ligjeve. Ky kapitull propozon një përzgjedhje të veprimeve që presidenti, ose zyra e kryeministrit dhe ministritë, mund t'i ndërmarrin për të mbrojtur, por dhe promovuar, sigurinë e gazetarëve në internet. Gjersa ky kapitull nuk përqendrohet në pushtetet lokale format dhe funksionet e së cilave janë tejet të ndryshme, veprimet e propozuara mund të jenë po aq relevante edhe për autoritetet lokale. Roli i agjencive të zbatimit të ligjit, ndonëse bie nën përgjegjësinë e ekzekutivit, trajtohet veçmas në kapitullin katër.

Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE u bën thirrje Shteteve që “të zbatojnë në tërësi të gjitha zotimet e OSBE-së dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare lidhur me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, përfshirë përmes respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së lirisë për të kërkuar, pranuar dhe dhënë informacion pavarësisht kufijve.”

› Të hartohet një plan kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve që adreson kushtet specifike për gazetaret

Zotimi kombëtar për sigurinë e gazetarëve duhet të dëshmohej në nivelet më të larta, si me fjalë ashtu edhe me vepra. Anëtarët e qeverisë duhet të dënojnë publikisht dhe pa mëdyshje sulmet ndaj gazetarëve që janë në lidhje me punën e tyre, dhe atë jo vetëm në raste të dhunës fizike, por edhe kur ka të bëjë me ngacmim seksual, frikësim, kërcënim

dhe abuzime të tjera, përfshirë përmes teknologjive digjitale.¹ Zyrtarët publikë duhet të udhëheqin me shembull dhe të përmbahen nga denigrimi, frikësimi ose kërcënimi i medias, përfshirë përdorimin e gjuhës misogynene ndaj gazetaresve.

Dhuna ndaj gazetaresve dhe ngacmimet e abuzimet në internet janë të lidhura në mënyrë të qenësishme me pabarazinë më të gjerë shoqërore dhe qëndrimet ndaj grave. Politikat për adresimin e shkaqeve kryesore të dhunës me bazë gjinore dhe të stereotipave gjinorë duhet të shoqërohen dhe ndërliken me plane veprimi që synojnë përmirësimin e sigurisë së gazetaresve. Duhet promovuar fuqizimi i grave në të gjithë shoqërinë, jo vetëm veprime specifike për sektorin e medias.

Sigurisht, ngacmimi dhe abuzimi në internet ndaj gazetaresve është i lidhur me mjediset mediatike në të cilat ato punojnë. Kuptimi i kontekstit specifik në secilin vend është thelbësor për adresimin e sigurisë së gazetaresve. Përfshirja e një vlerësimi kombëtar të mënyrës se si gratë dhe burrat gazetarë janë të ekspozuar ndaj dhe ndikohen nga lloje të ndryshme kërcënimesh (fizike, psikologjike, digjitale, ligjore dhe ekonomike) është hap i parë i rëndësishëm drejt hartimit të një plani kombëtar të veprimit për sigurinë të gazetaresve.

Qëllim përfundimtar i një plani kombëtar të veprimit duhet të jetë hartimi i masave më efektive për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi sigurinë e gazetaresve, dhe që këtë ta bëjë duke pasur parasysh përgjegjësinë gjinore. Kjo nënkupton hartimin e veprimeve për adresimin e nevojave specifike të grave gazetares duke kontribuar në ndryshimin e dinamikave gjinore dhe të pushtetit që minojnë barazinë gjinore. Hap konkret është realizimi i një auditimi të përgjegjshëm gjinor në lidhje me zbatimin e standardeve dhe zotimeve specifike, si [Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-](#)

[së mbi sigurinë e gazetarëve](#), si pjesë e një plani kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve. Nëse vendi ka tashmë plan aktiv kombëtar të veprimit për sigurinë e gazetarëve, i njëjti mund të rishikohet për të integruar një qasje të përgjegjshme ndaj çështjeve gjinore dhe masa për adresimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet. Këtu mund të përfshihet hartimi i programeve të trajnimit në fushën e sigurisë që kanë si qëllim identifikimin dhe trajtimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet, si dhe formimi ose fuqizimi i shoqatave, rrjeteve dhe forumeve mbështetëse për gratë gazetare, veçanërisht të atyre që punojnë për të luftuar abuzimin në internet.²

Rekomandohet fuqimisht gërshetimi me fushat tjera përkatëse, siç janë planet kombëtare të veprimit për barazinë gjinore, të drejtat e njeriut ose kategori të tjera me tema të ndërlidhura.

Sipas [Planit të veprimit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit](#), është thelbësore të krijohen partneritete strategjike me aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë, rajonalë e lokalë.³ Duke mbajtur këtë parasysh, veprimet për të adresuar ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj gazetarëve do të duhej të zhvillohen dhe zbatohen me një shkallë të lartë të përfaqësimit nga gazetaret. Në këtë mënyrë, do të krijoheshin praktika të bazuara në informata nga vet ato që preken nga ky problem dhe njëherazi të fuqizoheshin nëpërmjet pjesëmarrjes. Këtu mund të përfshihen të gjitha degët e shtetit, institucionet e pavarura për të drejtat e njeriut, organet rregullatore dhe vetërregulluese të mediave, kompanitë ndërmjetëse në internet, mediat publike, private dhe të komunitetit, shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve, grupet e shoqërisë civile, institucionet arsimore në lëmin e gazetarisë dhe studiuesit akademikë, ekspertë të edukimit mbi mediat dhe organizatat për të drejtat e grave.

Shembuj

Integrimi i planeve kombëtare të veprimit: Plani kombëtar i veprimit i Suedisë [Mbrotja e fjalës së lirë: Masat për të mbrojtur gazetaret, përfaqësuesit e zgjedhur dhe artistët nga ekspozimi ndaj kërcënimeve dhe urrejtjes](#) njih nevojën për të integruar planin për sigurinë e gazetarëve në strategjinë kombëtare për barazi gjinore dhe nevojën për të siguruar një qasje gjinore nga aktorët kryesorë të tillë si gjyqësori.⁴ Aspekt kyç i fokusit të këtij plani është zgjerimi, zhvillimi dhe financimi i institucioneve ekzistuese, siç janë qendrat lokale mbështetëse për viktimat dhe linjat telefonike për ndihmë për të mbështetur këdo që përballet me kërcënime si rrjedhojë e pjesëmarrjes në diskursin publik.

Realizimi i auditimeve: Në vitin 2018, Universiteti i Amsterdimit realizoi një [Auditim të lirisë së shprehjes në Holandë](#)⁵ me qëllim të ofrimit të një pasqyre konkrete të zbatimit të Rekomandimit të vitit 2016 të Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave në Holandë.⁶ Ndonëse auditimi në fjalë nuk mbulon në mënyrë specifike çështjen e dhunës në internet ndaj grave gazetare, ai është megjithatë shembull i mirë i mënyrës se si duhet të realizohet një vlerësim efektiv.

Përfshirja e çështjes së mbrojtjes së gazetarëve në politika: Për ta shtuar ndikimin, mbrojtja e gazetarëve mund të përfshihet në politikat kombëtare të barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut, ose në politika tjera të ndërlidhura. Për shembull, [Programi kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut 2013 - 2016](#) në Kroaci përmbante një rekomandim për forcimin e ndjekjes penale të kryerësve të veprave të dhunës dhe kanosjes ndaj gazetarëve.⁷

Burime

- [Treguesit e UNESCO-s për sigurinë e gazetarëve \(TSG\)](#)⁸ ofrojnë një sërë treguesish për vlerësimin e gjendjes së sigurisë së gazetarëve në nivel kombëtar. Gjithashtu, dokumenti përmban një udhëzues për mënyrën e zbatimit të tyre, megjithëse zbatimi i treguesve në fjalë nevojitet të përplotësohet me një mjet vlerësimi të përgjegjshëm gjinor.⁹ TSG-të janë zbatuar në Afganistan, Guatemalë, Irak, Kenia, Nepal dhe Pakistan.
- [Doracaku për planet kombëtare të veprimit mbi dhunën ndaj grave](#) i UN Women mund të shërbejë si pikë referimi për integrimin e qasje gjinore në kuadër të planit të veprimit për sigurinë e gazetarëve.¹⁰ Gjithashtu, [Si të menaxhohet një vlerësim i përgjegjshëm gjinor](#) i UN Women mund të ofrojë këshilla për vlerësimin e sigurisë së gazetarëve me një qasje të përgjegjshme gjinore.¹¹

› Të aplikohen masa mbrojtëse të përgjegjshme gjinore

Gazetarët të cilat janë cak i kërcënimeve duhet të kenë qasje të menjëhershme në masa konkrete të mbrojtjes. Reagimi i shpejtë në kërcënimet ndaj gazetarëve mund të jetë efektiv në mbrojtjen e një caku (të mundshëm) dhe minimizimin e përshkallëzimit të mundshëm të dhunës. Ky lloj mekanizmi mund t'i lihet nën mbikëqyrje ndonjë organi qeveritar si, për shembull, agjencie të zbatimit të ligjit ose grupi në përbërje të aktorëve të shumtë me mandat si mekanizëm kombëtar i mbrojtjes. Gjersa mekanizmat në fjalë përdoren tradicionalisht në raste sulmesh fizike, të njëjtit mund të mobilizohen dhe për mbështetje ligjore e psikosociale, përfshirë në rastet e ngacmimit dhe abuzimit në internet.

Duke pasur parasysh natyrën e veçantë dhe shpesh të ndjeshme të kërcënimeve ndaj gazetarëve, që mund të përfshijnë dhunë të seksualizuar, kërcënim me dhunë dhe sulm seksual, përfshirë ndaj anëtarëve të familjes, është e domosdoshme që të gjitha masat, përfshirë ato në kuadër të mekanizmave të reagimit të shpejtë, të jenë të përgjegjshme ndaj gjinisë. Hap i parë është që të sigurohet se çdo analizë e sulmeve që bëhet të ketë parasysh çdo aspekt gjinor dhe që grave t'u vihen në dispozicion burime personeli adekuate të tilla si zyrtare të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e personit të sulmuar, përfshirë shoqërimin e tyre si truproje, ose gra që u përgjigjen linjave telefonike të urgjencës. Protokollet e vlerësimit të rrezikshmërisë dhe reagimit duhet të marrin parasysh masat e sigurisë ose të mbështetjes si, për shembull, nëse është e nevojshme zhvendosja, që u janë përshtatur nevojave specifike të grave individuale të sulmuara.

Është me rëndësi që çdo reagim i shpejtë ose mekanizëm mbrojtës të përfshijë masa parandaluese dhe zgjidhje proaktive, jo vetëm përbërës reaktivë. Kjo mund të përfshijë një sistem të monitorimit të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve si në internet ashtu dhe jashtë internetit, të kombinuar me analizë gjinore. Masat e tilla parandaluese janë kyçe për identifikimin e trendeve dhe të gatishmërinë për t'i adresuar kërcënimet në mënyrë më efektive. Në kuadër të nismave parandaluese mund të përfshihen dhe programe trajnimi për të gjithë aktorët e angazhuar, mes tjerash përkritazi me mënyrën e reagimit në rastet kur gazetarët janë shënjestër e ngacmimit e abuzimit në internet dhe krijimin e burimeve lehtësisht të arritshme që i informojnë gazetarët se si t'i përdorin mekanizmat dhe masat e vendosura. Këto përpjekje duhet të shoqërohen me fushata ndërgjegjësimi.

Masat e mbrojtjes janë më të arritshme dhe efektive kur i përshtaten rastit dhe kontekstit të secilit gazetar veç e veç. Kjo nënkupton që, për shembull, pajisjet mbrojtëse duhet t'i përshtaten trupit dhe rrobave të grave, që mund

të paraqitet nevoja që në kuadër të mbështetjes financiare të parashihen dhe personat në ngarkim, si dhe që mbështetja specifike psikologjike të garantohet për gazetarët të cilët/cilat janë objekt i ngacmimit ose abuzimit në internet. Gjithë aktorët e angazhuar në mbrojtjen e gazetarëve duhet të trajnohen mbi qasjet e përgjegjshme gjinore.

Strukturimi i mekanizmave dhe masave mbrojtëse për të akomoduar përfaqësim të palëve të shumta të interesit në menaxhim dhe mbikëqyrje siguron ekspertizë të larmishme, si edhe llogaridhënie më të madhe. Në mesin e këtyre grupeve të interesit duhet të jenë dhe organizatat për të drejtat e grave dhe shoqatat e gazetarëve.

Përpyekjet për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve duhet të shoqërohen çdoherë me ndjekjen penale të atyre që kryejnë dhunë ndaj gazetarëve dhe me adresimin e mosndëshkimit të krimeve ndaj gazetarëve. Si masë mbështetëse konkrete, ekzekutivi mund të emërojë një prokuror kombëtar të pavarur e të specializuar në krime kundër lirisë së shprehjes dhe gazetarëve. Prokurori special mund të mbikëqyrë dhe bashkërendojë lëndët, t'u ofrojë mbështetje viktimave, si dhe të promovojë një kulturë të zero tolerancës ndaj mosndëshkimit të krimeve kundër lirisë së shprehjes dhe gazetarëve.¹² Ky person duhet të trajnohet për qasjet e përgjegjshme gjinore.

Disa vende mund të kenë tashmë mekanizma kombëtarë të mbrojtjes ose reagimit të shpejtë që funksionojnë mirë. Duke qenë se sulmet me bazë gjinore, përfshirë këtu ngacmimet dhe abuzimet në internet, janë kthyer në një kërcënim relativisht të madh kohët e fundit, mund të ketë akoma nevojë që mekanizmat ekzistues të rishikohen dhe reformohen në mënyrë që të sigurohet përfshirja dhe integrimi i duhur i një qasje të përgjegjshme gjinore. Ky proces duhet të bëhet në konsultim me palët e tjera të interesit, përfshirë ekspertë të perspektivave gjinore në politikat publike dhe në asistencën në siguri.

Shembuj

Krijimi i mekanizmave kombëtarë të reagimit të shpejtë: [Ufficio Centrale Interforze per la Sicurezza Personale](#), një trup i ngritur në kuadër të Ministrisë së Brendshme të Italisë, drejton një mekanizëm të reagimit të shpejtë që siguron truproja, makina të blinduara dhe pajisje të tjera mbrojtëse për gazetarët e kërcënuar nga krimi i organizuar.¹³

Krijimi i grupeve shumëpalëshe: Holanda ka krijuar një [Grup drejtues shumëpalësh kundër agresionit dhe dhunës ndaj gazetarëve](#), me mandatin për të bashkërenduar reagimin e policisë, prokurorisë dhe sektorit të medias e gazetarëve ndaj sulmeve kundër gazetarëve.¹⁴

Inkurajimi i komisioneve hetimore: Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, bashkë me organin përkatës për siguri kombëtare dhe shoqatat e gazetarëve, drejton Komisionin për hetimin e vrasjeve të gazetarëve gjatë luftërave në ish-Jugosllavi, të krijuar në vitin 2013. Si rezultat, në vitin 2019 një person u dënua për vrasjen e një gazetari serb në vitin 1999. Megjithëse ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj gazetarëve nuk janë në fokus të këtij komisioni, ai përbën një shembull të mirë të përbashkimit të ekspertizës dhe mbikëqyrjes së palëve të shumta të interesit.¹⁵

Mbështetja e mekanizmave kombëtarë të reagimit të shpejtë: Në vitin 2020, Bashkimi Evropian (BE) mbështeti krijimin e një mekanizmi të quajtur [Reagim i shpejtë për liri të mediave](#) për të mbrojtur gazetarët, që menaxhohet nga një grup i organizatave të shoqërisë civile në baza ditore.¹⁶ Në kohën kur u krijua ky mekanizëm ekzistonte tashmë një mekanizëm i përgjigjes së shpejtë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut [ProtectDefenders.eu](#), në përbërje të të cilit kishte gjithashtu gazetarë. Këtë mekanizëm e drejton një konzorcium i OJQ-ve për të drejtat e njeriut.¹⁷

Ngritja e mekanizmave kombëtarë të mbrojtjes: Kolumbia është vendi i parë në botë që ka ngritur një mekanizëm kombëtar të mbrojtjes për gazetaret. Në kuadër të tij është themeluar një komitet i dedikuar për mbrojtjen e grave, me përfaqësues nga organizatat për të drejtat e grave, qeveria dhe organizatat ndërkombëtare të tilla si UN Women. Ata analizojnë secilin rast të pranuar nga perspektiva gjinore, gjë që ka bërë të mundur përshtatjen e reagimeve sipas specifikave të rasteve.¹⁸ Dymbëdhjetë vjet pas themelimit të programit të mbrojtjes në 2000, qeveria prezantoi një protokoll në vitin 2012 për adresimin e kërcënimeve ndaj grave gazetare: një shembull i mirë i rivlerësimit dhe reformimit të një mekanizmi ekzistues për të integruar një qasje të përgjegjshme gjinore.

Caktimi i prokurorëve specialë: Në vitin 2006, Meksika caktoi prokurorin e parë special për krime kundër lirisë së shprehjes, me fokus në sulmet kundër gazetarëve.¹⁹

Burime

- [Raporti 24/2 i Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut \(KDNI\)](#) ka mbledhur praktika të mira të aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë për sigurinë e gazetarëve.²⁰
- Këshilli i Evropës (KiE) ka botuar një sërë rekomandimesh dhe praktikash të mira për sigurinë e gazetarëve, të titulluar [Ndërmarrja e veprimeve në mbrojtje të gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias](#), që përmban shembuj konkretë të mënyrave në të cilat standardet e KiE për sigurinë e gazetarëve janë zbatuar në disa vende.²¹

- Një kompilim i mekanizmave për mbrojtjen e gazetarëve mund të konsultohet në serinë e botimeve Mbështetja ndërkombëtare për media, të titulluar [Mbrojtja e gazetarisë](#),²² ku një prej [botimeve](#) në kuadër të kësaj serie përqendrohet posaçërisht në sigurinë e gazetarëve.²³
- Nisma [Reagim i shpejtë për liri të mediave](#) ka botuar një kompilim të masave mbrojtëse të ndërmarra nga shtetet anëtare të BE-së dhe vendet candidate.²⁴
- Universiteti i Palermos ka analizuar efektivitetin dhe strukturën institucionale për mekanizmat e mbrojtjes në një raport mbi rastet e Kolumbisë, Meksikës dhe Guatemalës.²⁵

› **Të mblidhen të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve për të shërbyer si bazë për politikën dhe hulumtimet, si dhe për të mbështetur fushatën e ndërgjegjësimit për nxitjen e angazhimit të vendimmarrësve dhe opinionit publik**

Reagim të fuqishëm ndaj ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj gazetarëve mund të ketë vetëm atëherë kur politikëbërësit, profesionistët e sektorit të medias, grupet e shoqërisë civile dhe publiku i gjerë të kenë njohuri të plota për përmasat e problemit dhe ndikimin të tij në profesionin e gazetarisë, shprehjen e lirë dhe rrjedhën e lirë të informacionit. Për ta ndërtuar këtë njohuri nevojitet të mblidhen, analizohen e hulumtohen të dhëna sasiore dhe cilësore.²⁶

Fillimisht duhet të mblidhen të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë, por edhe sipas identiteteve tjera ndërsektoriale. Të dhënat e tilla janë të

nevojshme për të siguruar që zgjidhjet me të cilat do dilet të kenë parasysh kompleksitetin dhe larinë e mënyrave në të cilat dhuna ndikon tek gratë dhe se si ushtrohet dhuna strukturore ndaj grupeve të caktuara në shoqëri.

Ndër fushat kryesore të hulumtimit janë mbledhja e të dhënave që bën dallimin ndërmjet formave të ndryshme të abuzimit në internet, ashpërsisë së sulmeve në internet dhe ndikimit të kësaj dhune në të drejtat dhe punën e gazetareve. Identifikimi i pengesave dhe rreziqeve specifike gjinore dhe të kuptuarit e mënyrës se si këto të fundit dallojnë nga ato me të cilat përballen kolegët e tyre meshkuj do të formonin bazën për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe reagime tjera të mundshme.

Në rrethana ideale, mbledhja e të dhënave do të duhej të bëhet në bashkëpunim me organet kombëtare të statistikave, universitetet, institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut dhe grupet e shoqërisë civile, për të siguruar informata më të sakta dhe të pavarura, si dhe për të siguruar të drejtën e privatësisë.²⁷ Përveç të shërbyerit si bazë për përcaktimin e veprimeve në nivel kombëtar, mbledhja e të dhënave do të ishte e dobishme për të informuar mekanizmat ndërkombëtarë. Për shembull, treguesi 16.10.1. i rishikimeve vullnetare kombëtare (RVK) të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm (OZHQ) u kërkon autoriteteve të raportojnë numrin e sulmeve kundër gazetarëve në vendet e tyre përkatëse.²⁸

Veç kësaj, mbledhja e të dhënave mund të shërbejë si pikëmbështetje për fushata të forta të ndërgjegjësimit të publikut, duke dëshmuar se ngacmimi dhe abuzimi në internet nuk është vetëm sulm ndaj gazetarëve, por edhe sulm ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, dhe kërcënim ndaj së drejtës së çdo personi dhe shoqërisë në tërësi për të pasur qasje në informata.²⁹

Hap tjetër i rëndësishëm drejt përmirësimit të njohjes së problemit nga publiku i gjerë është informimi edukativ. Përdorimi dhe trendet e rrjeteve

sociale mund të integrohen në kurrikulën arsimore nga autoritetet arsimore, ose të përfshihen në programet e edukimit mbi mediat. Mund të zhvillohen dhe zbatohen programe të arsimit për të rritur dhe atij joformal që promovojnë edukimin digjital të mediave dhe shoqërisë. Një gasje e këtillë mund të kontribuojë në krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë, përfshirë këtu edhe gazetaret.

Si pjesë e strategjisë së ndërgjegjësimit të publikut, zyrtarët qeveritarë duhet të nxjerrin deklaratat publike, përfshirë postime në rrjete sociale po të jetë e zbatueshme, për të shprehur mbështetje për gazetarët e shënjestruar, dhe të organizojnë aktivitete për ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth rolit të gazetarisë dhe ndikimit negativ të sulmeve ndaj gazetarëve në shoqëri. Ditët ndërkombëtare përkujtimore si Dita Botërore e Lirisë së Shtypit (3 maj), Dita Ndërkombëtare për t'i Dhënë Fund Mosndëshkimit të Krimeve kundër Gazetarëve (2 Nëntor), Dita Ndërkombëtare e Gruas (8 Mars) dhe Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (25 Nëntor) përbëjnë mundësi të mirë për aktivitete të tilla.

Shembuj

Krijimi i paneleve në përbërje të ekspertëve ligjorë: Mbretëria e Bashkuar ka krijuar një [Panel të pavarur të nivelit të lartë të ekspertëve ligjorë](#) me qëllim të realizimit të hulumtimeve për të shërbyer si bazë për hartimin e legjislacionit dhe politikave mbi sigurinë e gazetarëve.

³⁰Raporti i tyre i parë, i botuar në shkurt të vitit 2020, përqendrohet në [Përdorimin e sanksioneve për t'i mbrojtur gazetarët](#).³¹

Hartimi i programeve të edukimit medial: Një raport i përgatitur nga ekspertë kombëtarë të Observatorit Evropian Audiovizual për Komisionin Evropian u referohet [547 projekteve të edukimit medial](#)

të realizuara në shtetet anëtare të BE që nga viti 2010. Shkathtësitë e edukimit medial të lidhura me mendimin kritik janë adresuar nga 403 sosh, gjersa ato që kanë të bëjnë me kapacitetet e përdorimit të mediave kanë qenë pjesë e 385 projekteve nga gjithsej 547.³²

Finlanda ka një politikë kombëtare për promovim të të kuptuarit të mjedisit të mediave në internet dhe jashtë internetit, si edhe të rrjeteve sociale, që synon institucionet formale dhe joformale të arsimit, mediat dhe aktorë tjerë përkatës.³³

› **Të raportohet mbi sigurinë e gazetareve tek mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe të integrohet kjo çështje në politikën e jashtme**

Përmes pjesëmarrjes së tyre në organizatat ndërqeveritare (ONQ), Shtetet mund të luajnë një rol konstruktiv në kontribuimin për zhvillim të standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetareve. Shtetet duhet të sugjerojnë përfshirjen e çështjes së sigurisë së gazetareve dhe një qasjeje të përgjegjshme gjinore më të fortë në shumë rezoluta, rekomandime dhe vendime të miratuara nga ONQ-të.

Gjithashtu, Shtetet mund të kontribuojnë dhe të angazhohen në mënyrë aktive me trupat përkatëse të traktateve ndërkombëtare që përqendrohen në barazinë gjinore, të tilla si Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas ose Komisioni i OKB-së për Statusin e Grave (KSG). Mes tjerash, KSG monitoron progresin në zbatimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim të Pekinit, që njeh rëndësinë e promovimit të grave në industrinë e medias dhe integrimin e perspektivës gjinore në përmbajtjen mediale.³⁴

Një zotim i rëndësishëm në kuptimin e përgjegjësive që Shtetet kanë përballë standardeve ndërkombëtare është detyrimi i tyre për të raportuar mbi zbatimin e tyre. Raportimi i konsoliduar mirë siguron matje të progresit drejt përmbushjes së qëllimeve ose detyrimeve, por shërben njëherazi si mjet për dokumentim të trendeve, përfshirë nivelet e mosndëshkimit dhe praktikat e mira. Shtetet mund ta përmirësojnë më tej sasinë dhe cilësinë e të dhënave të raportuara në lidhje me dhunën ndaj gazetarëve (në bashkëpunim me aktorë joqeveritarë që mbledhin të dhëna dhe bëjnë hulumtime) kur marrin pjesë në mekanizmat e mëposhtëm.

Shembuj të mekanizmave

[Rishikimi periodik universal](#) (RPU).³⁵ Në kuadër të procesit të RPU, Shtetet duhet të raportojnë mbi situatën e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar, pas së cilës anëtarët e KDNJ të OKB-së japin rekomandime për përmirësim. Ky proces ofron një mundësi të shkëlqyeshme për ta bërë sigurinë e grave gazetarë jashtë internetit dhe në internet prioritet për të gjitha Shtetet.

- Me rastin e dhënies së kontributit për [raportet](#) e rregullta të KDNJ dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi zbatimin e rezolutave të KDNJ të OKB-së dhe të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (APOKB) mbi sigurinë e gazetarëve, Shtetet mund të nxjerrin gjithashtu në pah sfidat me të cilat përballen gazetaret.³⁶
- E njëjta gjë vlen edhe për [raportet tematike, komunikatat dhe thirrjet urgjente](#) që nxirren në kuadër të procedurave të posaçme të KDNJ të OKB-së, në veçanti për Raportuesin e Posaçëm për Promovimin dhe Mbrojtjen e së Drejtës për Liri të Mendimit dhe Shprehjes, si dhe institucionet e tjera mandatet e të cilave mund të mbulojnë dhunën ndaj gazetarëve.³⁷

- Në [Rishikimet kombëtare vullnetare](#) mbi zbatimin e OZHQ-ve, dhe në veçanti për OZHQ 5 (barazia gjinore dhe fuqizimi i grave) dhe OZHQ 16 (promovimi i shoqërive të drejta, paqësore dhe gjithëpërfshirëse), Shtetet duhet të përfshijnë të dhëna mbi sigurinë e gazetarëve të kategorizuara sipas gjinisë.³⁸
- Në përgjigje të kërkesave të UNESCO-s për informata rreth statusit gjyqësor të vrasjeve të gazetarëve, [Raporti i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s mbi sigurinë e gazetarëve dhe rrezikun e pandëshkueshmërisë](#) i mundëson OKB-së, e mandatuar me mbrojtjen e lirisë së shprehjes, të monitorojë trendet që ndikojnë në sigurinë e gazetarëve.³⁹ Veç kësaj, UNESCO mbledh një gamë më të gjerë të kontributeve për [Raportin për trendet botërore](#) në lidhje me lirinë e shprehjes dhe zhvillimin e mediave, që përmban informata rreth ngacmimeve në internet ndaj gazetarëve.⁴⁰ Përveç sigurimit të të dhënave, Shtetet mund të ndihmojnë në promovimin e gjetjeve të këtyre raporteve.
- Shtetet anëtare të KiE duhet t'u përgjigjen alarmeve në [Platformën e Këshillit të Evropës për promovimin e mbrojtjes së gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve](#). Platforma monitoron incidente të veçanta kundër gazetarëve dhe kërkon përgjigjet e Shteteve.⁴¹
- Nismat shumëpalëshe, si [Partneriteti për qeverisje të hapur](#), [Koalicioni për liri online](#), [Komuniteti i demokracive](#) dhe [Koalicioni për liri të medias](#), mund të shërbejnë si forume të mira për promovimin e diskutimeve mbi politikat për adresimin e sigurisë së gazetarëve në internet.

Përveç këtyre mekanizmave ndërkombëtarë, përfaqësitë diplomatike në vendet e tjera mund të mobilizohen për të promovuar ngjarje publike, për të nxjerrë deklarata publike dhe për të mbështetur nisma lokale

ose rajonale që promovojnë sigurinë e gazetarëve. Mënyrë tjetër jetike e reagimit është lehtësimi i kërkesave për viza dhe azil të bëra nga gazetaret të cilat janë cak i kërcënimeve.

Shembuj

Përfshirja e SOFJO në rishikimet periodike universale (RPU):

Deri në shtator 2019, pasi 84 shtete kishin kaluar nëpër procesin e RPU, 43 sosh e kishin përfshirë çështjen e sigurisë së gazetarëve në rekomandimet e tyre. Ndër shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që morën rekomandime mbi sigurinë e gazetarëve ishin Kirgizistani, Mali i Zi, Federata Ruse dhe Turkmenistani. Ndër Shtetet pjesëmarrëse që ishin të zëshme për këtë çështje, më aktivja ishte Republika Çeke, pasuar nga Austria, Kanadaja, Franca, Lituania dhe Norvegjia.⁴² Për shembull, Sllovenia rekomandoi Meksikës që të integrojë perspektivën gjinore me rastin e adresimit të sigurisë së gazetarëve.

Grupet joformale ndërqeveritare: Disa Shtete, në cilësinë e tyre si anëtare ose pjesëmarrëse të nismave ndërqeveritare, kanë krijuar grupe joformale për sigurinë e gazetarëve. Qëllimi i tyre është të bashkëpunojnë për rritjen e vëmendjes ndaj çështjes. Grupe të tilla joformale për bashkëpunim mbi këtë çështje ekzistojnë në zyrat e OKB-së në Gjenevë dhe Nju Jork, UNESCO dhe OSBE.⁴³ Përveç bashkërendimit të përpjekjeve të tyre rreth rezolutave dhe veprimeve të tjera të politikave, këto grupe organizojnë aktivitete për të tërhequr vëmendjen ndaj kësaj çështje. Për shembull, në vitin 2019, Grupi i Miqve i UNESCO-s (GM) për sigurinë e gazetarëve organizoi një konferencë mbi ngacmimet në internet ndaj gazetarëve.⁴⁴ Në të njëjtin vit, GM në selinë e OKB-së në Nju Jork organizoi një ngjarje mbi sigurinë e gazetarëve dhe OZHQ-të.

Bërja e deklaratave të politikave: Në vitet [2018](#) dhe [2019](#), grupi jozyrtar i miqve të OSBE-së për sigurinë e gazetarëve nxori deklarata ku shprehu shqetësimet për dhunën ndaj gazetarëve.⁴⁵

Burime

- Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka një [bazë të të dhënave](#) me rekomandime për të drejtat e njeriut që janë nxjerrë nga sistemi i OKB-së për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, burim ky i çmuar për hartimin e politikave publike.⁴⁶
- Raporti i ARTICLE 19 [Dhënia fund mosndëshkimit: Ndërmarrja e veprimeve sipas standardeve të OKB-së për sigurinë e gazetarëve](#) përmbledh standardet më të fundit në lidhje me sigurinë e gazetarëve, përfshirë rekomandime për adresimin e dhunës ndaj gazetarëve në internet dhe jashtë internetit.⁴⁷ Ai përmban një kapitull mbi qasjet e përgjegjshme gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve.
- Koalicioni i shteteve pjesëmarrëse në Partneritetin për Qeveri të Hapur ka hartuar një raport global mbi [Hapësira Qytetare: Mbrojtja e aktivistëve dhe gazetarëve](#), që përmban një sërë praktikash të mira për sigurinë e gazetarëve të vendosura nga Shtetet.⁴⁸
- Përmes nismës së [Media4Democracy](#), BE ka mbështetur delegacionet e saj në mbarë botën për t'i kuptuar më mirë sfidat përballë lirisë së medias dhe për të forcuar lirinë e shprehjes. Këtu përfshihet [Doracaku për delegacionet e BE-së: Mbrojtja e sigurisë së gazetarëve, mbrojtja e lirisë së shprehjes](#) që ofron udhëzime teknike lidhur me marrjen e masave për sigurinë e gazetarëve.⁴⁹


- Komuniteti i Demokracive ka publikuar një [Pako veglash për personelin e misioneve diplomatike lidhur me sigurinë e gazetarëve](#), që përmban veprime konkrete për promovimin e sigurisë së gazetarëve, si dialogu i rregullt me autoritetet dhe gazetarët, sigurimi i mbështetjes emergjente kur është e nevojshme, monitorimi i gjykimeve të gazetarëve ose sulmuesve të tyre, si dhe lehtësimi i lëshimit të dokumenteve të udhëtimit dhe vizave.⁵⁰
- Komisioni për Liritë Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme i Parlamentit Evropian ka botuar udhëzuesin [Siguria e gazetarëve dhe luftimi i korrupsionit në BE](#) ku shtjellohen masa të ndryshme rregullatore dhe masa të tjera për t'iu kundërvënë sulmeve kundër gazetarëve në Bashkimin Evropian.⁵¹

Shënime fundore

- 1 OSCE, Ministerial Council Decision No. 3/18, “Safety of Journalists”, 7 December 2018, <https://www.osce.org/chairmanship/406538?download=true>.
- 2 Elisabeth Witchel, “Shared responsibility: Safeguarding press freedom in perilous times”, International Media Support (IMS), 2020, <https://www.mediasupport.org/publication/shared-responsibility-safeguarding-press-freedom-in-perilous-times/>
- 3 UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity, UNESCO, CI-12/CONF.202/6, 2012, <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists>.
- 4 “Defending Free Speech - measures to protect journalists, elected representatives and artists from exposure to threats and hatred”, Swedish Ministry of Culture, 2018, <https://www.government.se/4990f9/contentassets/bd181f7bof4640e7920807d110b3c001/action-plan-defending-free-speech.pdf>. Fojo Media Institute, help-desk for journalists, <https://fojo.se/verkytyg-for-journalister/demokratijouren/helpdesk/>.
- 5 “Audit of freedom of expression in the Netherlands”, University of Amsterdam, Institute for Information Law, 2018, <https://www.ivir.nl/projects/auditoffreedomofexpression/>.
- 6 Council of Europe, Committee of Ministers, “Recommendation No. 4 on the protection of journalism and safety of journalists and other media actors”, CM/Rec(2016)413, April 2016, https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrolvovsJ/content/recommendation-cm-rec-2016-4-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-protection-of-journalism-and-safety-of-journalists-and-other-media-.
- 7 “Violence, threats and pressures against journalists and other media actors in the EU”, Contribution to the second Annual Colloquium on Fundamental Rights, European Union Agency for Fundamental Rights, November 2016, https://ec.europa.eu/information_society/news-room/image/document/2016-47/fra_threats_and_pressures_paper_19751.pdf.
- 8 “Journalists’ Safety Indicators: National Level; based on the UNESCO’s Media Development Indicators”, UNESCO, 2015, <https://en.unesco.org/themes/safety-of-journalists/journalists-safety-indicators>.
- 9 UNESCO, Applying UNESCO’s Journalists’ Safety Indicators (JSIs): A practical guidebook to assist researchers, 2015, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pfo000260894>.
- 10 UN Women, Handbook for National Action Plans on Violence against Women, 2012, <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2012/7/handbooknationalactionplansonvaw-en%20pdf.pdf?la=en&vs=1502>.
- 11 UN Women, How to Manage Gender-Responsive Evaluation, UN Women Independent Evaluation Office, 2015, <https://genderevaluation.unwomen.org/-/media/files/un%20women/gender%20evaluation/handbook/evaluationhandbook-web-final-30apr2015.pdf?la=en&vs=4246>.
- 12 UN Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, OSCE Representative on Freedom of the Media, the Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and the African Commission on Human and Peoples’ Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information, “Joint Declaration on Crimes against Freedom of Expression”, 25 June 2012, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/91595>.
- 13 Alberto Spampinato, Italy: So Much Mafia, So Little News, European Center for Media and Freedom and Osservatorio Balconi e Caucaso, 2018, <https://adobeindd.com/view/publications/4fd5f1fc-0f8c-4186-9565-dd3217e63b28/bndf/publication-web-resources/pdf/ECPMF-FFM-Italy.pdf>.
- 14 Presveilig, Steering Group on Aggression and Violence against Journalists, <https://www.persveilig.nl/>.

- 15 “Serbia: Commission to solve wartime journalists’ murders expanded”, European Federation of Journalists, <https://europeanjournalists.org/blog/2018/08/09/serbia-commission-to-solve-war-time-journalists-murders-expanded/>.
- 16 Media Freedom Rapid Response, <https://www.mfrr.eu/>.
- 17 ProtectDefenders.eu, <https://www.protectdefenders.eu>.
- 18 Unidad Nacional de Protección, <https://t.unp.gov.co/>.
- 19 “Conoce a la Fiscalía Especial para la Atención de Delitos cometidos contra la Libertad de Expresión”, Fiscalía General de la República, 2019, <https://www.gob.mx/fgr/documentos/conoce-a-la-fiscalia-especial-para-la-atencion-de-delitos-cometidos-contra-la-libertad-de-expresion>.
- 20 Human Rights Council, Report on its 24th session, A/HRC/24/2, 24 January 2014, <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session24/Pages/ListReports.aspx>, <https://rm.coe.int/cyprus-2020-safety-of-journalists/168097fa83>.
- 21 Peter Noorlander, “Taking Action to Protect Journalists and Other Media Actors: Artificial Intelligence – Intelligent Politics Challenges and opportunities for media and democracy”, Background Paper for the Council of Europe Ministerial Conference 2020, <https://rm.coe.int/cyprus-2020-safety-of-journalists/168097fa83>.
- 22 “New global study documents best practices on the safety of journalists”, IMS news item, 30 October 2019, <https://www.mediasupport.org/new-global-study-documents-best-practices-on-the-safety-of-journalists/>.
- 23 Silvia Chocarro, “The safety of women journalists: Breaking the cycle of silence and violence”, IMS Defending Journalism book series, International Media Support, October 2019, <https://www.mediasupport.org/publication/the-safety-of-women-journalists/>.
- 24 Media Freedom Rapid Response, “Protecting Journalists and Media Workers: Good Practice”, 2020, <https://www.mfrr.eu/wp-content/uploads/2020/06/MFRR-UK-Recommendations-Good-Practice.pdf>.
- 25 Natalia Torres and Eduardo Bertoni, Institutional Design and Effectiveness of the Agencies Charged with Protecting Journalists and Investigating Crimes against the Press: Mexico, Colombia and Guatemala: Universidad de Palermo, 2012, <https://www.palermo.edu/cele/cele/pdf/english/Internet-Free-of-Censorship/Institutional-Design.pdf>.
- 26 Op. cit. endnote 1.
- 27 OSCE RFoM, “Recommendations following the Expert Meeting New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists”, 17 September 2015, <https://www.osce.org/fom/19356?download=true>.
- 28 UN Sustainable Development Goals (SDGs), SDG 16: Promote peaceful and inclusive societies for sustainable development, provide access to justice for all and build effective, accountable and inclusive institutions at all levels, 2015, <https://sustainabledevelopment.un.org/sdg16>, <https://www.osce.org/fom/22041?download=true>.
- 29 “New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists”, OSCE RFoM, 2016, <https://www.osce.org/fom/22041?download=true>.
- 30 “IBAHRI Secretariat to the High Level Panel of Legal Experts on Media Freedom”, International Bar Association, https://www.ibanet.org/IBAHRI_Secretariat.aspx.
- 31 International Bar Association, IBAHRI Secretariat to the High Level Panel of Legal Experts on Media Freedom, Report on the Use of Targeted Sanctions to Protect Journalists, <https://www.ibanet.org/Document/Default.aspx?DocumentUid=1734a793-fd31-452d-84ca-b85efc4af744>.
- 32 Martina Chapman, “Mapping of media literacy practices and actions in EU-28”, Council of Europe, European Audiovisual Observatory, 2016, p. 28 and 39, <https://rm.coe.int/1680783500>.
- 33 Robert Tomljenovic, “Regulatory Authorities for Electronic Media and Media Literacy - Comparative analysis of the best European practices”, Council of Europe, 2018, <https://rm.coe.int/regulatory-authorities-for-electronic-media/1680903a2a>.
- 34 UN, Beijing Declaration and Platform for Action, 15 September 1995, https://www.un.org/en/events/pastevents/pdfs/Beijing_Declaration_and_Platform_for_Action.pdf.

- 35 “Universal Periodic Review”, United Nations Human Rights Council, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/upr/pages/uprmain.aspx>.
- 36 “Resolutions on Journalists’ Safety: How Does the UN Monitor their Implementation?”, IFEX news item, 22 December 2017, <https://ifex.org/resolutions-on-journalists-safety-how-does-the-un-monitor-their-implementation/>.
- 37 “Special Procedures of the Human Rights Council”, UN Human Rights, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/sp/pages/welcomepage.aspx>.
- 38 “Voluntary National Reviews Database”, UN Sustainable Development Knowledge Platform, <https://sustainabledevelopment.un.org/vnrs/>.
- 39 UNESCO, Director-General’s Report on the Safety of Journalists and the Danger of Impunity, 2018, <https://en.unesco.org/themes/safety-journalists/dgreport>.
- 40 “World Trends in Freedom of Expression and Media Development”, UNESCO, <https://en.unesco.org/world-media-trends>.
- 41 “Platform to promote the protection of journalism and safety of journalists”, Council of Europe, <https://www.coe.int/en/web/media-freedom>. Austria, Canada, Denmark, Estonia, France, Germany, Greece, Latvia, Lithuania, Montenegro, the Netherlands, Norway, Sweden, the United Kingdom, and the United States of America.
- 42 UNESCO, Intensified attacks, new defences: developments in the fight to protect journalists and end impunity, In Focus edition of the World Trends in Freedom of Expression and Media Development, Paris, 2019, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000371487>.
- 43 “OSCE delegations establish a Group of Friends on Safety of Journalists”, US Mission to the OSCE news item, 23 April 2018, <https://osce.usmission.gov/osce-delegations-establish-a-group-of-friends-on-safety-of-journalists/>. “Groups of Friends on the Safety/Protection of Journalists publish joint statement on safety of journalists and access to information during the COVID-19 pandemic”, UNESCO news, 14 April 2020, <https://en.unesco.org/news/groups-friends-safe-protection-journalists-publish-joint-statement-safety-journalists-and>.
- 44 “UNESCO Conference tackles online harassment of female journalists”, UNESCO news item, 12 June 2019, <https://en.unesco.org/news/unesco-conference-tackles-online-harassment-female-journalists>.
- 45 In 2020, the following OSCE participating States are part of the OSCE Group of Friends on the Safety of Journalists: Austria, Canada, Denmark, Estonia, France, Germany, Greece, Latvia, Lithuania, Montenegro, the Netherlands, Norway, Sweden, the United Kingdom, and the United States of America.
- 46 Universal Human Rights Index, <https://uhri.ohchr.org/>.
- 47 ARTICLE 19, “Ending Impunity: Acting on UN Standards on the Safety of Journalists,” 2019, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2019/11/SOJ-Web.pdf>.
- 48 “Defending Journalists and Activists”, Open Government Partnership, <https://www.opengovpartnership.org/policy-area/defending-journalists-and-activists-expression/>.
- 49 Media4Democracy, Handbook for EU delegations: “Protecting the safety of journalists, protecting freedom of expression”, 2020, <https://media4democracy.eu/wp-content/uploads/2020/07/Final-M4D-Safety-of-Journalists-Handbook.pdf>.
- 50 Community of Democracies, “Toolkit: On the Safety of Journalists for the Personnel of the Diplomatic Missions”, March 2017, <https://community-democracies.org/app/uploads/2018/06/Toolkit-Safety-of-Journalists-1-1.pdf>.
- 51 Tarlach McGonagle, Safety of Journalists and the Fighting of Corruption in the EU, European Parliament, Brussels, 2020, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/655187/IPOL_STU\(2020\)655187_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/655187/IPOL_STU(2020)655187_EN.pdf)



**Dega legjislative
e qeverisë**

Veprimet e propozuara

1. Të rishikohen dhe, po të jetë e nevojshme, të plotësohen e ndryshohen ose miratohen ligje për të promovuar një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve;
2. Të sigurohet se legjislacioni që adreson ngacmimin dhe abuzimin në internet ndaj gazetarëve të mos minojë të drejtën për lirinë e shprehjes.

2. Dega legislative e qeverisë

Miratimi ose përshtatja e kornizave ligjore për një mjedis më të sigurt në internet dhe jashtë internetit

Dega legislative është kuvendi diskutues me autoritetin për të bërë ligje. Kjo pjesë përqendrohet në mënyrën në të cilën ligjvënësit mund të miratojnë ligje që mundësojnë një mjedis të sigurt në internet dhe jashtë internetit në nivel kombëtar për gazetaret, në përputhje me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, përfshirë [Vendimin nr. 3/18 të Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve](#).¹

[Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së](#) u bën thirrje shteteve që “ligjet, politikat dhe praktikat e tyre që lidhen me lirinë e medias t’i bëjnë në përputhshmëri të plotë me detyrimet dhe zotimet e tyre ndërkombëtare dhe t’i rishikojnë, e sipas nevojës, shfuqizojnë ose ndryshojnë ato ashtu që të mos e kufizojnë mundësitë e gazetarëve për të kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje të panevojshme.”

- › **Të rishikohen dhe, po të jetë e nevojshme, të plotësohen e ndryshohen ose miratohen ligje për të promovuar një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve**

Të paturit e legjislacionit të duhur për mbrojtjen e gazetarëve fillon me një kornizë ligjore që njeh dhe mbron në mënyrë adekuate të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtën për lirinë e shprehjes.² Mënyra në të cilën gazetaret po bëhen cak i sulmeve, qoftë në internet apo jashtë

internetit, është e lidhur në thelb me diskriminimin strukturor e të rënjosur thellë. Shtetet kanë një detyrim pozitiv për ta adresuar këtë.

Ligjvënësit duhet të sigurojnë që autoritetet shtetërore t'i përmbushin detyrimet sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: për të parandaluar sulmet, për t'i mbrojtur ata që janë cak i dhunës, si dhe për të ndjekur penalisht autorët e krimeve dhe për të siguruar mjete juridike. Legjislacioni që parashih krijimin e mekanizmave kombëtarë të mbrojtjes për gazetarët duhet të ngërthejë një mekanizëm të përgjegjshëm gjinor.

Shumë vende kanë në fuqi ligje që tashmë mund të kenë zbatuar dhe penalizuar disa lloje të ngacmimeve dhe abuzimeve në internet. Aty ku ligjet ekzistojnë, por që nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme, krijimi i ligjeve të reja duhet të jetë zgjidhja e fundit. Në vend të kësaj, duhet të mendohet për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve ekzistuese. Për më tepër, ligjet duhet të rishikohen për të siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, është thelbësore që të merren po ashtu në konsideratë një gamë e larmishme e mjeteve juridike në të drejtën civile dhe administrative, jo domosdoshmërisht vetëm e drejta penale.

Procesi i rishikimit, reformimit ose bërjes së ligjeve duhet të përfshijë konsultime të gjera me sektorin e medias, publikun dhe organizatat e shoqërisë civile, në kuadër të qëllimit për të siguruar mbrojtjen e duhur të të drejtave të grave për jetë, mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues, barazi, mosdiskriminim, liri të shprehjes dhe privatësi. Në këtë përpjekje, do të ishte e dobishme të sigurohet mbështetje e ekspertëve nga organet ndërqeveritare ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë Përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias (PLM), komunitetin akademik dhe atë ligjor.

Shembuj

Përdorimi i ligjeve ekzistuese: Disa shtete kanë përdorur legjislacionin ekzistues për t'i ndjekur penalisht ngacmuesit në internet të gazetareve. PLM i OSBE-së, në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Shtypit (INSH), ka analizuar dhe krahasuar tre raste të tilla në raportin e vitit 2019 [Përgjigjet ligjore ndaj ngacmimit dhe abuzimit në internet të gazetarëve - Perspektiva nga Finlanda, Franca dhe Irlanda](#).³ Siç theksohet në raport, një prej autorëve u ndoq penalisht për shpifje penale, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes, të cilat rekomandojnë dekriminalizimin e shpifjes. Në [Kanada, Finlandë, Francë, Gjermani dhe Spanjë](#) ligjet ekzistuese ndalojnë cenimin e privatësisë, kërcënimet, mesazhet keqdashëse, përcjelljen nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, ngacmimin në internet, zbulimin dhe shpërndarjen e të dhënave të paautorizuara, dhe forma të tjera të ngacmimit.⁴

Burime

- Udhëzuesi i Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) [Hartimi i ligjeve që funksionojnë për gratë dhe burrat: Udhëzues praktik për legjislacion me ndjeshmëri gjinore](#) ofron këshilla të dobishme për atë se si të krijohen ligje që funksionojnë si për burrat ashtu edhe për gratë.⁵
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ka hartuar një [Doracak për integrimin dhe zbatimin e barazisë gjinore në jetën publike](#) që përmban një kapitull mbi praktikën e ndjeshme gjinore në parlament.⁶

- Unioni Ndërparlamentar ka botuar një [Doracak mbi lirinë e shprehjes për parlamentet dhe deputetët: Rëndësia dhe fushëveprimi i mbrojtjes](#), që mund të jetë i dobishëm për ligjvënësit që hartojnë ligje për mbrojtjen e gazetarëve.⁷

› **Të sigurohet se legjislacioni që adreson ngacmimin dhe abuzimin në internet ndaj gazetarëve të mos minojë të drejtën për lirinë e shprehjes**

Interneti përbën një platformë të paprecedent për ushtrimin e lirisë së shprehjes. Zhvillimet legjislative në lidhje me ngacmimin dhe abuzimin në internet ndaj gazetarëve duhet ta njohin këtë fakt.

Liria e shprehjes shtrihet jo vetëm në idetë dhe informacionet që zakonisht konsiderohen si jo fyese, por edhe në ato që mund të ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë.⁸ Legjislacioni duhet të njohë faktin që çdo masë që mund ta kufizojë të drejtën për liri të shprehjes duhet të jetë e paraparë me ligj, t'i shërbejë një qëllimi legjitim, si dhe të jetë e domosdoshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike,⁹ sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e së Drejtës për Liri të Mendimit dhe Shprehjes ka paralajmëruar se përpjekjet për të promovuar sigurinë e gazetarëve në internet mund të çojnë pa dashje në “censurë ose kufizime të padrejta që mund të shpijnë në minimin e të drejtave të vetë grave nga të cilat qeveritë mund të kërkojnë dëmshpërblim.”¹⁰ Për shembull, ligjet dhe rregulloret e formuluar në mënyrë të paqartë që ndalojnë lakuriqësinë ose sjelljet e pahijshme mund të kenë një efekt domethënës dhe tronditës në diskutimet kritike rreth seksualitetit, gjinisë dhe shëndetit riprodhues.¹¹

Nga ky këndvështrim, duke marrë parasysh rreziqet e kufizimit të shprehjes legjitime, është e dobishme të theksohet fakti që në mesin e trupave tjera ndërkombëtare, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka ngritur shqetësime specifike në lidhje me abuzimin e së drejtës penale për t'i shënjestruar gazetarët, hulumtuesit dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut të cilët ndajnë informata me interes publik legjitim.¹² Në një shoqëri demokratike, ligji penal duhet të zbatohet vetëm si mjet i fundit dhe vetëm në rastet më të rënda. Prandaj, Shtetet duhet të përpiqen që të përdorin gjithmonë masa civile ose administrative më pak kufizuese.¹³

Në disa raste, Shtetet kanë paraparë dispozita ligjore penale mbi “gjuhën e urrejtjes” për trajtimin e ngacmimit dhe abuzimit me bazë gjinore në internet ndaj grave, përfshirë ndaj gazetarëve. E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk parasheh ndonjë përkufizim uniform të “gjuhës së urrejtjes”, prandaj ligjet e tilla mund të keqpërdoren dhe të krijojnë kufizime të paligjshme të së drejtës për lirinë e shprehjes, ose të abuzohen për të mundësuar shkeljen e shprehjeve të ligjshme. I gjithë legjislacioni duhet të përcaktojë me saktësi termat që përbëjnë përmbajtje të ndaluar sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Gjithashtu, ai duhet t'i rezistojë kriminalizimit të një gjuhe të këtillë, përveçse në situatat më të rënda, të tilla si mbështetja e urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësi ose dhunë,¹⁴ dhe në vend të kësaj të miratojë interpretimet e përfshira në Planin e veprimit të Rabatit.¹⁵

Në disa raste, ligjet për shpifje janë përdorur për të adresuar raste të ngacmimit dhe abuzimit në internet. Këto terma nganjëherë ngatërrohen, por shpifja ka të bëjë me dëmtimin thelbësor të reputacionit të dikujt bazuar në deklarime të rreme të fakteve. Gjithsesi, duhet të theksohet se mbrojtja e reputacionit duhet të adresohet ekskluzivisht përmes ligjit civil

kundër shpifjes, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹⁶ Shpifja duhet të dekriminalizohet në të gjitha Shtetet.

Disa dispozita të së drejtës civile mund të gjejnë zbatim si përgjigje ndaj ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetareve. Shembuj të tillë përfshijnë ligjet në lidhje me shkeljen e privatësisë ose konfidencialitetit ose të së drejtës për mbrojtjen e sigurisë së një personi. Gjatë kërkimit të një mjeti juridik specifik për dëmin e shkaktuar nga forma specifike të ngacmimit dhe abuzimit në internet, gazetarët mund t'u referohen edhe këtyre masave të së drejtës civile.¹⁷

Në mbrojtjen e gazetareve, kriptimi dhe anonimiteti janë të një rëndësie thelbësore ngaqë u ofrojnë më shumë mundësi për të ushtruar të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes pa ndërhyrje të panevojshme nga aktorë shtetërorë ose jo shtetërorë,¹⁸ përfshirë këtu praktikën e përcjelljes dhe ngacmimit të drejtpërdrejtë. Zhvillimet legjislativë që adresojnë ngacmimin dhe abuzimin në internet ndaj gazetareve nuk duhet të vendosin ndalesa të kriptimit dhe anonimitetit, ose të identifikimit të detyrueshëm të përdoruesve të internetit.¹⁹ Gazetarët gëzojnë të drejtën e anonimitetit në internet si pjesë e së drejtës së tyre për privatësi.

Në fund, legjislacioni duhet të ruajë dhe të ndjekë parimet dhe standardet mbi përgjegjësinë e kushtëzuar të ndërmjetësve të internetit. Kjo do të thotë se ata nuk duhet të jenë përgjegjës për përmbajtjen e palës së tretë kur nuk janë përfshirë në modifikimin e përmbajtjes në fjalë dhe se Shtetet mund t'u kërkojnë atyre vetëm të heqin përmbajtjen me urdhër gjykatë.

Shembuj

Propozimi i përgjigjeve të shkallëzuara: Propozimi i Komisionit Ligjor të Irlandës artikulon një shumëllojshmëri masash (përgjigje e shkallëzuar) që u jep përparësi programeve edukative dhe masave ligjore civile para ligjit penal.²⁰ Një qasje e këtillë do të ndihmonte për të siguruar që çdo ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes e shkaktuar nga ligjet kundër ngacmimit në internet të jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar nga vepra e ngacmimit.

Ndryshimi i legjislacionit: Në vitin 2018, Franca ndryshoi [Kodin penal të](#) saj për të mundësuar ndjekjen penale të ngacmimit të kryer nga një grup njerëzish ose përmes përdorimit të shërbimeve të komunikimit në internet.²¹

Përdorimi i ligjeve ekzistuese: Në vitin 2018, [Irlanda](#) përdori ligjet ekzistuese kundër ngacmimit për të ndjekur penalisht një individ për “ngacmim të pamatur” në internet të një gazetareje. Aktakuza u ngrit sipas Ligjit të vitit 2010 për veprat jofatale që kryhen ndaj një personi, që mundëson ndjekjen penale të individëve për ngacmime të kryera “në çfarëdolloj mënyre”. Rasti dëshmon se dispozitat e tilla mund të zbatohen në rastet kur janë përdorur forma të komunikimit në internet.²²

Përfshirja e dispozitave që zbatohen për format e ngacmimit në internet: Në Gjermani, dispozitat e [Kodit Penal](#) mbi veprat e përcjelljes përfshijnë përpjekje të paautorizuara për ta kontaktuar personin tjetër me anë të mjeteve të telekomunikimit dhe përdorimin jo të duhur të të dhënave të një personi tjetër për t'i nxitur palët e treta që ta kontaktojnë atë person.²³

Dekriminalizimi i shpifjes: Që nga viti 2009, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë shënuar përparim në dekriminalizimin e ligjeve për shpifje dhe/ose fyerje penale. Që nga viti 2017, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në vijim shfuqizuan dispozitat e përgjithshme për shpifjen penale: Armenia, Bosnja dhe Hercegovina, Qipro, Estonia, Gjeorgjia, Irlanda, Kirgizistani, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Rumania, Taxhikistani, Mbretëria e Bashkuar dhe Ukraina.²⁴

Burime

PLM i OSBE-së dhe INSH kanë publikuar një raport mbi [Reagimet ligjore ndaj ngacimit dhe abuzimit në internet të gazetarëve: Perspektivat nga Finlanda, Franca dhe Irlanda](#), që shqyrton përgjigjet ligjore për ngacimin dhe abuzimin në internet të gazetarëve në Finlandë, Francë dhe Irlandë.²⁵

- PLM i OSBE-së publikon analiza ligjore të legjislacionit përkatës me rekomandime për autoritetet, si për shembull [Projektligji i Austrisë për kujdes dhe përgjegjësi në internet](#);²⁶ [Ligji i Ukrainës për mediat](#);²⁷ [Projektligji për shërbime mediale në Shqipëri](#);²⁸ ose [Projektligji i Gjermanisë për zbatim më të mirë të ligjit në rrjetet sociale](#).²⁹
- [Legislationline](#) është një bazë e të dhënave e krijuar nga ODIHR për Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që ta konsultojnë dhe harmonizojnë legjislacionin me standardet ndërkombëtare.³⁰

- Biblioteka Ligjore e Kongresit Amerikan ka publikuar një analizë krahasuese të legjislacionit në raportin [Ligji në mbrojtje të gazetarëve nga ngacmimi në internet](#).³¹
- Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e së Drejtës për Liri të Mendimit dhe Shprehjes jep rekomandime të dobishme në [Raportin mbi përdorimin e kriptimit dhe anonimitetit në komunikimet digjitale](#).³²
- [Plani i veprimit i Rabatit kundër nxitjes së urrejtjes në baza kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës](#) nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, ofron rekomandime të qarta për atë se çfarë përbën “gjuhë të urrejtjes”.³³
- “[Gjuha e urrejtjes](#)” e sqaruar: [Pako veglash](#) është një udhëzues i përpiluar nga ARTICLE 19 për identifikimin e “gjuhës së urrejtjes” dhe mënyrat e luftimit efektiv të saj pa cenuar të drejtën për liri të shprehjes dhe barazi.³⁴

Shënime fundore

- 1 OSCE, Ministerial Council Decision No. 3/18, “Safety of Journalists”, 7 December 2018, <https://www.osce.org/chairmanship/406538?download=true>.
- 2 “Equality and Non-discrimination”, United Nations and the Rule of Law, <https://www.un.org/ruleoflaw/thematic-areas/human-rights/equality-and-non-discrimination/>.
- 3 “Legal Responses to Online Harassment and Abuse of Journalists - Perspectives from Finland, France and Ireland”, OSCE RFoM and IPI, 7 March, 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/413549>.
- 4 The Law Library of Congress, Laws Protecting Journalists from Online Harassment, September 2019, p. 4–5, <https://www.loc.gov/law/help/protecting-journalists/online-harassment.pdf>.
- 5 OSCE, Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR), “Making Laws Work for Women and Men: A Practical Guide to Gender-Sensitive Legislation”, 2017, <https://www.osce.org/odihhr/327836?download=true>.
- 6 OECD, “Toolkit for Mainstreaming and Implementing Gender Equality”, 2018, <https://www.oecd.org/gov/toolkit-for-mainstreaming-and-implementing-gender-equality.pdf>.
- 7 Toby Mendel, “Freedom of expression for parliaments and their members: Importance and scope of protection”, Inter-Parliamentary Union, 2018, <https://www.ipu.org/resources/publications/handbooks/2018-10/freedom-expression-parliaments-and-their-members-importance-and-scope-protection>.
- 8 European Court of Human Rights, *Handyside v. the United Kingdom*, Application no. 5493/72, 7 December 1976, paragraph 49, <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22docnum%3A5493%22%2C%22itemid%3A%22001-57499%22%7D>. Yaman Akdeniz, “Media Freedom on the Internet: An OSCE Guidebook”, OSCE RFoM, 2016, <https://www.osce.org/netfree-dom-guidebook?download=true>.
- 9 UN General Assembly, Resolution 2200A (XXI), International Covenant on Civil and Political Rights, 16 December 1966, entry into force: 23 March 1976, Article 49, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>.
- 10 “UN experts urge States and companies to address online gender-based abuse but warn against censorship”, UN Office of the High Commissioner for Human Rights, news item, 8 March 2017, <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?News- ID=21317&LangID=E>.
- 11 Ibid.
- 12 UN Human Rights Committee, General Comment No. 34, Article 19: Freedoms of opinion and expression, CCPR/C/GC/34, 2011, paragraphs 30 and 34, <https://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/gc34.pdf>.
- 13 OSCE RFoM, “Recommendations following the Expert Meeting New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists”, 17 September 2015, <https://www.osce.org/fom/19356?download=true>.
- 14 UN General Assembly, Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression, A/74/486, 9 October 2019, <https://undocs.org/A/74/486>.
- 15 UN General Assembly, Report of the United Nations High Commissioner for Human Rights on the expert workshops on the prohibition of incitement to national, racial or religious hatred, A/HRC/22/17/Add.4, 11 January 2013, https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Opinion/SeminarRabat/Rabat_draft_outcome.pdf.
- 16 “Decriminalization of defamation”, OSCE RFoM, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/106287>.
- 17 Op. cit. endnote 3.

- 18 Op. cit. endnote 1.
- 19 UN General Assembly, Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression, A/HRC/29/32, 25 May 2015, <https://www.ohchr.org/en/issues/freedomofopinion/pages/callforsubmission.aspx>
- 20 Op. cit. endnote 3.
- 21 French Criminal Code, France, <https://www.legifrance.gouv.fr/affichCode.do?idSection-TA=LEGISCTA000021796946&cidTexte=LEGITEXT000006070719>.
- 22 Op. cit. endnote 3.
- 23 German Criminal Code, https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_stgb/englisch_stgb.html.
- 24 Scott Griffen, “Defamation and Insult Laws in the OSCE Region: A Comparative Study”, OSCE RFoM, March 2017, <https://www.osce.org/files/f/documents/b/8/303181.pdf>.
- 25 Op. cit. endnote 11.
- 26 OSCE RFoM, Legal Review of the Austrian draft Law on Diligence and Responsibility Online, 4 June 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/421745>
- 27 OSCE RFoM, Legal Review on the draft law of Ukraine “on media”, February 2020, <https://www.osce.org/files/f/documents/2/7/447508.pdf>.
- 28 OSCE RFoM, Legal Review of the draft Law on Media Services in Albania, July 2019, <https://www.osce.org/files/f/documents/4/3/425462.pdf>.
- 29 OSCE RFoM, Legal Review of the German Draft Law on Better Law Enforcement in Social Networks, May 2017, <https://www.osce.org/files/f/documents/a/o/333541.pdf>.
- 30 OSCE ODIHR, “Legislationline database”, <http://www.legislationline.org/>.
- 31 Library of Congress Law, “Laws Protecting Journalists from Online Harassment: Comparative Summary”, Library of Congress Law, <https://www.loc.gov/law/help/protecting-journalists/>.
- 32 UN General Assembly, Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression, A/HRC/29/32, 22 May 2015, <https://undocs.org/A/HRC/29/32>.
- 33 Op. cit. endnote 15.
- 34 ARTICLE 19, “‘Hate Speech’ Explained: A Toolkit”, 2015, <https://www.articlerg.org/data/files/medialibrary/38231/Hate-Speech-Explained---A-Toolkit-%282015-Edition%29.pdf>.



Gjyqësori

Veprimet e propozuara

1. Të ketë vetëdijesim për çështjet gjinore në të gjithë sistemin gjyqësor, meqë kjo është thelbësore për mbrojtjen e gazetareve;
2. Të rritet ekspertiza e personelit gjyqësor për çështjet e lirisë së shprehjes, sigurisë së gazetarëve dhe ngacmimit e abuzimit në internet dhe jashtë tij;
3. Të zbatohen dhe promovohen praktikat më të mira në qasjen në drejtësi, dënime dhe mjete juridike;
4. Institucionet kombëtare të drejtave të njeriut të angazhohen në çështjen e sigurisë së gazetarëve.

3. Gjyqësori

Sigurimi i qasjes në drejtësi dhe dhënia fund mosndëshkimit

Ky kapitull përqendrohet në punën e gjykatave dhe gjyqtarëve që interpretojnë dhe zbatojnë ligjin, që është thelbësore në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurinë e gazetarëve. Veç kësaj, ky kapitull përmban një pjesë për institucionet e pavarura të drejtave të njeriut që janë të mandatuara të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut.

Një nga sfidat në adresimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetarëve është se shpesh nuk raportohet dhe, për këtë arsye, garantimi i qasjes së tyre në drejtësi është thelbësor. Shqetësim i veçantë është niveli i lartë i mosndëshkimit për krime kundër gazetarëve - gati 90 për qind të vrasjeve të gazetarëve në mbarë botën.¹ Duke qenë se përbën dështim sistematik të funksioneve të qeverisë dhe sundimit të ligjit, nga i cili varet siguria dhe të drejtat e gjithsecilit, luftimi i mosndëshkimit është një domosdoshmëri absolute.²

Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së u bën thirrje shteteve që “të ndërmarrin masa efektive për t’i dhënë fund mosndëshkimit për krimet e kryera kundër gazetarëve, duke siguruar llogaridhënien si një element kryesor në parandalimin e sulmeve në të ardhmen, përfshirë këtu duke siguruar që agjencitë e zbatimit të ligjit të kryejnë hetime të shpejta, efektive dhe të paanshme të akteve të dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. në mënyrë që t’i sjellin para drejtësisë të gjithë ata që janë përgjegjës të sillen dhe të sigurojnë që viktimat të kenë qasje në mjete të përshtatshme juridike.”

› **Të ketë vetëdijesim për çështjet gjinore në të gjithë sistemin gjyqësor, meqë kjo është thelbësore për mbrojtjen e gazetareve**

Për sigurinë në internet të gazetareve nevojitet një sistem gjyqësor që mbron të drejtat e gjithsecilit dhe është i vëmendshëm për mënyrat e ndryshme të përjetimit të përvojave nga burrat, gratë dhe njerëzit me orientime seksuale, identitete dhe shprehje gjinore të ndryshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.³ Për ta përmbushur këtë ideal, Shtetet duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të vlerësuar dhe reformuar sistemin e drejtësisë me qëllim të avancimit të barazisë gjinore. Hapat e mundshëm drejt këtij qëllimi përfshijnë balancimin e përfaqësimit gjinor në personel dhe ngritjen e kapaciteteve për të garantuar qasje të barabartë në drejtësi.

Një nga sfidat në adresimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetareve është mosraportimi i shpeshtë. Ka shumë faktorë që kontribuojnë në këtë gjë, si frika nga hakmarrja, pasojat profesionale dhe stigmatizimi nga kolegët. Mund të jetë fjala edhe për mbrojtje joadekuade për të ruajtur dinjitetin e ankuesve, kostot ekonomike dhe perceptimi se nuk do të ndërmerret asgjë, faktorë që mund t'i dekurajojnë gazetaret edhe më që ta çojnë rastin deri në fund.⁴ Hapat proaktivë për lehtësimin e qasjes në drejtësi, përfshirë këtu shërbimet e ndihmës juridike dhe fushatat informuese, mund t'u ndihmojnë gazetareve që t'i kapërcejnë disa nga këto pengesa. Promovimi i sundimit të ligjit dhe sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për gjithsecilin është një ndër zotimet në kuadër të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm.⁵

Hapat drejt përmirësimit të shkallës së adresimit nga ana e sistemit gjyqësor të rasteve që lidhen me sigurinë e gazetareve mund të përfshijnë po ashtu organizimin e dialogut midis gjyqësorit dhe grave gazetare për të shkëmbyer përvoja dhe për të kuptuar më mirë se në ç'mënyrë ndikon ngacmimi dhe abuzimi në internet në jetën personale dhe profesionale të gazetareve.

Shembuj

Trajnimi i profesionistëve gjyqësorë: Duke filluar nga viti 2013, autoritetet e Bosnjës dhe Hercegovinës, në bashkëpunim me Shoqatën e Gjyqtareve, kanë trajnuar profesionistë gjyqësorë lidhur me qasjet gjinore në procedurat dhe praktikat gjyqësore.⁶

Mbështetja e rasteve që sillen në gjykatë: Në vitin 2018, autoriteti rajonal rregullator i mediave i Nordrhein-Westfalen të Gjermanisë nisi një projekt që ofron mbështetje ligjore për organizatat dhe gazetarët e lajmeve për t'i çuar rastet e ngacmimit dhe abuzimit në internet në gjykatë.⁷

Burime

- Rekomandime të hollësishme për mënyrat se si të sigurohet një qasje e përgjegjshme gjinore e sistemit të drejtësisë janë dhënë nga OSBE në pakon e veglave të titulluar [Drejtësia dhe gjinia](#).⁸
- Programi i Këshillit të Evropës për edukimin për të drejtat e njeriut për profesionistët ligjorë (HELP) ofron një kurs trajnimi në internet të titulluar [Qasja në drejtësi për gratë](#), që përmban module lidhur me përmirësimin e qasjes së grave në drejtësi dhe qasjet me ndjeshmëri gjinore në ushtrimin e ligjit.⁹
- Raporti i UNESCO-s [Parandalo dhe ndëshko: Në kërkim të zgjidhjeve për të luftuar dhunën ndaj gazetarëve](#) përmban rekomandime në lidhje me adresimin e mosndëshkimit të krimeve të kryera gazetarëve, megjithëse nuk përmban specifika për çështjet gjinore.¹⁰

› **Të rritet ekspertiza e personelit gjyqësor për çështjet e lirisë së shprehjes, sigurisë së gazetarëve dhe ngacmimit e abuzimit jashtë internetit dhe në internet**

Për të qenë në gjendje që të përshtatet, personeli gjyqësor duhet të jetë në dijeni të dobive e sfidave të ndryshme që paraqet peizazhi vazhdimisht i ndryshueshëm medial për gratë dhe burrat gazetarë. Temat si realizimi dhe mbrojtja e së drejtës për liri të shprehjes në internet, rëndësia themelore e qasjeve të përgjegjshme gjinore në mbështetjen e kësaj të drejte, si dhe reagimi i duhur ndaj ngacmimeve dhe abuzimeve në internet duke qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duhet të përfshihen në kurrikulat arsimore dhe programet e trajnimit ligjor.

Trajnimet e këtilla duhet të mbulojnë të paktën pesë tema që ndikojnë në sigurinë e gazetarëve në internet:

1. përmbledhje e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale të krimeve kundër së drejtës për liri të shprehjes;
2. pasqyrë e qartë e kufizimeve të ligjshme të së drejtës për liri të shprehjes dhe të të ashtuquajturit test trepjesësh (faqe 42: ligjshmëria, legjitimiteti, dhe domosdoshmëria e proporcionaliteti);
3. dobitë dhe sfidat që lidhen me të drejtën për liri të shprehjes në internet dhe një pasqyrë e mënyrës së funksionimit të internetit dhe rrjeteve sociale;
4. qasje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese ndaj gëzimit të së drejtës për liri të shprehjes; dhe
5. roli i gazetarisë dhe gazetarëve në shoqëritë demokratike.¹¹

Organizimi i trajnimeve në bashkëpunim me homologë nga shtete tjera mund të jetë me vlerë për të gjithë. Për shembull, organizimi i një seminari me gjyqtarë ose profesionistë tjerë të sektorit të drejtësisë nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së mund të shërbejë si mundësi për shkëmbim produktiv të përvojave dhe mësimave të nxjerra.

Shembuj

Organizimi i kurseve masive të hapura në internet: Që nga viti 2014, më se 12,000 gjyqtarë kanë marrë pjesë në kurset masive të hapura në internet të organizuara nga UNESCO për t'i zgjeruar njohuritë e tyre mbi çështjet e lirisë së shprehjes. Pjesëmarrësit i kanë mirëpritur ngrohtësisht kurset, me komente që tregojnë se trajnimi u ka ndihmuar t'i kuptojnë më mirë çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve.¹²

Shkëmbime ndërkombëtare të nivelit të lartë midis ekspertëve: Dialogu gjyqësor i Azisë Qendrore nga PLM i OSBE-së ka mundësuar bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar midis juristëve dhe gjyqtarëve të shquar të cilët takohen rrallëherë, në mos fare, me njëri-tjetrin.¹³ Ata shkëmbejnë mendime juridike dhe përvojat gjyqësore mbi çështjet më të ngutshme, të tilla si dekriminalizimi i shpifjes dhe luftimi i “gjuhës së urrejtjes” duke mbrojtur njëherazi lirinë e shprehjes.

Ndjekja e trajnimeve me pjesëmarrje fizike: Që nga viti 2016, më se 4,000 gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe profesionistë të medias kanë marrë pjesë në projektin e Këshillit të Evropës JUFREX duke zgjeruar njohuritë e tyre mbi lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve në Evropën Juglindore.¹⁴

Krijimi i gjykatave të specializuara: Estonia ka krijuar një gjykatë të specializuar për ngacmime në internet, me gjyqtarë dhe zyrtarë të zbatimit të ligjit të trajnuar enkas për këtë çështje.¹⁵

Burime

- UNESCO ka publikuar një pako veglash mbi [Standardet ligjore të lirisë së shprehjes në Afrikë](#), që përmban një pjesë mbi perspektivat gjinore të lirisë së shprehjes.¹⁶ Në bashkëpunim me Qendrën për Ndihmë Ndërkombëtare për Mediat, UNESCO ka publikuar gjithashtu një udhëzues për [Standardet ndërkombëtare të lirisë së shprehjes: Udhëzues themelor për profesionistët ligjorë në Amerikën Latine](#)¹⁷ si dhe një pako mjetesh edukative për gjyqtarët në lidhje me lirinë e shprehjes, qasjen në informacion dhe sigurinë e gazetarëve.¹⁸
- Mbrojtja e së drejtës për lirinë e shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, udhëzues i Këshillit të Evropës që ofron rekomandime mbi sigurinë e gazetarëve.¹⁹
- Një trajnim në internet mbi sigurinë e gazetarëve i dedikuar për gjyqtarë dhe profesionistë ligjorë përcakton bazat për mbrojtjen dhe ndjekjen penale të dhunës ndaj gazetarëve. Trajnimi është në dispozicion në gjuhë të ndryshme në [Platforma në internet e Këshillit të Evropës HELP](#).²⁰

› **Të zbatohen dhe promovohen praktikat më të mira në qasjen në drejtësi, dënim dhe mjete juridike**

Meqenëse paditë e pavarura mund të jenë traumatike dhe t'i marrin kohë personit që ka qenë cak i dhunës, duhet të ketë sistem për të siguruar që proceset të jenë të shpejta dhe të ofrohet ndihmë ligjore dhe mjete juridike.²¹ Mjetet juridike duhet të jenë proporcionale me seriozitetin e shkeljeve dhe mund të përfshijnë kompensim financiar, si edhe një sërë masash për rehabilitimin e viktimave dhe lehtësimin e kthimit në punë nëse ato e dëshirojnë këtë.²²

Kur shqyrtojnë lëndë të ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetareve, gjykatat duhet të mbajnë parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit dhe sanksioneve e mjeteve korrigjuese përkatëse ndikimin që ka pasur sjellja në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit.²³ Gjatë shqiptimit të dënimit, gjyqtarët duhet të marrin në konsideratë praktikat më të mira të rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve që janë shqyrtuar nga gjykata të tjera, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ekziston një jurisprudencë gjithnjë në rritje në të cilën mund të bazohet gjyqësori. Kjo mund të shërbejë për të siguruar që kryerësit shtetërorë dhe jo shtetërorë të jenë plotësisht të vetëdijshëm se nuk mund të veprojnë pa u ndëshkuar dhe pa shqiptimin e ndonjë mase dëmshpërblimi nga gjykatat. Masë e tillë është dëmshpërblimi i gazetarit që ka qenë cak i shkeljes.²⁴

Në bashkëpunim me prokurorët specialë dhe komisionet e pavarura të themeluara nga palë të ndryshme të interesit, organet gjyqësore duhet të promovojnë forcimin e luftës kundër mosndëshkimit. Kjo mund të përfshijë bashkëveprimin me komisionet e posaçme që monitorojnë efektshmërinë e hetimeve në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse, organizatat e mediave dhe organizatat e shoqërisë civile.

Shembuj

Dënimi: Në Francë, dy individë u dënuan me gjashtë muaj burg me kusht dhe u gjobitën me 2,000 euro për bërjen e kërcënimeve me vdekje dhe kërcënimeve për përdhunim. Shënjestra e tyre, një gazetare franceze, ishte bërë cak i një fushate ngacmimi në internet për tetë muaj rresht.²⁵ Në Irlandë, një individ u dënua me katër vjet e gjysmë burg (18 muajt e fundit të të cilit u pezulluan) për ngacmim të një gazetareje sipas Ligjit për vepra jofatale ndaj personit.²⁶

Nisma për hetime publike: Në nëntor të vitit 2019, u nis një hetim publik për vrasjen e Daphne Caruana Galizia në Maltë, pas avokimit të konsiderueshëm nga familja e viktimës, rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Komitetit të Çështjeve Ligjore të Këshillit të Evropës dhe presionit nga organizatat e tjera ndërkombëtare.²⁷

Dhënia e reparacioneve financiare: Në Finlandë, një gjykatë vendore caktoi dëmshpërblimin prej 94,000 euro për një gazetare, së bashku me kompensimin për shpenzimet mjekësore, humbjen e fitimeve dhe sigurisë, pasi që ishte kthyer në cak të ngacmimeve, përndjekjes dhe shpifjeve në internet nga tre individë.²⁸

Sigurimi i mjeteve juridike civile: Në shumë vende, viktimat mund të parashtrajnë padi civile për dëmshpërblim nëse ngacmimi ose abuzimi në internet shkel të drejtën kushtetuese të një personi privat, për shembull sipas Ligjit Irlandez.²⁹

Burime

- Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) mund të konsultohet në raportin e Këshillit të Evropës [Liria e shprehjes, mediat dhe gazetarët: Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut](#).³⁰ Në dispozicion është po ashtu dhe trajnimi virtual HELP i Këshillit të Evropës mbi [Arsyetimin e aktgjykimeve penale dhe hyrje në KEDNJ](#).³¹
- [Baza e të dhënave IRIS Merlin](#) e Observatorit Audiovizual Evropian përmban informata të dobishme mbi çështjet ligjore mediale, duke përfshirë mbrojtjen e gazetarëve.³²
- [Baza e të dhënave e praktikës gjyqësore të lirisë globale të shprehjes](#) e Universitetit të Kolumbias ofron qasje në qindra aktgjykime mbi çështjet e lirisë së shprehjes në të gjithë botën, përfshirë sigurinë e gazetarëve.³³
- Fakulteti Juridik i Universitetit të Oksfordit ka botuar një [Raport mbi dëmshtëpërblimet dhe mjetet juridike për viktimat e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore](#) duke trajtuar jurisprudencën ndërkombëtare, rajonale dhe vendore.³⁴

› **Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut të angazhohen në çështjen e sigurisë së gazetarëve**

Pavarësisht nëse themelohen si komision, ombudsperson ose në ndonjë formë tjetër, institucionet e pavarura publike shtetërore për të drejta të njeriut (IKDNJ-të) janë në pozitë të mirë për të trajtuar çështjen e sigurisë së gazetarëve, duke përfshirë çështjen e ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetarëve. IKDNJ-të mund t'i kushtojnë vëmendje sigurisë së gazetareve përmes monitorimit, edukimit dhe komunikimit strategjik, si dhe përmes shqyrtimit të ankesave dhe parandalimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe keqtrajtimit ndaj gazetarëve.³⁵ Për shembull, IKDNJ-të kanë për mandat të merren me ankesa individuale dhe të ndërmjetësojnë midis ankuesve dhe organeve të administratës publike që nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Veç kësaj, IKDNJ-të mund të bëjnë deklarata publike, të nisin fushata të ndërgjegjësimit, si dhe të publikojnë hulumtime për fushën.

IKDNJ-të janë të pozicionuara mirë për të monitoruar sulmet ndaj gazetarëve, përfshirë ngacmimet dhe abuzimet në internet. Si institucione të pavarura publike, IKDNJ-të janë në pozitë të mirë që të zhvillojnë sisteme të grumbullimit të të dhënave për shtrirjen dhe ndikimin e sigurisë së gazetarëve, e që mund të shërbejnë si bazë për politika publike dhe mekanizmat ndërkombëtarë, siç janë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

IKDNJ-të në disa raste kanë edhe kompetencë lëndore, që i vendos ato në një pozitë të mirë që të rekomandojnë dhe të ofrojnë mjete juridike, ose kenë një rol në zgjidhjet alternative të kontesteve. Mjete të tilla jo juridike mund të jenë alternativë e mirëpritur për rastet e ngacmimeve me bazë gjinore në internet dhe jashtë internetit ndaj grave që nuk duan t'i nënshtrohen një procedure të hapur gjyqësore.

Sikundër institucionet e tjera, IKDNJ-të duhet të sigurojnë qasje të përgjegjshme gjinore në punën e tyre dhe të sigurojnë edhe burimet e duhura njerëzore dhe financiare për të zbatuar qasjen e tillë në mënyrë efektive.

Shembuj

Hartimi i raporteve të ombudspersonit për të drejtat e njeriut:

Ombudsmani për të Drejta të Njeriut në Bosnjë dhe Hercegovinë ka hartuar një [Raport të posaçëm për gjendjen dhe rastet e kërcënimeve ndaj gazetarëve](#). Ai identifikon sfidat kryesore për sigurinë e gazetarëve, duke përfshirë ngacmimet dhe abuzimet në internet, si dhe shkallën në të cilën këto sfida janë trajtuar mirëfilli nga Shteti.³⁶

Publikimi i raporteve në bashkëpunim me mediat: Zyra e Ombudsmanit Seimas në Lituani bashkëpunon me mediat, në veçanti Shoqatën e Radiostacioneve Rajonale, për të realizuar programe të përbashkëta mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Në këtë nismë të përbashkët, gazetarët e radios përgatisin programe me kontribute në përmbajtje nga zyra e ombudspersonit. Ky lloj rregullimi ofron një forum për të trajtuar çështjet e lirisë së shprehjes dhe dhunës ndaj gazetarëve, përfshirë ngacmimet dhe abuzimet në internet.³⁷


Burime

- [Doracaku për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore](#) i Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut ofron këshilla të dobishme për integrimin e perspektivës gjinore në punën e IKDNJ-ve.³⁸

Shënime fundore

- 1 UNESCO, "Intensified attacks, new defences: developments in the fight to protect journalists and end impunity", 2019, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000371487>.
- 2 William Horsley, "OSCE Safety of Journalists Guidebook", OSCE RFoM, 2014. p. 23, <https://www.osce.org/fom/118052?download=true>.
- 3 Eleanor Gordon, "Justice and Gender, in Gender and Security Toolkit", DCAF, OSCE, ODIHR, UN Women, 2019, https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/GSToolkit_Tool-4%20EN%20FINAL_1.pdf.
- 4 Michelle Ferrier, "Attacks and Harassment: The Impact on Female Journalists and Their Reporting", International Women's Media Foundation, TrollBusters, 2018, <https://www.iwmf.org/wp-content/uploads/2018/09/Attacks-and-Harassment.pdf>. Edison Lanza, "Women Journalists and Freedom of Expression: Discrimination and gender-based violence faced by women journalists in the exercise of their profession", IACHR, RFOE, OEA/SER.L/V/II CIDH/RELE/ INF.17/17, 31 October 2018, <http://www.oas.org/en/iachr/expression/docs/reports/Women-Journalists.pdf>.
- 5 UN Sustainable Development Goal 16: Promote peaceful and inclusive societies for sustainable development, provide access to justice for all and build effective, accountable and inclusive institutions at all levels, 2015, <https://sustainabledevelopment.un.org/sdgr6>.
- 6 Op. cit. endnote 3, case study 5: gender and justice reform (Bosnia and Herzegovina).
- 7 Barbara Trionfi and Javier Luque Martinez, "Newsroom Best Practices for Addressing Online Violence against Journalists: Perspectives from Finland, Germany, Poland, Spain and the United Kingdom", IPI, in co-operation with the OSCE RFoM, June 2019, <https://newsrooms-on-the-line.ipi.media/wp-content/uploads/2019/06/IPI-report-online-harassment-06032019.pdf>, https://dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/GSToolkit_Tool-15%20EN%20FINAL_o.pdf.
- 8 Lorraine Andaya Serrano, "Integrating Gender in Project Design and Monitoring for the Security and Justice Sector", in: Gender and Security Toolkit, DCAF, OSCE ODIHR, UN Women, 2019, https://dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/GSToolkit_Tool-15%20EN%20FINAL_o.pdf.
- 9 Council of Europe, HELP Online Courses, <http://help.elearning.ext.coe.int/>.
- 10 Eduardo Bertoni, "Prevent and Punish: In search of solutions to fight violence against journalists", UNESCO, 2015, https://en.unesco.org/sites/default/files/prevent-and-punish_bertoni.pdf.
- 11 Catalina Botero, "Guía político-pedagógica sobre la incorporación de la temática de libertad de expresión y de acceso a la información pública en la formación de operadores judiciales en América Latina", UNESCO, 2016, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000243750>.
- 12 Rosental Calmon Alves, "Training Judges Online to Safeguard Journalists", in the UNESCO Courier, April – June 2017, <https://en.unesco.org/courier/2017-april-june/training-judges-online-safeguard-journalists>.
- 13 OSCE RFoM, "OSCE Media Freedom Representative concludes the second Central Asia Judicial Dialogue", March 2020, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/448045>. OSCE RFoM, "Second Expert Meeting - Central Asia Judicial Dialogue, 2020, https://www.osce.org/files/f/documents/o/e/461008_o.pdf
- 14 "Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX)", Council of Europe, South-East Europe Freedom of expression (JUFREX), <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/promoting-freedom-of-expression-in-south-east-europe>.
- 15 Peter Noolander, "On the safety of journalists and other media actors, for the Conference of Ministers responsible for Media and Information Society", Background paper on the implementation of CM/rec(2016)4, May 2020, <https://rm.coe.int/background-paper-safety-of-journalists-and-other-media-actorsfinal/168094b396>.
- 16 UNESCO, "Legal Standards on Freedom of Expression: Toolkit for the Judiciary in Africa", 2018, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000366340>.

- 17 Silvia Chocarro, “International standards on freedom of expression: A basic guide for legal practitioners in Latin America and the Caribbean”, Center for International Media Assistance, 2018, <https://www.cima.ned.org/resource/international-standards-on-freedom-of-expression-a-basic-guide-for-legal-practitioners-in-latin-america-and-the-caribbean/>.
- 18 UNESCO, “Caja de herramientas para escuelas judiciales iberoamericanas”, 2017, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000251593>.
- 19 Dominika Bychawska-Siniarska, “Protecting the Right to Freedom of Expression Under the European Convention on Human Rights”, Council of Europe, 2017, <https://rm.coe.int/handbook-freedom-of-expression-eng/1680732814>.
- 20 Council of Europe, HELP online platform, <http://help.elearning.ext.coe.int/>
- 21 UN Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, OSCE Representative on Freedom of the Media, Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and African Commission on Human and Peoples’ Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information, “Joint Declaration on Crimes against Freedom of Expression”, 25 June 2012, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/91595>.
- 22 Ibid.
- 23 Scott Griffen (ed.), “Legal Responses to Online Harassment and Abuse of Journalists: Perspectives from Finland, France and Ireland”, OSCE RFoM and IPI, 7 March 2019, <https://www.osce.org/files/f/documents/8/9/413549.pdf>.
- 24 Op. cit. endnote 5.
- 25 “RSF publishes report on online harassment of journalists”, Reporters Without Borders news item, 1 August 2018, <https://rsf.org/en/news/rsf-publishes-report-online-harassment-journalists>.
- 26 Op. cit. endnote 23.
- 27 Council of Europe, Parliamentary Assembly Resolution No. 2293, “Daphne Caruana Galizia’s assassination and the rule of law in Malta and beyond: ensuring that the whole truth emerges”, 26 June 2019, <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?fileid=28053>.
- 28 Op. cit. endnote 23.
- 29 Ibid.
- 30 European Audiovisual Observatory, “Freedom of Expression, the Media and Journalists: Case-law of the European Court of Human Rights”, December 2017, <https://rm.coe.int/freedom-of-expression-the-media-and-journalists-iris-themes-vol-iii-de/16807c1181>.
- 31 Council of Europe, “Human Rights Education for Legal Professionals”, August 2017, <https://www.coe.int/en/web/help/-/take-the-help-free-online-course-on-reasoning-of-criminal-judgments->
- 32 European Audiovisual Observatory, IRIS Merlin, 2020, <http://merlin.obs.coe.int/>
- 33 Columbia University, Global Freedom of Expression Case Law Database, <https://global-free-domofexpression.columbia.edu/>.
- 34 University of Oxford, “A Report on Reparations and Remedies for Victims of Sexual and Gender Based Violence”, REDRESS, January 2016, <https://rm.coe.int/freedom-of-expression-the-media-and-journalists-iris-themes-vol-iii-de/16807c1181>.
- 35 UN General Assembly, Resolution 74/157, “The safety of journalists and the issue of impunity”, 18 December 2019, <https://undocs.org/A/RES/74/157>.
- 36 The Institution of Human Rights Ombudsman of Bosnia and Herzegovina, “Special Report on the Status and Cases of Threats Against Journalists in Bosnia and Herzegovina”, June 2017, https://www.ombudsmen.gov.ba/documents/obmudsmen_doc2017082415202346eng.pdf.
- 37 OECD, “The Role of Ombudsman Institutions in Open Government: OECD Working Paper on Public Governance No. 29”, 2018, <https://www.oecd.org/gov/the-role-of-ombudsman-institutions-in-open-government.pdf>.
- 38 OSCE ODIHR, “Handbook for National Human Rights Institutions on Women’s Rights and Gender Equality”, 2012, <https://www.osce.org/odihr/97756?download=true>.



**Agjencitë e
zbatimit të ligjit**

Veprimet e propozuara

1. Të avancohet trajnimi i autoriteteve ligjzbatuese lidhur me çështjet e sigurisë së gazetarëve në internet
2. me një qasje të përgjegjshme gjinore;
3. Të rishikohet dhe përmirësohet trajtimi i çështjeve gjinore në vlerësimet e rrezikshmërisë për kërcënime e ngacmime;
4. Të përforcohen protokollet, metodat dhe procedurat e hetimit të krimeve ndaj gazetarëve dhe lirisë së shprehjes;
5. Të avancohet dialogu dhe bashkërendimi për sigurinë e gazetarëve midis autoriteteve të zbatimit të ligjit, mediave dhe shoqërisë civile.

4. Agjencitë e zbatimit të ligjit

Avancimi i metodave për mbrojtje dhe hetime efektive

Ky kapitull merret me organet shtetërore që duhet të përmbushin detyrimin për të mbrojtur gazetarët dhe për të hetuar efektivisht krimet ndaj tyre: agjencitë e zbatimit të ligjit. Gratë gazetare përballen me rreziqe të veçanta në punën e tyre, gjë që kërkon qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj sigurisë së tyre. Hetimi i krimeve ndaj gazetarëve, të kryera në mjedisin virtual, është ende fushë në zhvillim. Çdo propozim i ri për të luftuar praktikën në internet duhet të vlerësohet me kujdes, për të siguruar që mbrojtja dhe ushtrimi i të drejtave të njeriut në internet, përfshirë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe privatësisë, të mos dëmtohen.

Ky kapitull ofron një pasqyrë të përmbledhur të rekomandimeve dhe standardeve ekzistuese për hetimin efektiv të krimeve ndaj gazetarëve, përfshirë ato të trajtuara në Vendimin nr. 3/18 të Këshillit Ministror të OSBE-së, për adresimin e gamës së sjelljeve ngacmuese e abuzuese me bazë gjinore në internet ndaj grave gazetare. Gjithashtu, ky kapitull propozon hapa që autoritetet e zbatimit të ligjit duhet t'i ndër marrin si minimum për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së u bën thirrje Shteteve që t'i "inkurajojnë organet shtetërore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit që të angazhohen në aktivitete ndërgjegjësimit dhe trajnimit në lidhje me domosdoshmërinë e garantimit të sigurisë së gazetarëve, dhe të promovojnë përfshirjen e shoqërisë civile në aktivitete të tilla, kurdo që është e mundur."

› **Të avancohet trajnimi i autoriteteve ligjzbatuese lidhur me çështjet e sigurisë së gazetarëve në internet me një qasje të përgjegjshme gjinore**

Meqë zyrtarët e zbatimit të ligjit mund të mos jenë gjithëherë të vëmendshëm ndaj standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe sigurisë së gazetarëve në punën e tyre të përditshme, programet e trajnimit mund të luajnë rol konstruktiv për t'u ndihmuar që t'i kuptojnë më mirë të drejtat e gazetarëve, shtrirjen e kërcënimeve me të cilat ata përballen, si dhe mënyrat e reagimit ndaj tyre.¹ Programet e tilla trajnuese duhet të përmbajnë disa komponentë dhe rekomandime se si të krijohen procedura që inkurajojnë gratë gazetare të raportojnë sulmet në internet dhe ato fizike tek autoritetet kompetente. Këto programe trajnimi duhet të përfshijnë edhe veprime për përmbajtje nga sjelljet institucionale që i shtyjnë individët të rijetojnë traumën e sulmit dhe kështu të përkeqësojnë përvojën negative (e njohur edhe si riviktimizim).² Një vështrim i përgjithshëm mbi përdorimin, keqpërdorimin dhe dobitë e teknologjisë, bashkë me module praktike që ofrojnë mjete dhe njohuri mbi aspektet ligjore dhe teknike, duhet të përçojë manifestimet e ndryshme të ngacmimit dhe abuzimit me bazë gjinore, si dhe rrethanat specifike në të cilat kërcënimet dhe ngacmimet në internet përbëjnë vepra penale që duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si krimet jashtë internetit.³

Trajnimi i tillë duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë personelin përkatës të zbatimit të ligjit, posaçërisht për policinë që pranon raportet, si dhe hetuesit, si dhe duhet të përcaktojë disa afate për kryerjen e tij. Modulet për barazinë dhe mosdiskriminimin duhet të përmbajnë edhe masa për t'iu kundërvënë pengesave me të cilat përballen gratë në qasjen e tyre në drejtësi, siç janë diskriminimi strukturor dhe i shënjestruar në sistemin e drejtësisë penale.

Masat parandaluese janë qenësore, ashtu si edhe procedurat për identifikimin e rreziqeve dhe kërcënimeve të veçanta me të cilat gratë gazetare përballen shpesh në internet, krahasuar me ato që përjetojnë kolegët e tyre meshkuj.

Autoritetet e zbatimit të ligjit duhet t'u japin përparësi kërcënimeve ndaj jetës apo integritetit fizik, përfshirë kërcënimet për përdhunim ⁴ dhe sjellje të tjera kriminale në internet që kanë potencial të ndodhin edhe fizikisht.

Personeli i zbatimit të ligjit duhet të jetë mirë i trajnuar për masat praktike të disponueshme për parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative të ngacmimit dhe abuzimit me bazë gjinore në internet. Për shembull, ata duhet të kenë dijeni për mundësitë që mjetet digjitale të sigurisë ofrojnë për parandalim të qasjes së paautorizuar në llogaritë digjitale të gazetarëve. Gjithashtu, autoritetet duhet të jenë të vetëdijshme për aspektet unike të veprimtarisë së gazetarëve, si nevoja thelbësore për mbrojtjen e burimeve dhe ndikimi që kanë ngacmimet dhe abuzimet e ndryshme në jetën e tyre personale dhe profesionale.

Trajnimi duhet të edukojë dhe të vetëdijesojë zyrtarët e zbatimit të ligjit për tendencat historike dhe akoma të pranishme të fajësimin të grave që janë shënjestër e abuzimit dhe ngacmimit me bazë gjinore. Trajnimi duhet që po ashtu të nxjerrë në pah barrën dhe ndikimin psikologjik të raportimit dhe ndjekjes së ankesave të tilla. Identifikimi i shkaqeve rrënjësore të neglizhimit të raporteve të abuzimit në internet dhe akteve të tjera të raportuara nga gazetarët do të duhej të ofronte informata për vendosjen e masave që mbrojnë gratë gazetare nga sulmet si dhe i parandalojnë ato të ndodhin.

Për më tepër, zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të ndjekin trajnime dhe të marrin informata për zbatimin e masave në mbështetje të gazetarëve, kur aktet e caktuar nuk e arrijnë nivelin e trajtimit penal.

Shembuj

Ofrimi i trajnimeve virtuale për policinë: Autoriteti Policor Suedez, në bashkëpunim me Universitetin Uppsala, ka nisur një [trajnim në internet për zyrtarët e policisë](#) për trajtimin e krimeve të urrejtjes, duke adresuar lirinë e fjalës, lirinë e shtypit dhe të drejtat e liritë themelore të gazetarëve, opinion-bërësve dhe politikanëve.⁵

Publikimi i doracakëve për policinë: [Departamenti Kanadez i Drejtësisë: Doracak për policinë dhe prokurorët e kurorës për ngacmimet në nivel penal](#) paraqet llojet e ndryshme të ngacmimeve që bëhen në internet, si dhe ligjet dhe procedurat e ndryshme që mund të ndiqen për të hetuar krime të tilla.⁶

Burime

- Doracaku i trajnimit për [Lirinë e shprehjes dhe rendin publik](#), botuar nga UNESCO, ka për qëllim pajisjen e pjesëtarëve të forcave të sigurisë me mjetet për ruajtjen e rendit publik, në pajtim me të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes, ndërsa garantojnë edhe sigurinë e gazetarëve.⁷ Doracaku është përdorur në punëtorit dhe kurse trajnimi, si pjesë e zbatimit të Planit të veprimit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e pandëshkueshmërisë në shumë vende, përfshirë Kazakistanin, Kirgizistanin, Taxhikistanin dhe Uzbekistanin.⁸
- Për të ndihmuar ligjzbatuesit të hetojnë më mirë ngacmimet dhe abuzimin në internet e grave gazetare, ARTICLE 19 ka hartuar një punim politikash [Hetimi i ngacmimit në internet dhe abuzimit të grave gazetare](#).⁹

› **Të rishikohet dhe përmirësohet trajtimi i çështjeve gjinore në vlerësimet e rrezikshmërisë për kërcënime e ngacmime**

Diskriminimi dhe pabarazia me të cilat përballen gratë në ambientin fizik shpesh paraqiten si të tilla në internet. Autoritetet ligjzbatuese duhet të jenë të vetëdijshme për këto rrethana, sidomos në rastet kur gazetarët janë të zëshëm dhe ekspozojnë sjellje kundër normave shoqërore dhe stereotipave gjinorë, e që mund t'i vendosin ata në rrezik të shtuar.

Autoritetet ligjzbatuese duhet të shqyrtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse procedurat dhe masat që zbatohen për të vlerësuar nivelin e rrezikshmërisë së kërcënimeve në internet dhe jashtë tij ndaj gazetarëve. Ky shqyrtim duhet të përfshijë nivelin e rrezikut që i mveshet kërcënimeve të ndryshme që jo detyrimisht klasifikohen si vepra penale, qoftë në internet apo jashtë tij, përfshirë edhe në ndërlidhje midis dy sferave. Shqyrtimi i tillë gjithëpërfshirës duhet të prodhojë praktika me qëllim zhvillimin e një protokollit - të kuptuar si grup metodash, procedurash dhe standardesh që udhëzojnë veprimtarinë e autoriteteve - për hetimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve me të cilat përballen gazetarët.¹⁰

Të gjitha raportimet e kërcënimeve nga zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të përmbajnë një përshkrim të hollësishëm të vlerësimit dhe masave të rekomanduara, si dhe të gjitha konsideratat faktike, kontekstuale dhe gjinore të ofruara nga gazetari dhe specialisti i çështjeve gjinore, nëse ka pasur të tillë, që ka qenë pjesëmarrës në vlerësim apo hetim.

Vlerësimet e rrezikut duhet të përmbajnë një pjesë që përfshin dhe shqyrton trendet e sjelljes dhe aspektet gjinore të incidentit, siç janë stereotipat, diskriminimi, mostoleranca, kërcënimet seksuale dhe frikësimi. Ky informacion duhet të përdoret për të përcaktuar veprimet vijuese dhe për të avancuar grumbullimin e të dhënave në lidhje me manifestimet e ndryshme të ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetarëve.

Funksionet e zbatimit të ligjit mund të kontribuojnë në të kuptuarit më të mirë dhe zhvillimin e reagimit me politika ndaj ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj grave gazetare. Autoritetet duhet të sigurojnë ose të përkrahin mbledhjen dhe analizën e të dhënave në lidhje me këtë çështje,¹¹ punë kjo që mund të orientojë dhe përforcojë reagimin parandalues dhe hetimor, në pajtim të plotë me detyrimet për mbrojtjen e të dhënave dhe standardet e mbrojtjes së privatësisë. Gazetarët që raportojnë incidentet duhet të informohen qartë në lidhje me përdorimin dhe përpunimin e informacionit të tyre, si dhe mjetet juridike që mund t'i gëzojnë në rast të shkeljeve apo abuzimeve.

Shembuj

Vendosja e protokolleve për vlerësimin e kërcënimeve dhe rreziqeve: Me qëllim zhvillimin e një protokolli model për vlerësimin e rreziqeve,¹² si dhe për t'i përmirësuar bashkërisht përgjigjet që autoritetet e zbatimit të ligjit u japin gazetarëve që përballen me rreziqe të veçanta të lidhura me punën e tyre, Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për përmbarimin jashtëgjyqësor, të përshpejtuar apo arbitrar u ka bërë thirrje shteteve të mbështesin grumbullimin e praktikave të mira në hetim, vlerësim dhe/ose reagim ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve që u kanosen gazetarëve. Protokollet e tilla duhet të përfaqësojnë nocionet digjitale dhe teknologjike të kërcënimeve dhe rreziqeve me të cilat përballen gazetarët.

› **Të përforcohen protokollet, metodat dhe procedurat e hetimit të krimeve ndaj gazetarëve dhe lirisë së shprehjes**

Përforcimi i hetimeve të sulmeve ndaj gazetarëve është qenësor në luftimin e mosndëshkimit, por kur bëhet kjo, është e rëndësishme të inkorporohet një qasje gjinore që u përgjigjet manifestimeve, ndikimeve dhe rreziqeve të ndryshme me të cilat përballen përkatësisht gratë dhe burrat.¹³

Adresimi i mosndëshkimit të krimeve ndaj gazetarëve kërkon hetime të zellshme, të paanshme dhe efektive që synojnë zbardhjen e së vërtetës dhe përcjelljen, arrestimin, ndjekjen penale dhe përfundimisht ndëshkimin e të gjithë autorëve të krimeve kundër gazetarëve.¹⁴

Një nga masat që autoritetet e zbatimit të ligjit duhet të ndërmarrin është të krijojnë njësi të posaçme brenda policisë dhe prokurorive për hetimin e krimeve ndaj gazetarëve, ose të krijojnë ndonjë plan veprimi të ngjashëm e adekuat, që mundësojnë prioritizimin dhe specializimin e hetimeve të krimeve kundër gazetarëve. Këto njësi ose veprime të posaçme duhet të ndërtojnë operacionet e tyre mbi metodat, procedurat ose protokollet e zhvilluara përmes praktikave të mira të ndara mes palësh.

Në vijim, agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të kenë resurse të mjaftueshme për t'i dhënë përparësi vlerësimeve të rrezikut dhe hetimeve të krimeve kundër grave gazetare. Përveç këtyre, atyre u duhet dhënë kapaciteti për të zhvilluar një grupim të specializuar standardesh, procedurash dhe protokolleesh për të siguruar që hetimi i krimeve kundër gazetarëve të përfshijë, si rregull, shterimin e pistave të hetimit lidhur me aktivitetin gazetar të viktimës. Kur agjencitë e zbatimit të ligjit vendosin të mos gjurmojnë apo shterojnë këtë pistë hetimi, ato duhet ta arsyetojnë këtë vendim me shkrim, si dhe ta dorëzojnë për miratim tek ndonjë zyrtar i nivelit më të lartë. Në rastet që përfshijnë gratë gazetare, çështjet gjinore duhet të theksohen në raport.

Kur kërcënimet dhe ngacmimet në internet përbëjnë vepra penale që duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si krimet jashtë interneti, autoritetet e zbatimit të ligjit duhet të vlerësojnë protokollet e tyre ekzistuese të hetimit dhe masat parandaluese, ashtu që të identifikojnë praktikatat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga të gjitha procedurat që zbatohen në parandalim dhe hetim të këtyre krimeve. Në dobi të një vlerësimi të tillë mund të jetë pjesëmarrja e organizatave dhe ekspertëve që punojnë me individë të abuzuar, si dhe me gazetaret që kanë hasur në pengesa në qasjen e tyre në sistemin e drejtësisë penale.

Shembuj

Ofrimi i udhëzimeve gjyqësore të nivelit të lartë: Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës në Mbretërinë e Bashkuar ka ofruar udhëzime për vendimet në rastet që përfshijnë komunikime të dërguara përmes rrjeteve sociale me anë të botimit të tij [Mediat sociale - Udhëzues për ndjekjen penale të rasteve me komunikime të dërguara përmes rrjeteve sociale](#), i cili ofron sqarime mbi atë se cilat komunikime në rrjete sociale mund të konsiderohen vepra penale.¹⁵

Caktimi i përgjegjësisë së veçantë: Policia në Kosovë ka caktuar Departamentin e saj të Krimeve të Rënda për të hetuar sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve. Në një masë të lidhur me këtë, Gjykata Themelore e Prishtinës ka caktuar koordinatorin për rastet e gazetarëve.¹⁶

Burime

- Disa organizata të shoqërisë civile, së bashku me Prokurorinë Publike, kanë miratuar një protokoll të posaçëm për hetimin e krimeve kundër lirisë së shprehjes në Meksikë. Ai përmban standardet operacionale të hetimit dhe mbledhjes së provave, bashkëpunimin midis autoriteteve të ndryshme dhe masat për të orientuar dhe koordinuar individët në fjalë me shërbimet përkatëse.¹⁷
- Dokumenti i Politikave nga ARTICLE 19 [Hetimi i ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj grave gazetare](#) trajton fushëveprimin e detyrimeve të Shtetit për të adresuar ngacmimet dhe abuzimet në internet të gazetareve, si dhe për të kryer hetime efektive të ngacmimeve dhe abuzimeve në internet.¹⁸

› **Të avancohet dialogu dhe bashkërendimi për sigurinë e gazetarëve midis autoriteteve të zbatimit të ligjit, mediave dhe shoqërisë civile**

Për ta ngritur besimin e publikut në shtetin e së drejtës dhe për të luftuar efektivisht diskriminimin gjinor, autoritetet e zbatimit të ligjit duhet të promovojnë, lehtësojnë dhe inkurajojnë bashkërendimin midis policisë, prokurorëve, organizatave të medias dhe shoqërisë civile. Është qenësore që gazetarët që kanë qenë në shënjestër të sulmeve në internet dhe/ose jashtë tij si dhe krimeve tjera ta raportojnë krimin në polici.

Dialogu midis këtyre palëve duhet të përqendrohet në adresimin e shkaqeve bazë të pandëshkueshmërisë për krimet kundër gazetarëve, si dhe rolin e teknologjisë, si në ushtrimin e të drejtave të njeriut ashtu

edhe në rrezikun që paraqet ajo ndaj të drejtave të gazetarëve. Ky dialog duhet të zhvillohet mbi bazën e pajtimit të gjerë të të gjithëve se është thelbësore që të ketë kontribut nga të sulmuarit, si dhe nga grupet që mbështesin njerëzit që kanë përjetuar ngacmime dhe abuzime në internet, kur agjencitë e zbatimit të ligjit duan të hartojnë, zhvillojnë ose zbatojnë procedura që trajtojnë praktikën diskriminuese dhe pengesat strukturore. Bashkërendimi midis pjesëmarrësve duhet të rezultojë me metoda dhe procedura të reja, ose me forcimin e atyre ekzistuese, për të siguruar llogaridhënie dhe zgjidhje.

Autoritetet e zbatimit të ligjit mund të marrin pjesë edhe në nisma të bashkëpunimit ndërkombëtar, të tilla si ato të organizuara nga Zyra e OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC), apo për shembull ato të drejtuar nga Komisioni për Parandalimin e Krimit dhe për Drejtësi Penale. Nisma të tilla ofrojnë hapësirë për të shkëmbyer ekspertizë, përvoja dhe informacion në lidhje me praktikën e drejtësisë penale dhe parandalimin e krimeve kundër gazetarëve. Shoqëria civile dhe sektori i medias duhet të përfshihen gjithashtu në këto nisma.

Shembuj

Bashkëpunimi për përmirësim të hetimeve: Shërbimet holandeze të policisë dhe prokurorisë, së bashku me Shoqatën Holandeze të Kryeredaktorëve, janë pajtuar të përmirësojnë hetimet e sulmeve kundër gazetarëve, duke përfshirë zbatimin e masave të tilla si regjistrimi sistematik i rasteve, prioritizimi i sulmeve kundër gazetarëve, si dhe vënia në dispozicion dhe ofrimi i transparencës së informatave për viktimat.¹⁹

Vendosja e bazave të përbashkëta për ndërveprimin: Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (ECPMF) ka krijuar burimin virtual webpolicecodex.eu për të përmirësuar bashkëpunimin midis policisë dhe organizatave të medias.²⁰ Kodi përbëhet nga tetë udhëzues për policinë se si të reagojnë, trajtojnë dhe punojnë me gazetarët. Të tetë udhëzuesit trajtojnë konfliktet më të rëndësishme në Evropë midis dy grupeve profesionale, sipas gjetjeve të ECPMF-së.

Mundësimi i trajnimit të përbashkët për të përmirësuar dialogun: UNESCO ka lehtësuar dialogun dhe punëtori të strukturuar për personelin e zbatimit të ligjit dhe gazetarët në vende të ndryshme, si Ukraina, Nepali, Tunizia, Senegali, Tanzania, Somalia, Burkina Faso dhe Tunizia.²¹

Të ftohen më shumë palë në dialog: Komisioni i UNODC-së për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale udhëheq dialogë për sigurinë e gazetarëve ku marrin pjesë përfaqësues nga qeveritë dhe shoqëria civile.²²

Ofrimi i trajnimeve për çështje të caktuara, me shënjestra potenciale: Departamenti i OSBE-së për Kërcënimet Tejkufitare ka trajnuar policinë në Armeni për të përmirësuar dialogun me shoqërinë civile gjatë demonstratave, përfshirë vëmendjen e veçantë ndaj grave protestuese.²³

Burime

- Pas një sërë seminaresh me zyrtarë të zbatimit të ligjit dhe gazetarë në Ukrainë, UNESCO-ja publikoi një raport dhe një video incizim për të ndarë përvojën e tyre.²⁴

Shënime fundore

- 1 UN Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, OSCE Representative on Freedom of the Media, Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and African Commission on Human and Peoples' Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information, "Joint Declaration on Crimes against Freedom of Expression", 25 June 2012, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/91595>.
- 2 UN General Assembly Resolution 74/157, "The safety of journalists and the issue of impunity", 18 December 2019, <https://undocs.org/A/RES/74/157>.
- 3 OSCE RFoM, "Communiqué on the growing safety threat to female journalists online", 6 February 2015, <https://www.osce.org/fom/139186?download=true>.
- 4 "New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists", OSCE RFoM, 2016, <https://www.osce.org/fom/220411>.
- 5 Council of Europe, "How to protect journalists and other media actors? Implementation Guide to selected topics under the Protection and Prosecution pillars of the Guidelines of Recommendation CMJ/Rec(2016)4 on the protection of journalism and safety of journalists and other media actors", DGI(2020)11, 2020, p. 21, <https://rm.coe.int/safety-implementation-guide-en-16-june-2020/16809ebc7c>.
- 6 "A Handbook for Police and Crown Prosecutors on Criminal Harassment", Government of Canada, Department of Justice, <https://www.justice.gc.ca/eng/rp-pr/cj-jp/fv-vf/har/parti.html#cybstalk>.
- 7 UNESCO, Freedom of Expression and Public Order: Training manual, Tunis, 2015, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000231305>.
- 8 "Almaty Training on Freedom of Expression and Public Order", UNESCO news item, 9 December 2019, <https://en.unesco.org/news/almaty-training-freedom-expression-and-public-order>.
- 9 ARTICLE 19, "Investigating online harassment and abuse of women", 2020, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2020/10/Gender-Paper-Brief-3-.pdf>.
- 10 UN Human Rights Council, Report of the Special Rapporteur on extrajudicial, summary or arbitrary executions, "Investigation of, accountability for and prevention of intentional State killings of human rights defenders, journalists and prominent dissidents", A/HRC/41/CRP.1, 19 June 2019, https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/41/36.
- 11 OSCE RFoM, "Recommendations following the Expert Meeting New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists", 17 September 2015, <https://www.osce.org/fom/193556?download=true>.
- 12 Op. cit. endnote 10.
- 13 Op. cit. endnote 1.
- 14 UN General Assembly, Resolution 39/6, "The safety of journalists", 27 September 2018, <https://undocs.org/A/HRC/RES/39/6>.
- 15 "Social Media - Guidelines on prosecuting cases involving communications sent via social media", The Crown Prosecution Service, <https://www.cps.gov.uk/about-cps>.
- 16 Petrit Çollaku, "Kosovo Indicators on level of media freedom and journalists' safety", Association of Journalists of Kosovo, 2018.
- 17 Procuraduría General de la República, Estados Unidos Mexicanos, "Protocolo homologado de Investigación de delitos cometidos contra la libertad de expresión", October 2018, https://www.gob.mx/cms/uploads/attachment/file/444272/Protocolo_homologado_de_investigaci_n_de_delitos_cometidos_contra_la_libertad_de_expresi_n.pdf.
- 18 ARTICLE 19, "Investigating online harassment and abuse of women", 2020, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2020/10/Gender-Paper-Brief-3-.pdf>.

- 19 “Agreement of the Steering Group on Aggression and violence against journalists” (Unofficial translation by Tarlach McGonagle), The Hague, 2018, <https://www.ivir.nl/publicaties/download/Agreement-of-the-Steering-Group-on-Aggression-and-violence-against-journalists-EN-translation.pdf>. All information related to the safety “mechanism” in The Netherlands is now available in this website, in Dutch: <https://www.persveilig.nl/>.
- 20 The European Centre for Press and Media, The Press Freedom Police Codex, <https://police-codex.eu/>.
- 21 “UNESCO partners with Tunisian Ministry of the Interior to improve safety of journalists”, UNESCO news item, 2019, <https://fr.unesco.org/news/1%E2%80%99unesco-et-le-minist%C3%A8re-de-l%E2%80%99int%C3%A9rieur-de-la-tunisie-coop%C3%A8rent-pour-am%C3%A9liorer-la-s%C3%A9curit%C3%A9-des>.
- 22 “The Safety of Journalists: Report on UNODC CCCPCJ Side-Event”, Academic Council of the United Nations System, 7 July 2014, <https://acuns.org/the-safety-of-journalists-report-on-unodc-cccpcj-side-event/>.
- 23 “OSCE Transnational Threats Department / Strategic Police Matters Unit introduces concept of dialogue policing to senior police officers and parliamentarians in Armenia”, OSCE polis, November 2019, <https://polis.osce.org/osce-introduces-concept-dialogue-policing-senior-police-officers-and-parliamentarians-armenia>.
- 24 “Film on the training of Ukrainian law enforcement officers on freedom of expression & safety of journalists”, UNESCO news item, 11 April 2018, <https://en.unesco.org/news/film-training-ukrainian-law-enforcement-officers-freedom-expression-safety-journalists>.



**Organizatat
ndërqeveritare**

Veprimet e propozuara

1. Të integrohen qasje me ndjeshmëri gjinore brenda standardeve dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut lidhur me sigurinë e gazetarëve;
2. Mbështetje për shtetet në adresimin e mangësive në zbatim të standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve;
3. Ndihmë në rritjen e të dhënave dhe hulumtimeve që të shërbejnë si bazë për nismat për sigurinë e gazetarëve në internet;
4. T'i jepet përparësi bashkëpunimit dhe bashkërendimit të palëve për të shtresuar ndikimin e duhur.

5. Organizatat ndërqeveritare

Nga vendosja e standardeve tek ndihma për Shtetet

Qoftë ato të natyrës globale, si Kombet e Bashkuara (OKB), ose me ato me fokus rajonal, si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), organizatat ndërqeveritare (ONQ) mund të luajnë rol të rëndësishëm në përforcimin e standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut, përfshirë ato që kanë ndikim në sigurinë e gazetareve. ONQ-të mund t'u ndihmojnë anëtarëve të tyre, ose Shteteve pjesëmarrëse, t'i zbatojnë këto standarde në nivel vendi. Ky kapitull ofron një përzgjedhje të veprimeve të propozuara që ONQ-të mund t'i ndërmarrin për të përforcuar punën e tyre lidhur me sigurinë e gazetareve në internet.

Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së u bën thirrje Shteteve që të “bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin e OSBE-së për Liri të Mediave, përfshirë edhe në çështjen e sigurisë së gazetarëve” si dhe të “inkurajojnë avokimin e vazhdueshëm të Përfaqësuesit të OSBE-së për Liri të Mediave dhe promovimin e sigurisë së gazetarëve në të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, në pajtim me mandatin e tij/saj.”

- › **Të integrohen qasje me ndjeshmëri gjinore brenda standardeve dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut lidhur me sigurinë e gazetarëve**

Numri i standardeve dhe zotimeve ndërkombëtare në lidhje me sigurinë e gazetarëve është rritur në vitet e fundit, ndërsa gratë gazetare kanë qenë në fokus të veçantë në shumë prej këtyre teksteve. Për shembull, rezolutat

e OKB-së dhe zotimet e UNESCO-s, kanë theksuar në mënyrë progresive nevojën për të adresuar kërcënimet specifike me të cilat përballen gratë gazetare në internet dhe jashtë tij. Organizatat rajonale, si OSBE-ja, kanë integruar po ashtu çështjen e sigurisë së gazetareve në tekstet e tyre për sigurinë e gazetarëve.

Ky shtim i vëmendjes përbën ndryshim pozitiv në të menduarit për sigurinë e grave gazetare si pjesë përbërëse e sigurisë së gazetarëve dhe shprehjes së lirë. Sidoqoftë, është ende e domosdoshme të punohet drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse me ndjeshmëri gjinore në të gjitha standardet, qasje kjo që jo vetëm promovon mbrojtjen e gazetareve, por edhe i fuqizon ato. Sigurisht, zërat e grave duhet të jenë pjesë e këtij procesi.

Ka shumë mekanizma të OKB-së dhe të tjerë rajonalë për të drejtat e njeriut dhe nisma të tjera që trajtojnë çështjen e sigurisë së gazetarëve. Fatkeqësisht, jo të gjitha sosh kanë qasje të përgjegjshme gjinore plotësisht të integruar, ose nuk i janë përgjigjur pyetjes se si ngacmimi dhe abuzimi në internet ndikon në punën dhe jetën e gazetarëve, si dhe se si mund të adresohet ky problem. Nismat bashkërenduese, si [Plani i veprimtimit i OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e pandëshkueshmërisë](#)¹ si dhe personat e kontaktit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve, mund të përdoren për të përforcuar qasjen gjinore.

Përveç këtyre, ka hapësirë për mekanizmat ekzistues të drejtave të njeriut brenda ONQ-ve - të cilët ofrojnë një formë të reagimit të shpejtë ndaj shkeljeve të drejtave të njeriut - për të rritur vëmendjen e tyre ndaj çështjes së sigurisë së gazetareve në internet. Organet në kuadër të ONQ-ve mund të marrin parasysh edhe krijimin e mekanizmave të rinj të reagimit të shpejtë, si formë e pranimit të ashpërsisë së kërcënimeve në rritje ndaj gazetarëve.

Shembuj

Të zbatohen ato që janë dakorduar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së: Për shembull [Rezoluta 74/157 e OKB-së e vitit 2019](#) vendosi standardin për të integruar qasje “me ndjeshmëri gjinore” në të gjitha masat parandaluese dhe mbrojtëse, procedurat hetimore dhe ndjekjen penale të dhunës ndaj gazetarëve.² ONQ-të duhet të zbatojnë të njëjtat standarde.

Mbështetja për funksionet e pavarura të ONQ-ve për sigurinë e gazetarëve: Mandati i Përfaqësuesit të OSBE-së për Liri të Mediave (PLM) i vitit 1997 thekson që: “ai/ajo do të marrë përsipër funksionin e paralajmërimit të hershëm. Ai/ajo do të adresojë problemet serioze të shkaktuara mes tjerash nga pengimi i veprimtarive mediale dhe kushtet e pafavorshme të punës për gazetarët.”³ Puna e përditshme e Përfaqësuesit përfshin vlerësimin e rasteve dhe ngritjen e vëmendjes për to. OSBE-ja ka zbatuar integrimin e perspektivës gjinore që nga viti 2004.⁴ PLM nisi projektin e tij mbi sigurinë e gazetarëve në internet (#SOFJO) në vitin 2015,⁵ ndërsa [Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve](#) i vitit 2018 i njezh rreziqet specifike me të cilat përballen gratë gazetare dhe u bën thirrje Shteteve pjesëmarrëse të dënojnë publikisht sulmet ndaj grave në internet dhe jashtë tij.⁶

Burime

- OSBE-ja ka publikuar disa [udhëzues](#) për mënyrën e integritit të qasjeve gjinore në nismat e tyre të ndryshme dhe ngjarjet që ndihmojnë OSBE-në të sigurojë qasjen gjinore brenda veprimtarisë së saj. Raportet dyvjeçare nga [PLM që i drejtohen Këshillit të Përhershëm](#)

[të OSBE-së](#) prezantojnë rastet dhe kërcënimet ndaj lirisë së medias që Përfaqësuesi ka ngritur gjatë secilës periudhë të raportimit.⁷

- Rekomandimet rreth mënyrës së integritimit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet në sistemin e OKB-së janë në dispozicion në [Rezolutën e OKB-së 2019/2](#) të Këshillit Ekonomik dhe Social, i cili ofron rekomandimet.⁸
- Udhëzues nga ARTICLE 19: [Dhënia fund mosndëshkimit: Veprimi në kuadër të standardeve të OKB-së për sigurinë e gazetarëve](#) përmbledh zotimet ekzistuese dhe përmban një kapitull në lidhje me zbërthimin e qasjeve të përgjegjshme gjinore ndaj standardeve ndërkombëtare të sigurisë së gazetarëve.⁹
- [Shpjeguesit 5-minutësh të Rrjetit IFEX](#) janë vegla për të ndihmuar në demitizimin e standardeve ndërkombëtare mbi sigurinë e gazetarëve.¹⁰

› **Mbështetje për Shtetet në adresimin e mangësive në zbatim të standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve**

Kur bëhet fjalë për standardet ndërkombëtare, çështja e ngutshme shpesh është se si t'i bëjmë ato realitet dhe të mos lejohen të mbesin fjalë boshe. Me rritjen e mbështetjes së drejtpërdrejtë, ndihmës dhe ekspertizës për Shtetet, ONQ-të mund të ndihmojnë në zbatimin dhe konkretizimin e standardeve ndërkombëtare për ngacmimin dhe abuzimin me bazë gjinore në internet ndaj gazetarëve. Një mënyrë mund të jetë hartimi i një analize ligjore për legjislacionin ekzistues

që vlen në rastet e kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe për ofrimin e rekomandimeve përkatëse.

Gjithashtu, ONQ-të mund të mbështesin grumbullimin e praktikave të mira në lidhje me çështjet qenësore për sigurinë e gazetarëve në internet, si udhëzuesit për hetimin e rasteve të ngacmimit dhe abuzimit, mekanizmat e mbrojtjes dhe masat që kanë ndikim në reduktimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj grave gazetare. Bashkëpunimi me autoritetet shtetërore dhe ato vartëse, si dhe mbështetja për to në hetime, është një mënyrë tjetër produktive për të ndihmuar Shtetet.

Një aspekt tjetër i mbështetjes që ONQ-të mund të ofrojnë ka të bëjë me zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve publike që punojnë në çështje të lidhura me sigurinë e gazetarëve, ngacmimet dhe abuzimet në internet, si dhe qasjet gjinore. Të gjitha përpjekjet e ONQ-ve për të zhvilluar ekspertizën tek palët shtetërore, siç janë udhëzuesit ose doracakët e trajnimit për të drejtat e njeriut, duhet të përmbajnë kapituj për të drejtën e lirisë së shprehjes, sigurinë e gazetarëve në internet dhe jashtë tij, si dhe qasje të fuqishme gjinore.

Periudhat zgjedhore shpesh prodhojnë dhunë të shtuar dhe frikësim të gazetarëve, përfshirë akte të agresionit në internet.¹¹ Këto sulme tkurrin qasjen e qytetarëve në informata, para dhe gjatë kohës së votimit. ONQ-të mund të mbështesin analizën e dhunës ndaj gazetarëve, përfshirë ngacmimet dhe abuzimet me bazë gjinore në internet, në kuadër të misionëve të vëzhgimit të zgjedhjeve. Duhet të merren edhe masa të tjera vëzhgimi dhe parandalimi shumë përpara periudhës zgjedhore, kur sulmet kundër gazetarëve rriten në numër.

Shembuj

Publikimi i raporteve me praktika të mira: Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave ka publikuar dhe ka kontribuar në disa raporte mbi sigurinë e gazetareve në internet, duke përfshirë këtu analizën e praktikave të mira dhe rekomandimeve në këtë fushë. Informatat janë në dispozicion në faqen e dedikuar [SOFJO](#).¹²

Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Dhunën ndaj Grave, Shkaqet dhe Pasojat e saj ka publikuar një raport mbi [Luftimin e dhunës ndaj grave gazetare](#), i cili ofron rekomandime specifike për OKB-në dhe shtetet anëtare se si të adresohet dhuna ndaj grave gazetare.¹³

Integrimi i qasjeve gjinore në raporte dhe analiza: Në raportin për [Sigurinë e gazetareve që mbulojnë protestat](#), UNESCO ka realizuar një analizë ndërsektoriale, duke marrë parasysh faktorët gjinorë dhe ata të diversitetit. Raporti ofron praktika të mira, siç janë trajnimi policor dhe masat e sigurisë që gazetarët mund t'i ndërmarrin vetë, si dhe rekomandime se si të përmirësohet siguria e gazetareve derisa mbulojnë protestat.¹⁴

Publikimi i raporteve të thukëta: Raportuesi i Posaçëm i Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut (IACHR) për Lirinë e Shprehjes ka publikuar një raport të gjerë mbi gazetaret dhe lirinë e shprehjes, që përmban rekomandime të shumta se si të avancohet siguria e grave gazetare në internet dhe jashtë tij.¹⁵

Udhëzues që vendosin standardin: [Udhëzuesi për sigurinë e gazetareve](#) nga PLM i OSBE-së ofron udhëzime të përgjithshme për Shtetet se si të promovojnë sigurinë e gazetareve.¹⁶ Edicionet vijuese të tij do të duhej të përfshinin kapituj më të thelluar për sigurinë e grave gazetare.

Realizimi i analizave ligjore: Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) rregullisht realizon [analiza ligjore](#) të çështjeve të ndryshme, përfshirë dhunën ndaj grave, në rajonin e OSBE-së, por edhe raportuesit e posaçëm ndërkombëtarë dhe rajonalë, lidhur me mandatet për lirinë e shprehjes.¹⁷

Përfshirja e sigurisë së gazetarëve në nismat e qeverisjes: Në vitin 2012, ODIHR publikoi një doracak mbi monitorimin e mediave për Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve. Publikime të ngjashme, ose edicionet tjera të tyre, krahas trajtimit të ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj gazetarëve, si dhe ndikimit të tyre në zgjedhjet e lira mund të përmbajnë edhe rekomandime për atë se si të ndahen të dhënat sipas gjinisë.¹⁸

Integrimi i qasjeve gjinore në OZHQ: Publikimi i vitit 2016 nga UN Women [Shtytja e zbatimit me ndjeshmëri gjinore të agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm](#) është një shembull i mirë i një nisme më të gjerë për të përforcuar zbatimin me qasje gjinore të standardeve ndërkombëtare.¹⁹

Shqyrtimi i mekanizmave ekzistues të mbrojtjes: Zyra e Komisionerit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka realizuar një shqyrtim të thelluar të mekanizmave të mbrojtjes në Meksikë, dhe ka ofruar një listë prej më se 100 rekomandimeve për zbatimin e tyre me efektshmëri dhe ndjeshmëri gjinore.²⁰

Përbashkimi në hetimet e krimeve kundër gazetarëve: Një Ekip i Posaçëm Përcjellës për hetimin e vrasjes së tre gazetarëve në kufirin mes Ekuadorit dhe Kolumbisë u krijua, pa ndonjë precedent paraprak, nga të dy shtetet dhe Raportuesi i Posaçëm për Lirinë e Shprehjes i Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut, duke dhënë kështu shembull të mirë sesi ONQ-të mund të shoqërojnë hetimet për krime kundër gazetarëve.²¹

Ndihmë në rritjen e të dhënave dhe hulumtimeve që të shërbejnë si bazë për nismat për sigurinë e gazetareve në internet

Në shumë vende, palë të ndryshme mbledhin të dhëna për sigurinë e gazetareve në mënyra të ndryshme, por këto nuk pasqyrojnë gjithmonë dallimet specifike gjinore. ONQ-të mund të luajnë rol të rëndësishëm, si për standardizimin e mbledhjes së të dhënave, ashtu edhe për diversitetin, duke përkrahur një qasje që përmban analiza më të fuqishme gjinore në mbledhjen dhe hulumtimin e të dhënave. Kjo do të kontribuonte në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ), në veçanti OZHQ-në nr. 5 për barazinë gjinore, si dhe OZHQ nr. 16 për paqen, drejtësinë dhe institucionet e forta.

Hulumtimet dhe studimet globale dhe rajonale, në veçanti ato që përfshijnë mbledhjen e praktikave të mira, janë të vlefshme për shtytjen e promovimit të sigurisë së gazetareve në internet, si dhe për të ofruar rekomandime më të hollësishme për Shtetet dhe aktorët tjerë përkatës. Studime të tilla preferohet të bëhen në bashkëpunim me institucionet akademike dhe organizatat e shoqërisë civile, ndërsa raportet e tyre më së miri është të shpërndahen gjerësisht dhe në rastet kur mund të diskutohen zgjidhjet për ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj gazetareve. Kjo shkon paralelisht me aktivitetet e ndërgjegjësimit, të cilat nga ana tjetër mund të jenë mënyrë e mirë për të mobilizuar aktorët kryesorë për sigurinë e gazetareve në nivelin kombëtar. Kur kanë kufizime kohore dhe buxhetore, ONQ-të duhet të kenë vendimmarrësit si audiencë kryesore të synuar.

Shembuj

Ndërgjegjësimi për nevojën për hulumtime të sakta dhe të vazhdueshme: PLM i OSBE-së ka krijuar një nismë me fokus në [Sigurinë e gazetareve në internet \(SOFIO\)](#), e cila përfshin një

dokumentar të metrazhit të gjatë të titulluar “Një vend i errët”.²² Filmi është shfaqur në shumë organizime nëpër botë dhe në universitete. Në vitin 2019, PLM mbajti Konferencën #SOFJO [Rritja e mundësive për lirinë e shprehjes dhe pluralizmit të mediave](#).²³

Monitorimi dhe përhapja e njohurive bazuar në të dhëna dhe hulumtime: [Raporti i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s mbi sigurinë e gazetarëve dhe rrezikun e pandëshkueshmërisë](#)²⁴ dhe [Raporti për trendet botërore të lirisë së shprehjes dhe zhvillimit të medias](#) monitorojnë dhunën ndaj gazetarëve dhe ofrojnë të dhëna në hulumtimet e tyre të vrasjeve dhe mosndëshkimit. Raporti i trendeve botërore gjithashtu vë në dukje kërcënimet me bazë gjinore ndaj grave gazetare.²⁵

Shkëmbimi i gjetjeve dhe praktikave të mira, si dhe sugjerimi i përgjigjeve të arritshme: Në vitin 2017, Programi ndërkombëtar i UNESCO-s për zhvillimin e komunikimit (PNZHK) publikoi një koleksion të praktikave të mira për sigurinë e gazetarëve nga aktorë të ndryshëm, koleksion ky që mund të informojë iniciativat e ardhshme në këtë fushë. Publikimi Sulmi ndaj njërës është sulm ndaj të gjithëve përmban shembuj të reagimeve të zhvilluara nga OJQ-të dhe profesionistët e mediave ndaj kërcënimeve në internet dhe jashtë tij ndaj gazetarëve.²⁶ PNZHK ka publikuar gjithashtu një raport analitik mbi [Rolin e PNZHK-së në promovimin e sigurisë së gazetarëve: Rruga përpara](#), i cili përmban rekomandime për fuqizimin e qasjes gjinore.²⁷

Informimi i palëve të interesit për lajmet më të fundit: UNESCO-ja boton një [Buletin dymujor](#) për zbatimin e Planit të veprimit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e pandëshkueshmërisë, që përmban lajme për standardet ndërkombëtare, politikat kombëtare, hulumtimet, nismat e shoqërisë civile dhe informacione të tjera të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve.²⁸

T'i jepet përparësi bashkëpunimit dhe bashkërendimit të palëve për të shtresuar ndikimin

Zyrat e ONQ-ve në terren shpesh nuk i kanë njohuritë e mjaftueshme për çështjet e brendshme të sektorit të medias, por as pasqyrën e plotë të qasjeve që nevojiten për sigurinë e gazetareve. Për një përmirësim real dhe efektiv të sigurisë së gazetarëve, ka nevojë urgjente për më shumë ekspertizë mbi çështjet gjinore në lidhje me mediat dhe gazetarinë, si dhe mbi standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Misionet në terren dhe ekipet vendore të ONQ-ve duhet të jenë të pajisur më mirë dhe të kenë njohuri të specializuara për të mbështetur zbatimin efektiv të standardeve ndërkombëtare në nivelin kombëtar. Për shembull, personelit të ONQ-ve mund t'u ofrohet trajnim për çështjet që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe barazinë gjinore.

Çështja e sigurisë së gazetarëve është kthyer në fokus kryesor të organeve të ndryshme të OKB-së dhe organizatave rajonale. Fuqizimi i bashkërendimit dhe shkëmbimit të informatave midis tyre, si në nivelin ndërkombëtar ashtu edhe midis atyre që veprojnë në nivel vendi, do të rriste ndikimin e tyre përfundimtar.

ONQ-të duhet që të krijojnë gjithashtu mundësi për të bashkëpunuar me nismat ndërkombëtare dhe rajonale të drejtuara nga Shteti, të cilat kanë çështjen e sigurisë së gazetarëve në mandatin e tyre.

Shembuj

Bashkëveprimi me homologët: Që nga viti 1999, bartësit e mandateve të posaçme për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias të OSBE-së, OKB-

së, Organizatës së Shteteve Amerikane dhe Komisionit Afrikan për të Drejtat e Popujve dhe të Njeriut, çdo vit nxjerrin deklaratë të përbashkët, duke dhënë rekomandime se si të adresohen sfidat specifike që lidhen me të drejtën e lirisë së shprehjes.²⁹


Ndërtimi i aleancave midis ONQ-ve kur ka nevojë: PLM i OSBE-së dhe Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës kanë nxjerrë deklarata të përbashkëta, përfshirë për luftimin e dhunës me bazë gjinore në internet.³⁰

Bashkërendimi i rregullt i punës suaj me ONQ-të tjera: UNESCO udhëheq një rrjet të personave të kontaktit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve, që bashkërendon zbatimin e Planit të veprimit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e pandëshkueshmërisë midis 14 agjencive dhe organeve të OKB-së. UN Women, organ që mund të mbështesë qasjen e përgjegjshme gjinore në këtë fushë, është ndër agjencitë pjesëmarrëse.³¹

Shënime fundore

- 1 UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity, UNESCO, CI-12/CONF.202/6, 2012, <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists>.
- 2 UN General Assembly, Resolution 74/157, “The safety of journalists and the issue of impunity”, 18 December 2019, <https://undocs.org/A/RES/74/157>.
- 3 OSCE, Permanent Council Decision No. 193, “Mandate of the OSCE Representative on Freedom of the Media”, PC.DEC/193, 5 November 1997, <https://www.osce.org/pc/40131>.
- 4 OSCE, Ministerial Council Decision No. 14/04, “2004 OSCE Action Plan for the Promotion of Gender Equality”, 7 December 2004, <https://www.osce.org/files/f/documents/7/d/23295.pdf>.
- 5 OSCE RFoM project on the Safety of Female Journalists Online (#SOFJO), launched in 2015, <https://www.osce.org/fom/sofoj>.
- 6 OSCE, Ministerial Council Decision No. 3/18, “Safety of Journalists”, 7 December 2018, <https://www.osce.org/chairmanship/406538?download=true>.
- 7 OSCE RFoM, Publications, collected: [https://www.osce.org/resources/publications?filters=+im_taxonomy_vid_1:\(19\)+im_taxonomy_vid_3:\(122\)](https://www.osce.org/resources/publications?filters=+im_taxonomy_vid_1:(19)+im_taxonomy_vid_3:(122)). OSCE RFoM’s statements and regular reports to the Permanent Council, collected: <https://www.osce.org/fom/66084>.
- 8 UN Economic and Social Council, Resolution 2019/2, “Mainstreaming a gender perspective into all policies and programmes in the United Nations system”, 6 June 2019, <https://undocs.org/en/E/RES/2019/2>.
- 9 ARTICLE 19, “Ending Impunity: Acting on UN Standards on the Safety of Journalists”, 2019, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2019/11/SOJ-Web.pdf>.
- 10 IFEX, “Collection of 5-minute explainers to help civil society engage in global spaces for free expression advocacy”, <https://ifex.org/resources/5-minute-explainers/>.
- 11 UN Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, OSCE Representative on Freedom of the Media, Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and African Commission on Human and Peoples’ Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information, “Joint Declaration on Freedom of Expression and Elections in the Digital Age”, 30 April 2020, https://www.osce.org/files/f/documents/9/8/451150_o.pdf.
- 12 Op. cit. endnote 4.
- 13 UN Human Rights Council, Report by the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences, “Combating violence against women journalists”, A/HRC/44/52, 2020, <https://undocs.org/en/A/HRC/44/52>.
- 14 UNESCO, “Safety of Journalists Covering Protests: Preserving Freedom of the Press During Times of Turmoil”, CI-2020/WTR/3, September 2020, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000374206>.
- 15 Edison Lanza, “Violence against journalists and media workers: Inter-American standards and national practices on prevention, protection and prosecution of perpetrators”, Inter-American Commission on Human Rights, OEA/Ser.L/V/II. CIDH/RELE/INF. 12/13, 31 December, 2013, http://www.oas.org/en/iachr/expression/docs/reports/2014_04_22_violence_web.pdf.
- 16 William Horsley, “OSCE Safety of Journalists Guidebook”, OSCE RFoM, 2014, <https://www.osce.org/fom/118052?download=true>.
- 17 OSCE, Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR), Legislationonline.org, 2020, <https://www.legislationline.org/>.
- 18 OSCE ODIHR, “Handbook On Media Monitoring for Election Observation Missions”, 2012, <https://www.osce.org/odihr/elections/92057>.

- 19 UN Women, “Driving the Gender Responsive Implementation of the 2030 Agenda for Sustainable Development”, 2016, <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2016/driving-gender-responsive-implementation-2030agenda.pdf?la=en&vs=5353>.
- 20 Diagnóstico sobre el funcionamiento del Mecanismo de Protección para Personas Defensoras de Derechos Humanos y Periodistas”, UN Office of the High Commissioner for Human Rights - Mexico, https://www.hchr.org.mx/index.php?option=com_k2&view=item&id=1318:diagnostico-co-sobre-el-funcionamiento-del-mecanismo-de-proteccion-para-personas-defensoras-de-derechos-humanos-y-periodistas&Itemid=280.
- 21 Organization of American States, Inter-American Commission on Human Rights, Special Follow-up on the Investigations Regarding the Team of Journalists from El Comercio Newspaper, November 2018, https://www.oas.org/en/iachr/media_center/PReleases/2018/235.asp. IACHR, “Informe Final Del Equipo De Seguimiento Especial (Ese) Designado Por La Comisión Interamericana De Derechos Humanos Seguimiento Del Componente Investigar Los Hechos Que Resultaron En El Secuestro Y Asesinato De: Javier Ortega, Paúl Rivas Y Efraín Segarra (Integrantes Del Equipo Periodístico Del Diario “El Comercio)”, IACHR, 2019, http://www.oas.org/es/cidh/expresion/informes/Informe_Final_ESE_MC_Dicc2019.pdf.
- 22 OSCE RFoM, ‘A Dark Place: A SOFJO Documentary’ Trailer, 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/410423>.
- 23 OSCE RFoM, #SOFJO Conference 2019: Increasing Opportunities for Freedom of Expression and Media Pluralism, 12 February 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/sofjoconference2019>
- 24 UNESCO, “Director-General’s Report on the Safety of Journalists and the Danger of Impunity”, UNESCO, 2018, <https://en.unesco.org/themes/safety-journalists/dgreport>.
- 25 UNESCO, “World Trends in Freedom of Expression and Media Development”, <https://en.unesco.org/world-media-trends>.
- 26 Larry Kilman, “An Attack on one is an attack on all: successful initiatives to protect journalists and combat impunity”, UNESCO, 2017, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000250430>.
- 27 Silvia Chocarro, “IPDC’s Role in the Promotion of the Safety of Journalists: A Way Forward”, UNESCO, 2016, http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CI/CI/pdf/Analytical_Paper_IPDC_Safety_of_Journalists_SChocarro_DE.pdf.
- 28 “Newsletter - UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity”, UNESCO, <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists/newsletter>.
- 29 Joint Declarations by the United Nations Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, the Organization for Security and Co-operation in Europe Representative on Freedom of the Media, and the Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression, <https://www.osce.org/fom/66176>.
- 30 “OSCE Media Freedom Representative and Council of Europe Commissioner for Human Rights urge systematic approach to counter gender-based violence online”, OSCE news item, 12 February 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/411206>.
- 31 “Newsletter - UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity”, <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists/newsletter>.
- “OSCE Media Freedom Representative and Council of Europe Commissioner for Human Rights urge systematic approach to counter gender-based violence online”, OSCE news item, 12 February 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/411206>.
- “Secretary General Calls to End Impunity for Crimes against Journalists, in Message for International Day”, UN news item, 2 November 2017, <https://www.un.org/press/en/2017/sgsm18776.doc.htm>.



**Ndërmjetësit
në internet**

Veprimet e propozuara

1. Të respektohen standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për lirinë e shprehjes, privatësinë, pjesëmarrjen dhe mosdiskriminimin në politikë dhe praktikë;
2. Të sigurohet që politikat për redaktimin e përmbajtjeve të jenë të qarta, transparente dhe të qasshme për përdoruesit, si dhe që përdoruesit të jenë të vetëdijshëm për mënyrën se si redaktohet përmbajtja, çfarë përbën ngacmim dhe abuzim në internet, si dhe si ta raportojnë atë;
3. Të zbatohen qasje të përqendruara tek përdoruesit, si dhe pa bazë në diskriminim, në të gjitha veprimtaritë;
4. Të trajtohet largimi i përmbajtjeve dhe kërkesat e përdoruesve për të dhëna me transparencë dhe konsistencë;
5. Të promovohet roli i grave në gazetari.

6. Ndërmjetësit në internet

Respektimi i të drejtave të gazetareve dhe promovimi i sigurisë në internet

Të gjitha bizneset kanë përgjegjësinë që të respektojnë të drejtat e njeriut.¹ Për ndërmjetësit e internetit, kategori që përfshin lloje të shumta të ofruesve të shërbimeve të internetit, duke filluar nga shërbimet teknike dhe të rrjetit e deri tek platformat e mediave sociale që lehtësojnë ndërveprimet në internet, kjo nënkupton mes tjerash shmangien e turrjes së mundësive të grave gazetare për të marrë pjesë plotësisht dhe për të ushtruar të drejtën e tyre për liri të shprehjes pa diskriminim dhe me respektim të privatësisë së tyre.

Për qëllimet e këtij udhëzuesi, kjo pjesë përqendrohet në lloje të caktuara ndërmjetësish në të cilët gazetarët kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë ngacmime dhe abuzime në internet, në veçanti platformat si Twitter, Facebook, Instagram, Google dhe YouTube. Kjo pjesë trajton standardet dhe veprimet që ndërmjetësit e internetit duhet t'i respektojnë e zbatojnë, si kontribut në mbrojtjen universale të të drejtave të njeriut dhe rritjen e pjesëmarrjes së gazetareve në internet.

Në [Vendimin nr. 3/18 të Këshillit Ministror të OSBE-së](#), 57 Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së “pranojnë që gazetaria dhe teknologjia kanë evoluuar dhe se kjo i kontribuon debatit publik, ndonëse edhe mund të zgjerojë gamën e rreziqeve që e minojnë sigurinë e gazetareve”. Gjithashtu, Shtetet pjesëmarrëse” theksojnë rrezikun e veçantë sa i përket sigurisë së gazetareve në epokën digjitale, duke e përfshirë këtu cenueshmërinë e veçantë të gazetareve për t’u shndërruar në caqe sulmi të hakerëve ose vëzhgimit apo përgjimit të paligjshëm dhe arbitrar të komunikimeve, duke e minuar kështu të drejtën e tyre për liri të shprehjes dhe të drejtën e tyre për të qenë të lirë nga ndërhyrjet arbitrare dhe të paligjshme në privatësi.”

› **Të respektohen standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për lirinë e shprehjes, privatësinë, pjesëmarrjen dhe mosdiskriminimin në politikë dhe praktikë**

Ndërmjetësit në internet, përfshirë platformat e mediave sociale dhe shërbimet e tyre përcjellëse, duhet të mbështesin parimin e përcaktuar me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, që pranon se të drejtat e njeriut të mbrojtura jashtë internetit mbrohen edhe në internet. Ata duhet po ashtu të praktikojnë veprime që kontribuojnë në arritjen e fuqizimit të grave dhe eliminimin e diskriminimit ndaj tyre në shërbimet e tyre, apo si pasojë e tyre.²

Minimalisht, politikat dhe kushtet e shërbimeve të ndërmjetësve të internetit duhet të jenë mjaftueshëm të qarta dhe të qasshme, si dhe të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç shpjegohen në [Parimet udhëzuese të OKB-së për biznesin dhe të drejtat e njeriut](#).³ Politikat dhe kushtet e shërbimit, si dhe udhëzimet e komunitetit dhe standardet e ndërmjetësve të internetit që ndikojnë në të drejtat e lirisë së shprehjes dhe privatësisë në veçanti, duhet të reflektojnë parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Ndërmjetësit në internet duhet ta kuptojnë që gazetaret mund të preferojnë të shprehen në internet pa zbuluar identitetin e tyre; kështu, kompanitë nuk duhet të kërkojnë emra të vërtetë ose identifikim, si dhe duhet të sigurojnë që anonimiteti mbetet mundësi e mirëfilltë për përdoruesit.

Në nivel praktik, ndërmjetësit e internetit duhet të kryejnë vlerësime të rregullta, ose auditime të ndikimit të shërbimeve, produkteve, politikave dhe operacioneve të tyre në të drejtat e ndryshme - lirinë e shprehjes, privatësinë dhe mosdiskriminimin - të cilat mbrohen nga e drejta ndërkombëtare, si dhe të mundësojnë pjesëmarrjen e grave gazetare në internet. Këto vlerësime duhet të përfshijnë edhe vlerësimin e dobisë

dhe efektshmërisë së mjeteve që kompanitë kanë zhvilluar me qëllim të bllokimit, heshtjes, largimit apo deprioritizimit të manifestimeve të ndryshme të ngacmimit dhe abuzimit në internet, si dhe mekanizmat e tyre të raportimit dhe ankesave.

Vlerësimet e ndikimit duhet të trajtojnë edhe efektet e krijuara nga algoritmet që përdoren për të prezantuar, promovuar apo demaskuar përmbajtjen, veçanërisht përmbajtjen që mund të nënkuptojë ngacmim dhe abuzim me bazë gjinore.

Detyrimet e përgjithshme për monitorimin e përmbajtjes dhe ndërveprimeve të përdoruesve bien ndesh me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.⁴ Këto do të kërcënonin privatësinë e përdoruesve dhe do të promovonin masa restriktive, pasi që ndërmjetësit anojnë gabimisht më shumë kah kujdesi, për të shmangur përgjegjësinë. Ndërmjetësit në internet nuk duhet të marrin masa që mund të rezultojnë në largimin e tepërt të përmbajtjes ose në praktika të vëzhgimit. Mjetet automatike të redaktimit - të ndërmarra me vetiniciativë apo për shkak të detyrimit për të larguar një përmbajtje të caktuar - mund të shërbejnë si formë e censurës para publikimit. Nisma për filtrim të ngarkimeve për shkak të përmbajtjes “abuzive” nuk është e këshillueshme.⁵

Ndërmjetësit në internet duhet të kuptojnë që çdo praktikë moderimi/redaktimi, si dhe veprimet e parapara të largimit të përmbajtjeve, kanë implikime në të drejtat e njeriut, të cilat duhen adresuar si formë e parandalimit të kufizimeve të panevojshme dhe jo proporcionale. Ndërmjetësit duhet të zbatojnë parimin trepjesësh të ligjshmërisë, legjitimitetit, dhe domosdoshmërisë e proporcionalitetit (paraqitur në kapitullin: Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që përkufizojnë sigurinë e gazetareve në internet), si dhe të respektojnë procesin e mirëfilltë e të duhur për të gjitha praktikatat që lidhen me moderimin e përmbajtjes.

Burime

- [Parimet udhëzuese të OKB-së për biznesin dhe të drejtat e njeriut](#) janë një tërësi parimesh për Shtetet dhe bizneset për ngritjen e standardeve të të drejtave të njeriut si dhe praktikave të biznesit.⁶
- [Dokumenti strategjik për të hedhur dritën e vëmendjes mbi IA-në dhe lirinë e shprehjes](#) (#SAIFE) nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave ofron një pasqyrë më të qartë mbi atë se si inteligjenca artificiale (IA) ndikon në lirinë e shprehjes, si dhe cilat janë masat e nevojshme për mbrojtjen e fjalës së lirë.⁷ Vetë dokumenti dhe rekomandimet e tij preliminare, në veçanti, përqendrohen në përdorimin e IA-së në moderimin dhe kurimin e përmbajtjes, duke përfshirë mënyrën e trajtimit të “gjuhës së urrejtjes”.
- ARTICLE 19 ka publikuar dokumentin e politikave [Ngacmimi dhe abuzimi në internet ndaj grave gazetare dhe platformat kryesore të mediave sociale](#), i cili ofron rekomandime për platformat e mediave sociale se si të promovojnë dhe mbrojnë sigurinë e gazetareve në internet.⁸

- › **Të sigurohet që politikat për redaktimin e përmbajtjes të jenë të qarta, transparente dhe të qasshme për përdoruesit, si dhe që përdoruesit të jenë të vetëdijshëm për mënyrën se si redaktohet përmbajtja, çfarë përbën ngacmim dhe abuzim në internet dhe si ta raportojnë atë**

Ngacmimi dhe abuzimi në internet ndaj grave gazetare do të trajtohet më mirë kur përdoruesit të kenë informacion të dobishëm për atë se çfarë

përbën secili lloj i ngacmimit dhe abuzimit, kur të gjithë përdoruesit të kenë njohuri të plota për atë se si redaktohet përmbajtja (përfshirë renditjen, uljen në rangim dhe heqjen e përmbajtjes), si dhe kur të gjithë përdoruesit të kenë qasje efektive në mjetet juridike.

Kompanitë ndërmjetëse të internetit duhet të sigurojnë që përmbajtja dhe zbatimi i kushteve të tyre të shërbimit, udhëzimet për komunitetin dhe politikat e tjera të veçanta (p.sh., politikat e reklamimit ose tregtimit) të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe privatësinë. Kjo do të thotë se kushtet e shërbimit, dhe të tjera të ngjashme, duhet të jenë proporcionale dhe adekuate, të qarta, të kuptueshme dhe në dispozicion të të gjithë përdoruesve.⁹ Përdoruesit duhet të jenë në gjendje që të parashikojnë nëse përmbajtja e tyre ka gjasë që të hiqet, renditet, ulet në rangim ose ndikohet në çfarëdo mënyrë tjetër.¹⁰ Gjithashtu, duhet të jetë e qartë se kur dhe se si të dhënat e përdoruesit ka gjasë që të mblidhen, ruhen ose kalohen tek palët e treta, përfshirë tek autoritetet e zbatimit të ligjit.

Së bashku me kushtet e tyre të shërbimit dhe materialet e tjera që udhëzojnë përdoruesit, platformat e mediave sociale duhet të japin shembuj të hollësishëm, ose raste studimore, për mënyrën në të cilën zbatohen standardet dhe politikat e tyre të komunitetit. Shtimi i pjesëve me shembuj të manifestimeve të ndryshme të ngacmimit dhe abuzimit në internet, përfshirë një listë të plotë të shembujve me bazë gjinore, do t'u ndihmonte përdoruesve që t'i kuptojnë politikat e këtyre platformave. Ata duhet të integrojnë të dhëna që ilustronjë trendet në zbatimin e politikave ose vënien në jetë të tyre, bashkë me shembuj të rasteve të vërteta ose hipoteza të hollësishme që ilustronjë nuancat e interpretimit dhe zbatimit të rregullave të veçanta.¹¹

Gjithashtu, është e nevojshme të ketë transparencë më të madhe në proceset e vendimmarrjes së platformave të mediave sociale. Për shembull, duhet të jetë

e qartë cilat mjete ata i përdorin për të moderuar dhe hequr përmbajtjen, së bashku me funksionin dhe ndikimin e tyre, duke përfshirë përdorimin e algoritmeve dhe mjeteve të inteligjencës artificiale, skemave të besueshme të alarmimit ose një kombinim të metodave.

Hap tjetër që mund të shërbejë si bazë për politikën dhe praktikën është që ndërmjetësit në internet të mbledhin, analizojnë dhe raportojnë rregullisht dhe publikisht mbi të dhënat në lidhje me ngacmimin dhe abuzimin në internet dhe efektet e tij.¹² Këto të dhëna dhe raporte duhet të përpunohen sipas rregullave të mbrojtjes së të dhënave, si dhe të bazohen në mënyrë rigorozë në informatat e siguruar nga përdoruesit të cilët kanë dhënë pëlqimin e tyre për t'i përdorur ato për këto qëllime të veçanta.

Shembuj

Informata rreth zbatimit të politikave: [Raporti për transparencë](#) i Twitter ofron të dhëna statistikore në lidhje me veprimet që kompania ndërmerr ndaj llogarive të përdoruesve në zbatim të disa prej kushteve të tyre të shërbimit.¹³ Ajo publikon gjithashtu përshkrimin e secilës prej politikave të tyre si dhe numrin e raporteve dhe veprimeve që janë ndërmarrë në lidhje me çdo zbatim të politikave. Qendra e ndihmës e Twitter ofron një udhëzues për të [raportuar shkelje të rregullave të Twitter](#) drejtpërdrejtë me një cicërimë ose një profil.¹⁴

Mekanizëm i qasshëm i raportimit: YouTube ofron një mjet të qasshëm për të raportuar abuzimin sipas [udhëzimeve](#) të tyre të komunitetit.¹⁵ Megjithatë, në disa raste, përdoruesi i abuzuar duhet të shterë komunikimin me bartësin e llogarisë abuzive para se ta kontaktojë kompaninë YouTube.

Transparenca në heqjen e përmbajtjes: Facebook publikon Raportin e tij për [zbatimin e standardeve të komunitetit](#), në të cilin kompania jep të dhëna numerike për raportet që i marrin sipas çdo udhëzuesi për komunitetin, duke përfshirë lakuriqësinë, llogaritë e rreme dhe ngacmimet.¹⁶ Ato sigurojnë sasinë e gjithmbarshme të pjesëve të përmbajtjes ndaj të cilave ndërmarrin veprim, përfshirë ankesat dhe pjesët e përmbajtjes që ata i zbulojnë dhe heqin me përdorimin e mjeteve të automatizuara. Megjithatë, për të qenë funksional për qëllime të llogaridhënies dhe transparencës, raporti duhet të përmirësohet ngaqë tani për tani, për shembull, nuk mundëson krahasim të të dhënave. Twitter dhe Google publikojnë gjithashtu këso lloje të raporteve të transparencës; është e rëndësishme që të gjitha platformat e mediave sociale të përmirësojnë mekanizmat e tyre të transparencës.

Largimi për çdo mekanizëm raportimi: YouTube publikon [raportin e tij të transparencës mbi zbatimin e udhëzimeve të komunitetit](#), në të cilin ata paraqesin numrin e videove që janë larguar përmes skemave të ndryshme të raportimit: shënjimi/alarmimi automatik, raportet e përdoruesve, alarmuesit e besueshëm, OJQ-të dhe qeveritë.¹⁷ Ky raport përmban gjithashtu numrin e videove që janë hequr sipas udhëzimeve për komunitetin.

Burime

- [Raporti i Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e së Drejtës së Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes për Këshillin e të Drejtave të Njeriut](#) ofron rekomandime për përgjegjësitë e sektorit privat në moderimin e përmbajtjes.¹⁸

- [Rekomandimet e Këshillit të Evropës \(KiE\) për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me shërbimet e rrjeteve sociale](#) paraqesin parimet për moderimin e përmbajtjes.¹⁹
- Rekomandimet e KiE dhe të PLM të OSBE-së në vijim të punimeve të [Konferencës për lirinë e internetit “Roli dhe përgjegjësitë e kompanive ndërmjetësuese të internetit”](#) trajtojnë mes tjerash moderimin e përmbajtjes përmes procedurave transparente në bazë të sundimit të ligjit.²⁰
- Deklaratat e përbashkëta nga Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes, PLM i OSBE-së, Raportuesi i Posaçëm i Organizatës së Shteteve Amerikane për Lirinë e Shprehjes dhe Raportuesi i Posaçëm i Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve për Lirinë e Shprehjes dhe Qasje në Informacion japin rekomandime për sektorin privat dhe kompanitë ndërmjetësuese të internetit për moderimin e përmbajtjes me fokus në të drejtat e njeriut. Në veçanti, [Deklarata e përbashkët e përvjetorit të njëzetë për sfidat e lirisë së shprehjes në dekadën e radhës](#) e vitit 2019 paraqet parimet për të parandaluar që rregullat e përmbajtjes private të ndërhyjnë në të drejtat e individëve për të gëzuar lirinë e shprehjes.²¹
- [Parimet e Santa Clara për transparencë dhe llogaridhënie në moderimin e përmbajtjes](#) janë një gamë e parimeve që synojnë të shërbejnë si një pikënisje, duke përshkruar nivelet minimale të transparencës dhe llogaridhënies që duhet të ketë moderimi i përmbajtjes së platformave të internetit.²²
- [Parimet e Manillës për përgjegjësinë e kompanive ndërmjetësuese](#) propozojnë këtë kornizë të masave mbrojtëse bazë dhe praktikave më të mira për përgjegjësinë e kompanive ndërmjetësuese.²³

› **Të zbatohen qasje të përqendruara tek përdoruesit, si dhe pa bazë në diskriminim, në të gjitha veprimtaritë**

Është më se e nevojshme që ndërmjetësit në internet ta përmirësojnë mënyrën në të cilën i informojnë dhe këshillohen me grupe të përdoruesve të cilët janë të prekur nga ngacmimet dhe abuzimet në internet, dhe mënyrën se si mjetet e moderimit të përmbajtjes dhe opsionet e korrigjimit integrojnë këto përvoja dhe shqetësime.

Përdoruesit, veçanërisht ata që kanë më shumë të ngjarë të jenë shënjestër në internet, duhet ta dinë se çfarë mund të bëjnë për t'i ulur rreziqet e pjesëmarrjes në platformat e internetit. Prandaj, ndërmjetësit në internet duhet të sigurojnë informata për përdoruesit në lidhje me praktikat më të mira për sigurinë në internet dhe zgjidhjet teknike për raportimin e përmbajtjes abuzive. Ato duhet të ofrojnë gjithashtu mjete të raportimit dhe kushte të shërbimit që janë të qasshme e të thjeshta për përdorim dhe që lehtë mund të gjenden në gjuhët lokale.²⁴

Ndërmjetësit në internet duhet të bëjnë përparim në përdallimin midis niveleve dhe formave të ndryshme të abuzimit dhe ngacmimit dhe mënyrës se si praktikohen heqjet dhe i prekin përdoruesit me karakteristika të mbrojtura sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ndërmjetësit në internet duhet t'i synojnë në mënyrë aktive dhe t'i marrin parasysh në mënyrë efektive çështjet gjinore, veçanërisht cenueshmërinë ose marginalizimin, si dhe shqetësimet e komuniteteve që përballen me rreziqe të caktuara të censurës dhe diskriminimit.²⁵ Prandaj, ndërmjetësit në internet duhet të zhvillojnë zgjidhje dhe mjete korrigjuese që janë të qasshme dhe të dobishme për përdoruesit. Kjo qasje është jetike për ta parandaluar dhe zvogëluar ndikimin jo proporcional të ngacmimit dhe abuzimit në internet tek përdoruesit të cilët janë cak i tyre, si dhe për të mundësuar vlerësime të përqendruara në të drejtat e njeriut për ndikimin

e vendimeve algoritmike dhe vendimeve tjera të bazuara në IA.

Ndërmjetësit në internet duhet t'i hartojnë dhe zbatojnë mjetet dhe politikat e tyre përmes konsultimeve me publikun dhe me shoqërinë civile që shihen si kuptimplota nga pjesëmarrësit, dhe kompanitë ndërmjetësuese të internetit duhet të publikojnë rezultatet e këtyre konsultimeve në praktikë.²⁶ Për qëllime të sigurisë së grave gazetare, ndërmjetësit në internet duhet të miratojnë metodologji dhe procedura që mbajnë parasysh kontekstin, përvojën dhe pengesat e gazetareve në përdorimin e mjeteve dhe shërbimeve të tyre. Konsultimet duhet të organizohen në aso lloj mënyre që gazetarët, mediat, shoqëria civile dhe komuniteti akademik ta kenë të lehtë që të marrin pjesë në mënyrë aktive në to. Në konsultime duhet të marrin pjesë një gamë e gjerë e individëve të prekur, e sidomos nga vendet dhe komunitetet posaçërisht të prekura nga shërbimet. Kjo pjesëmarrje nuk duhet të imponojë kërkesa të panevojshme angazhimi, siç janë marrëveshjet e moszbulimit ose kërkesat e tepërta për informata për t'u regjistruar në nismat dhe programet e tyre.

Burimet

- Rregullimi i përmbajtjes së prodhuar nga përdoruesit është në fokus të [Raportit të vitit 2018 të Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e së Drejtës për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes](#), që përmban rekomandime të dobishme për Shtetet dhe kompanitë.²⁷
- [Ethical Explorer Pack](#), që është zhvilluar nga Rrjeti Omidyar, u drejtohet kompanive të mediave sociale dhe zhvilluesve të shërbimeve për t'i ndihmuar mes tjerash që të fillojnë biseda dhe

të kryejnë analiza të rrezikut për diversitetin, përfshirjen, si dhe drejtësinë dhe barazinë. Kompanitë që duan të zhvillojnë norma të vetërregullimit dhe procese etike duhet të identifikojnë se çfarë nënkuptojnë siguria dhe barazia gjinore për punën e tyre.²⁸ Ndonëse kjo pako argumentesh dhe sugjerimesh nuk shtjellon nene të veçanta për të drejtat e njeriut, ajo vë në pah disa mënyra në të cilat kompanitë e teknologjisë mund të përfshijnë diskutimet për atë se si mund të zbatojnë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut.

› **Të trajtohet largimi i përmbajtjeve dhe kërkesat për të dhënat e përdoruesve me transparencë dhe konsistencë**

Çdo proces ose veprim që ndërhyr në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe privatësisë së përdoruesve të ndërmjetësve në internet dhe palëve të tjera të prekura duhet të jetë sa më i hapur dhe transparent që të jetë e mundur.²⁹ Platformat mbizotëruese të mediave sociale duhet të marrin parasysh zbatimin e testeve të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit ndaj veprimeve që lidhen me përmbajtjen, edhe kur veprimet e tilla ndërmerren me qëllim të parandalimit ose reagimit ndaj ngacmimeve dhe abuzimeve në internet kundër gazetarëve.³⁰

Ndërmjetësit në internet duhet t'i bazojnë vendimet e tyre në lidhje me heqjen e përmbajtjes dhe kërkesat për të dhënat e përdoruesve në parimet e procesit të rregullt, krahas sigurimit të mjeteve juridike për lirinë e shprehjes, privatësisë dhe shkeljeve të parimeve të mosdiskriminimit.³¹ Në praktikë, kjo do të thotë që ndërmjetësit në internet duhet të krijojnë sisteme njoftimi ku të përfshihen të gjitha palët e prekura nga vendimet e tyre, duke dhënë shpjegime të plota të politikave që zbatohen, vlerësimin

që drejtoi vendimin, si dhe hollësi për atë se si të aktivizohen mekanizmat e ankesave për të kundërshtuar vendimet.³²

Kompanitë ndërmjetësuese të internetit duhet të publikojnë informatat në lidhje me heqjen e përmbajtjes dhe kërkesat për të dhënat e përdoruesve. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në informata statistikore për veprimet e ndërmarra lidhur me përmbajtjen, ankesat dhe rezultatet, si dhe çdo informatë tjetër që e informon publikun në lidhje me konsistencën e vendimeve të tyre nga pikëpamja sasiore dhe cilësore. Këto informata duhet të bëjnë të mundur shqyrtimin nga ana e publikut e moderimit të përmbajtjes së kompanive ndërmjetësuese të internetit dhe përdorimin e sistemeve të automatizuara, dhe ndikimin e tyre në të drejtën për liri së shprehjes, privatësi dhe mosdiskriminim.

Angazhimi dhe partneritetet e ndërmjetësve në internet me qeveritë duhet të jenë sa më transparente që është e mundur, në mënyrë që informatat të jenë në dispozicion dhe t'i shërbejnë vlerësimit të ndërveprimit midis qeverive dhe kompanive ndërmjetësuese. Raportet ekzistuese në lidhje me numrin dhe identifikimin e kërkesave të qeverive për të hequr përmbajtjen ose për të pasur qasje në informatat e përdoruesve, nuk japin hollësitë e nevojshme për të vlerësuar dhe kontrolluar me të vërtetë angazhimin midis këtyre aktorëve.

Raportet e transparencës duhet të përmbajnë të dhëna shteruese në lidhje me autoritetin e përfshirë në kërkesë, bazën ligjore, ose mungesën e saj, për kërkesën, si dhe veprimet e ndërmarra nga kompania për çdo kërkesë në secilin vend, përfshirë ato që mundësojnë kontestimin e brendshëm të shkeljeve të të drejtave të njeriut ose keqpërdorimin e mekanizmave për parashtrimin e kërkesës.

Ndërmjetësit në internet, në veçanti platformat e mediave sociale, duhet të angazhohen për mbikëqyrje të pavarur dhe duhet të marrin parasysh

bashkimit me organet rregullatore shumëpalëshe, siç janë këshillat e mediave sociale, që do të mundësonin mbikëqyrje më të mirë publike dhe llogaridhënie për praktikën e tyre, përfshirë në fushën e ngacmimit dhe abuzimit me bazë gjinore.³³

Shembuj

Raportimi për kërkesat për informata: Twitter publikon informata rreth vendimeve të tyre për kërkesat e qeverive dhe kërkesat tjera të “raportuesve të autorizuar”, bazuar në bazën e brendshme ligjore, përfshirë shembuj për çdo vend. Raporti i tyre i transparencës për [informatat rreth kërkesave](#) shpalosë vëllimin e kërkesave ligjore që ata marrin nga parashtruesit qeveritarë dhe joqeveritarë për kategori dhe për çdo vend, duke përfshirë një profil specifik për çdo vend.³⁴ Sidoqoftë, raporti nuk ofron informata sa i përket bazës ligjore për kërkesat, as nuk paraqet rastet në të cilat qeveritë përmbushin, ose dështojnë që t'i përmbushin, kërkesat ligjore.

YouTube ofron [rubrikën e pyetjeve të shpeshta për kërkesat për informacionin e përdoruesve](#).³⁵ Google ofron të dhëna statistikore për kërkesat e qeverive për të hequr përmbajtjen.³⁶

Çdo gjashtë muaj, Facebook nxjerr një raport për [kërkesat e qeverisë për të dhënat e përdoruesve](#) duke dhënë numrin e kërkesave për çdo vend si dhe një përmbledhje të shkurtër të disa rasteve të veçanta.³⁷

Në lidhje me kërkesat për të dhënat e përdoruesve, Twitter, Google dhe Facebook përfshijnë një pjesë që përmban të dhëna të përgjithshme numerike për çdo vend dhe zbatimin e udhëzimeve të tyre për kërkesat nga autoritetet e zbatimit të ligjit.³⁸

› Të promovohet roli i grave në gazetari

Gratë gazetare preken në mënyrë joproporcionale nga ngacmimet dhe abuzimet në shërbimet dhe platformat që ofrohen nga kompanitë ndërmjetësuese të internetit. Ndërmjetësit në internet duhet të marrin iniciativa publike dhe proaktive për të luftuar manifestimet e ndryshme të ngacmimit dhe abuzimit në internet, përfshirë përmes programeve të ndërgjegjësimit, mbështetjes së aktiviteteve të grave gazetare dhe kontributit në krijimin dhe shpërndarjen e kundër-narrativëve.

Ndërmjetësit në internet mund të promovojnë dhe rrisin në mënyrë aktive pjesëmarrjen më të sigurt të grave gazetare në shërbimet e tyre, për shembull, duke mbështetur ose mbajtur trajnime për gratë gazetare dhe anëtare të tjera të mediave dhe shoqërisë civile për mënyrën në të cilën duhen zbatuar politikat e kompanive të platformave të mediave sociale dhe si të përdoren e përmirësohen mekanizmat e tyre për raportim dhe ankimim.

Nismat nga ndërmjetësit në internet që mëtojnë të promovojnë shërbime gazetareske ose të rrisin aktivitetet gazetareske duhet të rishikohen në mënyrë që këto shërbime në internet të jenë të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe në përputhje me të drejtat e njeriut. Për shembull, kjo do të thotë që menaxherët përgjegjës për shërbimet që janë të dobishme për punën e gazetarisë duhet të konsultohen dhe të adresojnë në mënyrë aktive nevojat e gazetareve gjatë fazave të hartimit dhe zbatimit, si dhe të ofrojnë mundësi për të përmirësuar sigurinë e grave.

Shembuj

Përvoja e grave gazetare të bëhet e dukshme: Fushata e Twitter [#HerStory](#) përbën shembull të mirë të një ndërmjetësi të internetit që

prodhon materiale vetëdijesuese për qytetarët për disa nga çështjet me të cilat përballen gratë gazetare.³⁹ Twitter filloi serinë mujore të videove më 3 maj të vitit 2019 për të shënuar [Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit](#), si mënyrë për të vënë në pah punën dhe historitë personale të grave gazetare nga mbarë bota.⁴⁰

Trajnim për politikën dhe raportimin: Twitter punon me nisma rajonale për t'i trajnuar gratë gazetare për përdorimin e mjeteve të tyre, zbatimin e politikave dhe raportimin. Gjithashtu, ai promovon dhe mbështet krijimin e fushatave që paraqesin interesat dhe shqetësimet e grave në diskutimet në Twitter.⁴¹

Sigurimi i burimeve për alarmim për imazhe intime të shpërndara pa pëlqim: Nisma e Facebook [Not Without My Consent](#) siguron burime të ndryshme për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur shpërndarjes pa pëlqim të imazheve intime.⁴² Megjithëse nuk është krijuar posaçërisht për gratë gazetare, ajo ngërthen një pilot projekt që po zbatohet në partneritet me organizatat e shoqërisë civile për t'u ndihmuar individëve që të ndalojnë ose raportojnë shpërndarjen pa pëlqim të një imazhi intim.

Mbrojtja e shtresës teknike nga sulmet e bashkërenduara: [Projekti Shield](#) i Google siguron mbrojtje për organizatat e lajmeve, gazetarët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut nga sulmet e bashkërenduara kundër faqeve të tyre në internet që mëtojnë bllokimin e hyrjes në faqet e mediave - të ashtuquajturat sulme të shpërndara të mohimit të shërbimit (DDoS). Mbrojtja përbëhet nga masat që filtrojnë trafikun e kategorizuar si “keqdashës” duke përdorur infrastrukturën dhe mjetet e Google. Kur faqet e internetit sulmohen, mjetet e Project Shield bllokojnë trafikun “keqdashës” për të mbajtur në funksion faqet e internetit.⁴³

Shënime fundore

- 1** UN Human Rights Council, Resolution 17/4, “Human rights and transnational corporations and other business enterprises”, 15 June 2011, <https://daccess-ods.un.org/TMP/4498748.77929688.html>. The Special Representative of the UN Secretary-General on the issue of human rights and transnational corporations and other business enterprises developed the “Guiding Principles on Business and Human Rights: Implementing the United Nations ‘Protect, Respect and Remedy’ Framework”, annexed to the final report to the Human Rights Council (A/HRC/17/31, <https://undocs.org/en/A/HRC/17/31>), which also includes an introduction to the Guiding Principles and an overview of the process that led to their development.
- 2** UN General Assembly, Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences, “Online violence against women and girls from a human rights perspective”, A/HRC/38/47, 18 June 2018, paragraph 89, <https://undocs.org/A/HRC/38/47>.
- 3** UN High Commissioner for Human Rights, Guiding Principles on Business and Human Rights: Implementing the United Nations “Protect, Respect and Remedy” Framework, 2011, https://www.ohchr.org/Documents/Publications/GuidingPrinciplesBusinessHR_EN.pdf.
- 4** UN General Assembly, Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression, A/HRC/38/35, 6 April 2018, paragraph 67, <https://undocs.org/A/HRC/38/35>. European Union, Directive 2000/31/EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market (Directive on electronic commerce), Article 15, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX-%3A32000L0031>.
- 5** UN General Assembly, Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression, A/74/486, paragraphs 34 and 35, 9 October 2019, <https://undocs.org/A/74/486>.
- 6** Op. cit. endnote 3.
- 7** OSCE RfOM, “Strategy Paper to Put a Spotlight on AI and Freedom of Expression” #SAIFE, July 2020, https://www.osce.org/files/f/documents/9/f/456319_o.pdf.
- 8** ARTICLE 19, Online harassment and abuse against women journalists and major social media platforms London: 2020, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2020/10/Gender-Paper-Brief-2.pdf>.
- 9** OSCE RfOM, “Recommendations following the Expert Meeting New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists”, 17 September 2015, <https://www.osce.org/fom/19356?download=true>.
- 10** “Future Thinking: Harlem Désir on Freedom of Expression Online”, Internet Society news item, January 2018, <https://www.internetsociety.org/blog/2018/01/future-thinking-harlem-desir/>.
- 11** UN General Assembly, “Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression”, A/HRC/38/35, 6 April 2018, paragraph 46, <https://undocs.org/A/HRC/38/35>.
- 12** OSCE, RfOM, “Communiqué 1/2019, Freedom of the Media on Media Pluralism, Safety of Female Journalists and Safeguarding Marginalized Voices Online”, 29 February 2019, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/411917?download=true>.
- 13** “Twitter Rules enforcement”, Twitter, <https://transparency.twitter.com/en/twitter-rules-enforcement.html>.
- 14** “Report violations”, Twitter, <https://help.twitter.com/en/rules-and-policies/twitter-report-violation>.
- 15** “Report inappropriate content”, YouTube, <https://support.google.com/youtube/answer/2802027?hl=en>.


- 16 “Community Standards Enforcement Report”. Facebook, <https://transparency.facebook.com/community-standards-enforcement>.
- 17 “YouTube Community Guidelines enforcement”, Google, <https://transparencyreport.google.com/youtube-policy/removals?hl=en>.
- 18 UN General Assembly, “Report of the Special Rapporteur on the promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression”, A/HRC/32/38, 11 May 2016, <https://undocs.org/A/HRC/32/38>.
- 19 Council of Europe, Committee of Ministers, “Recommendations on the protection of human rights with regard to social networking services”, CM/Rec(2012)4”, 4 April 2020, <https://go.co.e.int/1L7Uv>.
- 20 Council of Europe and OSCE RfOM, “Key Conclusions and Recommendations of the Conference on Internet Freedom “The Role and Responsibilities of Internet Intermediaries”, 13 October 2017, <https://www.osce.org/files/f/documents/6/7/371846.pdf>.
- 21 UN Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, the OSCE Representative on Freedom of the Media, the Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression, and the African Commission on Human and Peoples’ Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information, “Twentieth Anniversary Joint Declaration: Challenges to Freedom of Expression in the Next Decade”, 10 July 2019, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/c/425282.pdf>.
- 22 Santa Clara Principles on Transparency and Accountability in Content Moderation, <https://santalarapprinciples.org>.
- 23 Manila principles on intermediary liability, <https://www.manilapinciples.org/principles>.
- 24 Op. cit. endnote 2, paragraph 117.
- 25 Op. cit. endnote 4, paragraph 48.
- 26 Op. cit. endnote 4, paragraph 70.
- 27 Ibid.
- 28 Omidyar Network, 2020, “Ethical Explorer Pack”, <https://ethicalexplorer.org/>. This is recommended by UNESCO in the publication “Steering AI and Advanced ICTs for Knowledge Societies: A Rights, Openness, Access, and Multi-stakeholder Perspective”, 2019, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000368711/PDF/368711eng.pdf.multi>.
- 29 Op. cit. endnote 20.
- 30 Op. cit. endnote 6, paragraph 50.
- 31 Opt. cit. endnote 3.
- 32 Opt. cit. endnote 6.
- 33 ARTICLE 19, “Social Media Councils”, <https://www.article19.org/social-media-councils/>.
- 34 “Information Requests”, Twitter, <https://transparency.twitter.com/en/information-requests.html>.
- 35 “Requests for user Information FAQs”, Google, <https://support.google.com/transparencyreport/answer/9713961>.
- 36 “Government requests to remove content”, Google, <https://transparencyreport.google.com/government-removals/overview>.
- 37 “Government Requests for User Data”, Facebook, <https://transparency.facebook.com/government-data-requests>.
- 38 See Twitter’s [Guidelines for Law Enforcement](#); YouTube’s [FAQs on requests for users’ information](#); Facebook’s [Law Enforcement Request system and a guide](#).
- 39 Twitter News, “White House reporter for @NewsHour and co-moderator for this week’s #DemDebate, @Yamiche discusses what it’s like to be a female journalist of color.”, Twitter, 18 December 2019, <https://twitter.com/TwitterNews/status/1207330560881942528>.
- 40 Anabel Pasarow, “With #HerStory, Twitter Is Celebrating Women In Journalism”, Refinery29, 2 May 2019, <https://www.refinery29.com/en-gb/2019/05/231662/twitter-her-story-wom>.

[en-journalists-original-series](#).

41 "Inclusion & Diversity Report March 2020", Twitter, https://blog.twitter.com/en_us/topics/company/2020/Inclusion-and-Diversity-Report-March-2020.html.

42 "Not Without My Consent", Facebook, <https://www.facebook.com/safety/notwithoutmyconsent/>.

43 "Project Shield", Google Jigsaw, <https://projectshield.withgoogle.com/landing>.



Mediat

Veprimet e propozuara

1. Të përmirësohet kultura e vendit të punës me politika gjithëpërfshirëse si për sigurinë edhe për gjininë;
2. Të sigurohet mbështetje dhe trajnim për gazetarët të cilët përballen me ngacmime dhe abuzime në internet;
3. Të hartohen udhëzime për komunitete të përgjegjshme ndaj gjinisë për platforma interaktive në internet;
4. Të monitorohet dhe dokumentohet abuzimi dhe ngacmimi në internet i gazetareve, përfshirë profesionistët e pavarura.

7. Mediat

Mbrojtja e gazetarëve fillon në vendin e punës

Mediat - më konkretisht, pronarët, menaxherët dhe redaktorët e formave të ndryshme të të gjitha llojeve të kompanive dhe organizatave të mediave - kanë një detyrim dhe mundësi që të ushtrojnë ndikim pozitiv në sigurinë e gazetarëve. Ata e kanë për detyrë që të kujdesen për të garantuar sigurinë e të gjithë individëve që punojnë për ata, përfshirë profesionistët e pavarur, brenda redaksisë, si dhe në terren.

Si punëdhënës që janë, pronarët e mediave, kryeredaktorët dhe menaxherët duhet ta njohin dhe të reagojnë ndaj faktit që, përveç rreziqeve që burojnë nga të qenit gazetar, gratë gazetare përballen me një shtresë shtesë të rrezikut për shkak të të qenit gra.¹ Veç kësaj, mediat kanë përgjegjësinë që të sigurojnë se kultura e vendit të punës, e që tradicionalisht është një kulturë tejet patriarkale, çrrënjosë kërcënimet e mundshme nga kolegët e tjerë.

Pronarët, menaxherët dhe redaktuesit e mediave duhet që të përqendrohen në masat parandaluese dhe mbrojtëse për gjithë personelin, me vëmendje të veçantë për nevojat e grave. Duhet të ofrohen forma të ndryshme të mbështetjes zyrtare dhe joformale, të cilat përforcojnë njëra-tjetrën për një qasje tërësore të sigurisë.

Në [Vendimin nr. 3/18 e Këshillit Ministror të OSBE-së](#), 57 Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë të “alarmuara me shtimin e fushatave shënjestruese që minojnë punën e gazetarëve, duke e prishur besimin e publikut në kredibilitetin e gazetarisë, e duke e ditur se kjo mund të shtojë rrezikun e kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve.”

› **Të përmirësohet kultura e vendit të punës me politika gjithëpërfshirëse si për sigurinë edhe gjininë**

Kultura e sigurisë është thelbësore. Nëse gazetarët nuk ndiejnë se mediat e tyre po përpiqen që të parandalojnë, zvogëlojnë dhe reagojnë ndaj abuzimit të jashtëm dhe të brendshëm në çdo aspekt, atëherë puna e tyre bëhet më e vështirë.

Mungesa e sigurisë për gratë gazetare shpesh fillon në vendin e tyre të punës. Normat dhe stigmat diskriminuese kulturore, të shoqëruara me mungesën e besimit tek eprorët e tyre për të vepruar ndaj abuzimeve, shkurojnë raportimin e dhunës me bazë gjinore. Në këtë kontekst, mbizotëron heshtja.²

Hapi i parë i një kompanie mediatike drejt përmirësimit të kulturës së mjedisit të punës është që të pranojë se dhuna me bazë gjinore është një problem, dhe se sulmi ndaj një gazetari është sulm ndaj të gjithë medias. Kjo nënkupton që duhet të vepohet duke e ditur se gratë janë në shënjestër të komunikimeve në internet më shpesh sesa kolegët e tyre meshkuj dhe në mënyra më të dëmshme.³ Gjithashtu duhet të pranohet fakti se vetë kolegët mund t'i shënjestrojnë gratë gazetare dhe se këto incidente mund të mos raportohen.

Për t'i mbështetur gazetarët, mediat duhet të kryejnë rregullisht auditime të sigurisë në redaksitë e tyre të lajmeve dhe në mjediset e tjera të punës, të tilla si kushtet e zonës geografike që mbulojnë dhe të llojeve të ndryshme të punës në terren. Gjithashtu, ato duhet të kryejnë auditime dhe vlerësime digjitale të sigurisë për të kuptuar më mirë llojet e ndryshme të rreziqeve që mund t'iu kanosen individëve gjatë punës për kompaninë mediatike në fjalë. Përmes këtij procesi, ato mund të identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta operative. Në bazë të gjetjeve të auditimeve, dhe në bashkëpunim

me gazetarët, mediat duhet të zbatojnë politikat tërësore të sigurisë - ato që trajtojnë sigurinë fizike, sigurinë digjitale dhe mbështetjen psikosociale.

Krahas nxitjes së një kulture pozitive në redaksinë e lajmeve, kompanitë e mediave duhet të hartojnë udhëzime dhe protokolle për të parandaluar dhe luftuar sulmet, duke përfshirë këtu format e ndryshme të ngacmimeve dhe abuzimeve në internet. Këto udhëzime dhe protokolle duhet të parashohin caktimin e një personi përgjegjës për zbatimin e tyre, dhe se ato do të duhet që të rishikohen dhe azhurnohen rregullisht për të qenë relevante në botën teknologjike që po ndryshon me shpejtësi.

Është e rëndësishme që udhëzimet e tilla të përvijojnë të gjitha opsionet që janë në dispozicion të gazetarëve për të raportuar ngacmimin dhe abuzimin në internet dhe se si të kërkojnë ndihmën që u nevojitet, të tilla si këshilla ligjore ose mbështetje psikosociale. Në të njëjtën kohë, udhëzimet e tilla duhet të njohin që procedurat e ngurta të brendshme mund t'ua pamundësojnë gazetarëve që të raportojnë sulme me bazë gjinore për shkak të natyrës personale dhe intime të sulmeve të tilla. Prandaj, procedurat e brendshme duhet të parashohin një gamë fleksibël të veprimeve. Për shembull, një gazetar mund të parapëlqejë që të flasë me një koleg të ngushtë për t'i kërkuar atij që ta raportojnë abuzimin në vend se ta ngritë çështjen personalisht me mbikëqyrësit. Në një skenar tjetër, një gazetar mund të dëshirojë që të marrë mbështetje psikosociale pa e çuar çështjen më tej qoftë brenda ose jashtë organizatës.

Duke e ditur që ngacmimi me bazë gjinore mund të ndodhë edhe brenda vendit të punës, strukturat e korporatave për raportimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet duhet t'u mundësojnë gazetarëve që të adresojnë qoftë sulmet e brendshme apo të jashtme. Mekanizmat duhet të jenë të arritshëm lehtësisht, me garanci për konfidencialitet dhe reagim me kohë nga menaxhmenti.

Shoqëritë e pabarabarta, ku është normë që burrat të kenë më shumë mundësi dhe paga më të mëdha se gratë, janë strumbullari i sulmeve në internet me bazë gjinore ndaj gazetareve. Për më tepër, në shoqëri të tilla, ngacmimi dhe dhuna ndaj grave shpesh nuk pranohet në tërësinë e saj të plotë. Për të luftuar shkaqet kryesore të sulmeve të tilla, mediat duhet që të miratojnë dhe zbatojnë politikatat e barazisë gjinore në lidhje me pagat, ngritjet në detyrë, baraspeshën punë-jetë dhe qasja në pozitat vendimmarrëse.⁴ Politikatat duhet të trajtojnë edhe dhunën seksuale në vendin e punës dhe të përshkruajnë rrugën e duhur të veprimit si reagim ndaj shkeljeve të brendshme. Politikatat gjinore duhet të hartohen duke pasur parasysh gazetaret dhe përfaqësueset e shoqatave dhe sindikatave, gjersa tërë personeli duhet të trajnohet për t'u njoftuar mirë me politikatat e tilla.

Politikatat editoriale duhet që gjithashtu të promovojnë barazinë gjinore në përmbajtjen mediatike. Rekomandimet për mënyrën e arritjes së kësaj përfshijnë sigurimin që zërat e grave të shërbejnë si bazë për raportimet e lajmeve, duke shmangur paragjykimin gjinor në raportim, përfshirë edhe ndaj grave që janë personalitete publike, dhe raportimin për dhunën seksuale në një mënyrë që nuk stigmatizon ose përkeqëson traumën.

Shembuj

Diskutimi i praktikave më të mira: Mediat nga mbarë Evropa kanë marrë pjesë në një studim për gjininë të realizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shtypit (INSH), në bashkëpunim me Zyrën e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias (PLM), për të shqyrtuar praktikatat më të mira për trajtimin e ngacmimeve dhe sulmeve në internet ndaj grave gazetare. INSH publikoi raportin [Praktikat më të mira të redaksisë së lajmeve për trajtimin e dhunës në internet ndaj gazetarëve](#) në vitin 2019 që përfshin një sërë rekomandimesh.⁵

Zbatimi i udhëzimeve dhe protokolleve transparente: Një protokoll udhëzues për ngacmimet në internet, Masat për redaksitë e lajmeve dhe gazetarët për të trajtuar ngacmimet në internet, është në dispozicion në shumë gjuhë nga faqja e burimeve në internet e INSH. Ky protokoll mbështetet në praktikat më të mira në të gjithë Evropën dhe ofron rekomandime të veçanta. INSH punon me disa media për t'i zbatuar këto udhëzime.⁶

Shoqata Botërore e Gazetave dhe Botuesve të Lajmeve (WAN-IFRA) ka krijuar një udhëzues praktik hap-pas-hapi për organizatat dhe punonjësit e mediave për t'u ndihmuar në parandalimin dhe trajtimin konstruktiv të ngacmimeve seksuale në punë, të titulluar [Ngacmimet seksuale në media - Udhëzues praktik për punëdhënësit dhe punonjësit](#).⁷ Ai ofron modele që janë zhvilluar nga ekspertë të burimeve njerëzore të kompanive mediatike në lidhje me atë çfarë duhet raportuar, si duhet të vepohet me rastin e raportimit, si dhe si duhet të vepohet pas raportimit.

Transmetuesi publik i Austrisë, Österreichischer Rundfunk, përbën një shembull të një media që krijon protokolle me synime të barazisë gjinore. Transmetuesi publik ka ngritur një mjet vetërregullues për të promovuar barazinë gjinore dhe për të avancuar karrierën e grave, për të mbështetur një baraspeshë më të mirë midis punës dhe jetës private dhe për të arritur përfaqësimin prej 45 për qind të grave në të gjithë sektorët në organizatë, përfshirë fushat teknike.⁸

Redaksia e gazetës ruse Novaya Gazeta ka miratuar një protokoll kundër dhunës psikologjike dhe seksuale.⁹ Ai përkufizon ngacmimin seksual dhe presionin psikologjik, dhe parasheh krijimin e një bordi që të merret me ankesat e mundshme. Bordi nuk përfshinë redaktorin, drejtorin e botimit ose shkelësit e mëparshëm.

Aleanca ACOS, në bashkëpunim me Qendrën Dart, kanë hartuar Qëndrueshmëria në drejtim: Udhëzues për redaktorët dhe menaxherët e lajmeve se si të punohet me profesionistë të pavarur që u janë ekspozuar traumave.¹⁰

Përfshirja e spektatorëve në seancat e trajnimit: Disa studime kanë sugjeruar që shumë seanca trajnimi tradicionale për ngacmimin seksual nuk janë efektive. Në shkrimin e tij Trajnimi për ngacmimin seksual nuk [funksionon, por ca gjëra funksionojnë](#), The New York Times ofron këshilla që organizatat, përfshirë mediat mund t'i zbatojnë për të krijuar ndryshime domethënëse në kulturat e vendit të punës.¹¹ Ndër qasjet e tjera, shkrimi thekson trajnimin e spektatorëve.

Burime

- [Vetëvlerësimi i sigorisë për organizatat e lajmeve](#) që është krijuar nga Aleanca ACOS është një mjet me rekomandime nga anëtarët për mbështetjen e mediave në rishikimin dhe përmirësimin e praktikave dhe protokolleve të sigorisë.¹²
- Një blog nga WAN-IFRA, [Planifikoni për gjërat e pritshme dhe të papriturat: Çfarë duhet të keni parasysh kur të kryeni një vlerësim të rrezikut](#), ofron konsiderata kryesore për redaksitë, të tilla si krijimi i shablloneve të lehtë për t'u respektuar që gazetaret duhet t'i plotësojnë para fillimit të një detyre.¹³
- [Treguesit e ndjeshëm gjinor të medias nga UNESCO](#) siguron një kornizë për të vlerësuar ndjeshmërinë gjinore në veprimtarinë dhe përmbajtjen e mediave, duke ndihmuar mediat që të ndërmarrin një vetëvlerësim për përmirësimin e qasjes të përgjegjshme gjinore.¹⁴

- Zyra e PLM të OSBE-së ka publikuar një [fletë faktesh](#) për sigurinë e gazetarëve në internet, që gjithashtu përmban burime dhe rekomandime për organizatat mediatike.¹⁵

› **Të sigurohet mbështetje dhe trajnim për gazetarët të cilët përballen me ngacmime dhe abuzime në internet**

Pronarët, menaxherët dhe redaktorët e mediave duhet të jenë të përgatitur që të veprojnë shpejt me forma të ndryshme të mbështetjes për gazetarët të cilët përballen me ngacmime dhe abuzime në internet. Gazetarët të cilët shënjestrohen mund të kenë nevojë për siguri fizike, caktimin në detyrë tjetër, ndihmë psikosociale dhe ligjore, ose kombinim të të gjitha të mësipërmeve.

Gjithashtu, pronarët, menaxherët dhe redaktorët e mediave duhet që të jenë të gatshëm të ndihmojnë dhe mbështesin gazetarët të cilët vendosin të raportojnë rastet tek kompanitë e mediave sociale dhe/ose agjencitë e zbatimit të ligjit. Si pjesë e këtij procesi, ata duhet të vlerësojnë rrezikun e përfshirë në raportimin e sulmeve dhe duhet të sigurohen gjithmonë që ta kenë pëlqimin e plotë nga gazetari i cili ka qenë cak i sulmit. Mediat duhet që të lehtësojnë ose udhëheqin formimin grupeve për mbështetje mes kolegëve, ose lloje të tjera të kanaleve mbështetëse që ofrojnë hapësira të sigurta për gratë gazetare që t'i ndajnë përvojat dhe shqetësimet e tyre.

Pavarësisht nga mbështetja institucionale, gazetarëve, e veçanërisht profesionistëve të pavarur, u duhet të merren me efektin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet të vetëm. Prandaj, mediat duhet t'i japin përparësi sigurimit të mjeteve për të gjithë gazetarët për t'u ndihmuar në identifikimin dhe trajtimin e sulmeve. Gjithashtu, mediat kanë përgjegjësinë për të nxitur dhe për t'i rritur aftësitë mbrojtëse të gazetarëve

të tyre duke ofruar trajnime për mbrojtje tërësore, përfshirë për politikatat dhe protokollet e brendshme. Trajnimet e tilla duhet të përfshijnë menaxhimin e rrezikut të traumës, ndërgjegjësimin për manifestimet e dhunës me bazë gjinore në internet dhe mjetet digjitale të sigurisë.

Paraqitja ose promovimi i programeve të mentorimit mund të ndërtojë lidhjet dhe dialogun mes gazetareve dhe t'u ndihmojë që t'u drejtohen burimeve të dobishme.

Ngacmimi dhe abuzimi me bazë gjinore janë të rrënjosur thellë në normat shoqërore. Mediat janë në gjendje që të ndikojnë me ndryshime pozitive në lidhje me këto norma shoqërore. Trajnimi i gazetarëve dhe profesionistëve të mediave për atë se si të trajtojnë paragjykimet gjinore dhe stereotipat në raportimet e tyre dhe si të realizojnë reportazhe të ndjeshme për dhunën me bazë gjinore mund të nxisë gjithashtu diversitetin në mbulimin mediatik.¹⁶

Një mënyrë për t'i diversifikuar më tej mediat është përfshirja e sa më shumë grave nga të gjitha profesionet, në lajme dhe intervista, dhe njohja e rolit aktiv të grave në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Edhe në vendet që kanë rezultate më të mira përkitazi me barazinë gjinore, përfaqësimi i grave në media është i ulët ose mund të jetë stigmatizues.¹⁷

Trajnimet për çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe ngacmimit e abuzimit në internet duhet të mbahen rregullisht, me trajnime pasuese për të siguruar që të mësimnxënia nga brenda organizatës dhe zhvillimi i aftësive të jetë afatgjatë e kuptimplotë, dhe jo diçka që bëhet vetëm një herë sa për ta plotësuar obligimin.

Shembuj

Krijimi i një fondi mbështetës: Në Finlandë, kompanitë kryesore mediatike bashkuan forcat me sindikatat për të formuar një [fond mbështetës](#) për të ndihmuar gazetarët të cilët janë viktimë të kërcënimeve dhe persekutimeve, përfshirë ngacmimet dhe shtytjet në internet.¹⁸

Reagimi në mënyrë aktive ndaj ngacmimeve dhe abuzimeve në internet: Në Spanjë, gazetat El País dhe La Vanguardia dhe Catalunya Ràdio krijuan [ekipe të mediave sociale](#) për të mbështetur gazetarët të cilët ishin cak i sulmeve. Disa nga veprimet e tyre përfshijnë reagimin e drejtpërdrejt ndaj sulmeve në mediat sociale, largimin e përmbajtjes nga platformat e tyre, dokumentimin e sulmeve dhe mbështetjen për gazetarin e prekur për përgatitjen e procedurave ligjore.¹⁹

Intervistimi i më shumë grave: Në vitin 2011, menaxhmenti i transmetuesit frankofon të Belgjikës, RTBF, nisi një nismë të quajtur [Cherchez la femme](#), duke u kërkuar gazetarëve të saj që të intervistojnë gra në vend të burrave kur një gjë e tillë është e mundur. Kjo masë ka rritur përqindjen e grave të cilat janë paraqitur në transmetimet e lajmeve.²⁰

Monitorimi i përditshëm i pjesëmarrjes në media: Mjeti [Prognosis Shamebot](#) krahason përqindjen e emrave të burrave dhe grave në pothuajse 30 media ditore në internet në Suedi dhe Finlandë.²¹ Megjithatë ky mjet i veçantë ka kufizime, të tilla si mosdhënia e informacionit në lidhje me cilësinë e pjesëmarrjes në media, mediat që e kanë përdorur atë me kalimin e kohës e kanë konsideruar atë si të dobishëm për nxitjen e bashkëbisedimeve të brendshme dhe diskutimeve brenda sektorit të medias për burrat dhe gratë në media.

Burime

- Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës për barazinë gjinore në media rekomandon në [Rec\(2013\)1](#) që mediat “të miratojnë masa vetërregulluese, kod të brendshëm të sjelljes/etikës dhe mbikëqyrje të brendshme, si dhe të zhvillojnë standarde në mbulimin mediatik që promovon barazinë gjinore”. Ai inkurajon gjithashtu palët e treta që të “mbrojnë vazhdimisht barazinë gjinore duke paraqitur shqetësimet e tyre në organet vetërregulluese”.²²
- [Portretizimi i politikës: Pako veglash për gjininë dhe televizionin](#) nga Instituti i Diversitetit të Mediave përmban tetë module për trajnimin e gazetarëve për të marrë parasysh më mirë atë sesi i portretizojnë gratë në politikë.²³
- [SaferJourno: Burime të sigurisë digjitale për trajnerët e medias](#) është një udhëzues falas dhe me burim të hapur i kurrikulës i krijuar nga Internews për trajnerët e mediave të cilët u mësojnë studentëve, profesionistëve dhe kolegëve sigurinë digjitale dhe sigurinë në internet.²⁴ Publikimi që mund të shkarkohet ofron plane mësimore për gjashtë module të ndryshme: vlerësimi i rrezeve, mbrojtja themelore, siguria e telefonit celular, siguria e të dhënave, hulumtimi i sigurt, si dhe mbrojtja e postës elektronike.

› Të hartohen udhëzime për komunitete të përgjegjshme ndaj gjinisë për platforma interaktive në internet

Sot, mediat shpesh kanë hapësira interaktive në internet në faqet e tyre të internetit dhe përmes llogarive të mediave sociale. Udhëzimet e qarta

të komunitetit për angazhimin e përdoruesve në platformat online të mediave mund të ndihmojnë në parandalimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet, ose në zbutjen e ashpërsisë së sulmeve. Ndonëse moderimi i diskutimeve në platformën online të mediave mund të jetë një mjet i rëndësishëm për të parandaluar ose zbutur abuzimin me bazë gjinore në internet, ai nuk duhet të cenojë lirinë e shprehjes. Përveç kësaj, qartësia për atë se si gazetarët duhet të ndërveprojnë në platformat e mediave sociale mund të ndihmojë edhe për të shkurtuar periudhën e nevojshme nga gazetari dhe media për të vlerësuar rrezikun dhe për t'iu përgjigjur sulmeve në mënyrë të përshtatshme.

Gjithashtu, mediat mund të punojnë për të parandaluar ngacmimet dhe abuzimet duke investuar në mënyrë aktive në angazhimin e komunitetit dhe duke promovuar dialog konstruktiv në platformat e tyre në internet. Një mënyrë për ta bërë këtë është duke caktuar menaxherë të përkushtuar të komunitetit.

Shembuj

Angazhimi me komunitetin: Korporata Britanike e Transmetimit (BBC) ka krijuar [Rregullat e shtëpisë](#) për komentim dhe ngarkim në platformat e saj, dhe u ka kërkuar në mënyrë të veçantë lexuesve të saj që të përmbahen nga sjellja abuzive.²⁵

Caktimi i një menaxheri për dialog me komunitetin: Në vitin 2018, transmetuesi publik finlandez Yle filloi së zbatuari [menaxhimin e komunitetit](#) në platformat e tij. Yle punësoi një menaxher të dialogut me audiencën për të krijuar një kulturë më pozitive të diskutimit në internet.²⁶

Deutsche Welle (DW) ka një menaxher të komunitetit i cili është i caktuar ekskluzivisht për moderimin e secilës platformë shërbimi në gjuhën gjermane ku është e pranishme DW, ndërsa shërbimi i saj në gjuhën angleze ka menaxherë aktivë të komunitetit gjatë gjithë kohës.²⁷

Burimet

- Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Medias ka krijuar një [bazë të dhënave në internet](#) për udhëzimet për mediat sociale në të gjitha mediat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.²⁸

› **Të monitorohet dhe dokumentohet abuzimi dhe ngacmimi në internet i gazetareve, përfshirë profesionistët e pavarur**

Nevojiten më shumë të dhëna për të kuptuar dimensionin e plotë dhe ndikimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet, kërcënim ky relativisht i ri për gazetarinë. Mediat mund të ndihmojnë personelin e tyre dhe t'i shërbejnë komunitetit të gjerë të përkushtuar për sigurinë e gazetareve, duke dokumentuar ngacmimin dhe abuzimin në internet të personelit të tyre. Mbledhja e të dhënave të zërthyerë në lidhje me manifestimin dhe dimensionet e ndryshme të ngacmimit dhe abuzimit në internet është thelbësore për realizimin e vlerësimeve të rrezikut që e njohin natyrën e abuzimit dhe për të kuptuar ndryshimet me kalimin e kohës. Kjo do t'ju mundësonte mediave që të gjurmojnë statusin e secilit incident, si dhe të marrin parasysh dhe përmirësojnë masat e marra si reagim, përfshirë ruajtjen e provave kur sulmet përbëjnë sjellje kriminale.

Mekëto informata, mediat mund të krijojnë kanale më efektive të komunikimit me mekanizmat ekzistues kombëtarë të mbrojtjes, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, politikëbërësit dhe autoritetet e zbatimit të ligjit, dhe t'i ndajnë disa nga këto të dhëna me ta. Qëllimi është që të kontribuohet në miratimin e reagimeve me politika gjithëpërfshirëse, duke përfshirë situata të veçanta ku përshkallëzimi i abuzimit ndaj një gazetari të caktuar ose nga kryerës i caktuar kërkon monitorim dhe reagim të përqendruar.

Kjo gjithashtu kërkon transparencë dhe bashkëpunim të plotë me të tërë personelin dhe profesionistët e pavarur, dhe pëlqimin e plotë të gazetarit i cili është cak i sulmit. Madje edhe kur jepet pëlqimi, media duhet të kryejë një vlerësim të rrezikut për sa i përket përdorimit të informacionit identifikues nëse të dhënat ndahen publikisht ose me palë të treta, qoftë me agjenci qeveritare, autoritete të zbatimit të ligjit, grupe të shoqërisë civile ose në ndonjë platformë publike.

Shembuj


Krijimi i një portali për monitorimin e shkeljeve: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese krijoi [BIRD](#), një portal burimesh që monitoron shkeljet e të drejtave dhe lirive digjitale në gjashtë vende në Evropën Qendrore dhe Juglindore dhe publikoi një raport hulumtues për sulmet në internet kundër grave gazetare.²⁹

Realizimi i hulumtimeve për abuzimin në internet: Guardian ka kontraktuar një hulumtim për 70 milion komente të postuara në faqen e saj që nga viti 2006, për të kuptuar natyrën e abuzimit në internet kundër gazetarëve të saj. Kjo media ka zbuluar se në çdo dhjetë shkrimtarë të cilët ishin cak i abuzimit, tetë ishin gra. Gjetjet janë të paraqitura në raportin [Ana e errët e komenteve të Guardian](#).³⁰

Shënime fundore

- 1 Elisa Lees Munoz, “Why we should prioritize women journalists’ safety”, International Women’s Media Foundation, <https://www.iwmf.org/2017/11/why-we-should-prioritize-women-journalists-safety/>.
- 2 Silvia Chocaró, “The safety of women journalists: Breaking the cycle of silence and violence”, IMS Defending Journalism book series, International Media Support, 2019, <https://www.mediasupport.org/publication/the-safety-of-women-journalists>.
- 3 Mozilla Foundation, “Women journalists feel the brunt of online harassment”, Internet Health Report, 2019, <https://internethealthreport.org/2019/women-journalists-feel-the-brunt-of-online-harassment/>.
- 4 Gender Equality Commission, “Handbook on the implementation of Recommendation CM/Rec(2013)1 of the Committee of Ministers of the Council of Europe on gender equality and media”, Council of Europe, 2015, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680590558>.
- 5 Barbara Trionfi and Javier Luque Martínez, “Newsroom Best Practices for Addressing Online Violence against Journalists Perspectives from Finland, Germany, Poland, Spain and the United Kingdom”, IPI, in cooperation with the OSCE RFoM, <https://ipi.media/wp-content/uploads/2019/06/IPI-report-online-harassment-06032019.pdf>.
- 6 IPI, “Measures for Newsrooms and Journalists to Address Online Harassment”, Ontheline Newsrooms, <https://newsrooms-ontheline.ipi.media/>.
- 7 R. Zausmer, J. Godia, “Sexual Harassment in the Media”, Women in the News, 2018, <http://www.womeninnews.org/resource/41>.
- 8 Op. cit. endnote 3, p. 17.
- 9 “Рабочее место должно быть безопасным” (Workplace must be safe), Novaya Gazeta, 14 July 2020, <https://novayagazeta.ru/articles/2020/07/14/86271-rabochee-mesto-dolzno-byt-bezopasnym>.
- 10 Dart Centre and ACOS Alliance, “Leading Resilience: A Guide For Editors & Managers”, 2020, <https://www.acosalliance.org/trauma-management-for-editors>.
- 11 Claire Cain Miller, “Sexual Harassment Training Doesn’t Work. But Some Things Do.”, The New York Times, 11 December 2017, <https://www.nytimes.com/2017/12/11/upshot/sexual-harassment-workplace-prevention-effective.html?smid=fb-nytimes&smtyp=cur&r=0>.
- 12 ACOS Alliance, “News Organizations Safety Self-Assessment”, <https://www.acosalliance.org/self-assessment>.
- 13 Caroline Scott, “Plan for the expected and unexpected: What you need to think about when completing a risk assessment”, World Association of Newspapers and News Publishers, 6 April 2019, <https://blog.wan-iffra.org/2019/06/04/plan-for-the-expected-and-unexpected-what-you-need-to-think-about-when-completing-a-risk->
- 14 UNESCO, “Gender-Sensitive Indicators for Media: Framework of indicators to gauge gender sensitivity in media operations and content”, 2012, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000217831>.
- 15 OSCE RFoM, #SOFJO Factsheet: Safety of Female Journalists Online, 2018, https://www.osce.org/files/f/documents/2/5/370331_o.pdf.
- 16 The New York Declaration, “Gender & media: challenges and opportunities in the Post 2015 era”, 11 March 2017, <https://whomakesthenews.org/wp-content/uploads/who-makes-the-news/Reports/The%20New%20York%20Declaration%202017%20on%20gender%20and%20media.pdf>.
- 17 Sarah Macharia et al., “Who Makes the News? Global Media Monitoring Project”, WACC, 2015, <https://whomakesthenews.org/gmmp-2015-reports>.

- 18 “Media houses and unions set up fund to support journalists facing harassment”, The Union of Journalists in Finland news item, 28 May 2019, <https://journalistiliitto.fi/en/media-houses-and-unions-set-up-fund-to-support-journalists-facing-harassment/>.
- 19 Op. cit. endnote 5.
- 20 Op. cit. endnote 4.
- 21 Prognosis Shamebot, “Gender Equality Tracker 2020”, <http://www.prognosis.se/GE/>.
- 22 Council of Europe “Draft analytical report on the follow-up on the implementation of Recommendation CM/Rec(2013)1 of the Committee of Ministers of the Council of Europe on gender equality and media”, GEC(2019)10, CDMSI (2019)04, 8 November 2019, p. 46, <https://rm.coe.int/gec-2019-10-cdmsi-gec-analytical-report-cm-gender-equality-and-media/168098bce5>.
- 23 Portraying Politics Project Partners, “Portraying Politics – A toolkit on gender and television”, 2006, http://www.media-diversity.org/en/additional-files/documents/PP_EN.pdf.
- 24 “SaferJourno”, Internews, <http://saferjourno.internews.org/>.
- 25 “What are the rules for commenting and uploading?”, BBC, 2018, <https://www.bbc.co.uk/usingthebbc/terms/what-are-the-rules-for-commenting/>.
- 26 “Finnish public broadcaster fights online hate speech with dialogue and respect”, European Federation of Journalists news item, 20 August 2018, <https://europeanjournalists.org/blog/2018/08/20/finnish-public-broadcaster-fights-online-hate-speech-with-dialogue-and-respect/>.
- 27 Op. cit. endnote 5, p. 35.
- 28 “Social Media Guidelines for Journalists EU28”, European University Institute, <https://cmpf.eui.eu/social-media-guidelines-for-journalists-eu28/>.
- 29 “B.I.R.D.”, The Balkan Investigative Reporting Network and Share Foundation, <https://monitoring.bird.tools>.
- 30 Becky Gardiner et al., “The dark side of Guardian comments”, The Guardian, 12 April 2016, <https://www.theguardian.com/technology/2016/apr/12/the-dark-side-of-guardian-comments>.



**Organizatat
e gazetarëve
dhe organet
vetërregulluese**

Veprimet e propozuara

1. Të shtohen veprimet dhe avokimi kolektiv për të përmirësuar sigurinë dhe kushtet e tjera të punës për gazetaret;
2. Të konsolidohen kapacitetet përmes rrjeteve mes kolegëve, trajnimeve dhe mbështetjes tjetër praktike;
3. Të dokumentohen sulmet dhe informatat të përdoren për ndërgjegjësimin e aktorëve kryesorë;
4. Të promovohet përfshirja e çështjeve të sigurisë dhe barazisë gjinore në punën e organeve vetërregulluese.

8. Organizatat e gazetarëve dhe organet vetërregulluese

Organizimi i veprimit kolektiv dhe kodeve të sjelljes

Organizatat e gazetarëve si shoqatat dhe sindikatat profesionale i mbrojnë të drejtat e punës dhe interesat e përbashkëta të gazetarëve. Kjo përfshin rritjen e sigurisë së anëtarëve të tyre dhe mbështetje kur ata përballen me kërcënime të veçanta. Aktorët jo shtetërorë të këtij sektori, të tillë si këshillat e mediave, shoqëritë e redaktorëve, institucionet arsimore dhe ombudspersonët për media të cilët janë emërohen nga një ose shumë media, mund të luajnë gjithashtu rolin e tyre për promovimin e sigurisë së gazetarëve.

Kjo pjesë përvijon mënyrat në të cilat këta aktorë, përveç aktorëve të lëmit të arsimit që do të trajtohen më vonë, mund të rrisin ndikimin e tyre për promovimin e sigurisë së gazetarëve në internet.

Në [Vendimin nr. 3/18 e Këshillit Ministror të OSBE-së](#), 57 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së “vënë re me shqetësim se përdorimi i masave të papërshtatshme kufizuese kundër gazetarëve mund të ndikojë në sigurinë e tyre dhe i parandalon ata nga ofrimi i informacioneve për publikun, duke ndikuar kështu në mënyrë negative në ushtrimin e së drejtës për liri të shprehjes.”

› **Të shtohen veprimet dhe avokimi kolektiv për të përmirësuar sigurinë dhe kushtet e tjera të punës për gazetaret**

Shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve luajnë një rol vendimtar në detyrimin e mediave që si punëdhënës t'i përmbushin detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për sigurinë e grave gazetare gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre gazetareske, qofshin ato personel apo profesioniste të pavarura.

Në përpjekjet e tyre për të përmirësuar kushtet e punës në profesionin e mediave, shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve mund t'u japin përparësi sfidave të posaçme me të cilat përballen gazetaret. Negocimi me organizatat e mediave për t'i dhënë fund hendekut gjinor për pagën midis burrave dhe grave është thelbësor, ngaqë kjo praktikë shkel të drejtat e punëtorëve dhe përjetëson diskriminimin ndaj grave. Po ashtu, avokimi për barazinë gjinore dhe politikën kundër ngacimit seksual në media është thelbësor, krahas protokolleve të sigurisë që përfshijnë procedura të posaçme për gazetaret, si dhe pajisjet dhe mbështetjen e nevojshme.

Organizatat e gazetarëve duhet të angazhohen për barazi gjinore dhe politika gjinore edhe në strukturat e tyre dhe t'u kushtojnë vëmendje të veçantë çështjeve të ngacimit dhe abuzimit në internet të anëtarëve të tyre.

Përveç negociatave, shoqatat dhe sindikatat profesionale mund të monitorojnë dhe analizojnë legjislacionin për të avokuar për përmirësim e tij, kur është e nevojshme, në nivelin kombëtar, rajonal dhe atë ndërkombëtar. Kur ngacimi dhe abuzimi në internet përbëjnë sjellje kriminale, organizatat mund të sigurojnë mbështetje ligjore për gazetarët dhe bashkëpunëtorët.

Shembuj

Dhënia e rekomandimeve: Sindikata e Gazetarëve në Finlandë krijoi fletushkën [Fushatat e urrejtjes - Çfarë duhet të bëjmë](#). Ajo përmban rekomandime, të tilla si dokumentimi i abuzimit, caktimi i këshillimit për punonjësit nëse është e nevojshme, ose postimi i komenteve pozitive për ndonjë koleg në internet, për të informuar redaktorët, menaxherët dhe gazetarët për atë se çfarë hapash duhet ndërmarrë kur ata vetë, ndonjë punonjës ose kolegë janë cak i ngacmimeve dhe abuzimeve në internet.¹

Promovimi i barazisë gjinore në industrinë e mediave: Në qershor të vitit 2019, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) miratoi një seri të re të standardeve ndërkombëtare të punës, [Konventën 190 për dhunën dhe ngacmimin](#).² Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (FNG) po udhëheq fushatën Konventa 190 e ONP: Mund të ndryshojë jetët, duke u bërë thirrje Shteteve që ta ratifikojnë konventën.³

Përditësimi i politikave sindikaliste kur është e nevojshme: Sindikata Kombëtare e Gazetarëve në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë azhurnoi politikat e saj për të përfshirë një pjesë për [seksizmin dhe bullizmin](#).⁴

Burime

- FNG ka publikuar një seri të [Udhëzimeve për mediat dhe sindikatat për të luftuar ngacmimin e gazetarëve në internet](#), për të ndihmuar menaxherët e mediave, sindikatat dhe kolegët për ndërmarrjen e veprimeve të duhura.⁵

› **Të konsolidohen kapacitetet përmes rrjeteve mes kolegëve, trajnimeve dhe mbështetjes tjetër praktike**

Mbështetja mes kolegëve është dëshmuar të jetë çelës për gratë gazetare për t'u përballuar me ngacmimin dhe abuzimin në internet. Kolegët të cilët kanë përjetuar përvoja të ngjashme mbështesin njëri-tjetrin, për shembull përmes rrjeteve mes kolegëve. Sidoqoftë, rezulton se trajnimi dhe ndihma është e dëshirueshme, pasi çështjet që lindin mund të jenë të ndjeshme dhe komplekse. Së bashku me mediat (shih gjithashtu kapitullin shtatë), shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve mund të krijojnë rrjete mbështetëse për kolegët, të ofrojnë trajnime dhe të sugjerojnë rregulla për angazhim, si dhe forma të tjera të mbështetjes psikosociale. Ekspertiza e këtij lloji të aktorëve i bën ata mbrojtës të çmuar të sigurisë së gazetarëve. Ata mund të japin kontribut domethënës për zyrtarët publikë dhe parlamentarët për hartimin e legjislacionit dhe politikave që trajtojnë ngacmimin dhe abuzimin në internet.

Gjithashtu, shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve mund të organizojnë trajnime praktike për gratë gazetare në lidhje me praktikat më të mira të mundshme për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit dhe abuzimit në internet. Zhvillimi i hulumtimeve, gjithashtu në bashkëpunim me institucionet trajnuese e arsimore për gazetari dhe me pronarët e mediave, është thelbësor për t'i kuptuar më mirë sfidat me të cilat përballen gazetaret. Ato mund të lehtësojnë po ashtu forume të drejtuara nga gratë për ndarjen e informatave, duke u përqendruar në veglat për realizimin e vlerësimeve vetanake të rrezikut, mënyrave në të cilat mund t'i bëjnë profilet nëpër mediat sociale më të sigurta dhe këshilla se si t'i trajtojnë situatat kur janë cak i ngacmimit dhe abuzimit në internet.

Shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve kanë shpesh grupe grash ose persona kontaktues për gazetaret, që ofrojnë hapësira të rëndësishme për gratë që

të flasin rreth përjetimeve të tyre dhe nevojave për siguri. Përveç kësaj, shoqatat dhe sindikatat mund të hapin një pjesë të veçantë në faqen e tyre të internetit, që i kushtohet sigurisë së gazetareve në internet, duke ofruar informata, kontakte dhe burime gjegjëse që janë të thjeshta për t'iu qasur.⁶

Shembuj

Krijimi i veglave të trajnimit: Shoqata Ndërkombëtare e Grave në Radio dhe Televizion ka përpiluar një doracak sigurie për gratë, [Çfarë nëse? Doracak i sigurisë për gazetaret](#). Ai është përdorur për trajnime për mbrojtje në disa vende.⁷

Nxjerrja e mësimave nga praktikat e mira: Në vitin 2019, Sindikata e Gazetarëve në Turqi dhe Federata Evropiane e Gazetarëve organizuan një punëtori për praktikat më të mira dhe veglat konkrete për të përmirësuar barazinë gjinore dhe diversitetin në procesin e prodhimit mediatik dhe për luftimin e ngacmimeve në rritje e sipër në internet.⁸

Burime

- [Doracaku për praktikat më të mira të barazisë gjinore në sindikatat evropiane](#) i FNG-së përmbledhë një sërë praktikash të mira për të përmirësuar barazinë gjinore në sindikata dhe media.⁹

› **Të dokumentohen sulmet dhe informatat të përdoren për ndërgjegjësimin e aktorëve kryesorë**

Documenting attacks against journalists with a gender-responsive
Dokumentimi i sulmeve ndaj gazetarëve me një qasje të përgjegjshme
gjinore është thelbësor për ta kuptuar kompleksitetin e sfidave me të cilat
përballen gazetaret dhe mënyrat për t'i trajtuar ato.

Identifikimi i mënyrës më efektive dhe më të sigurt për të dokumentuar
dhunën në internet ndaj gazetarëve është gjithashtu thelbësor për
promovimin e sigurisë së gazetarëve, duke pasur parasysh që gjithnjë
e më shumë sulme ndaj mediave po kryhen përmes internetit. Për
shkak se ato janë në kontakt të ngushtë të vazhdueshëm me anëtarët e
tyre, rrjetet profesionale, shoqatat e gazetarëve dhe sindikatat janë në
pozitën të duhur për të monitoruar sulmet dhe për të analizuar trendet.
Bashkërendimi dhe bashkëpunimi midis grupeve që mund të gjurmojnë
dhunën ndaj gazetarëve është i rëndësishëm për të shmangur dyfishimet
dhe për të mbështetur njëri-tjetrin.

Informatat e hollësishme që shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve i kanë
për gjendjen e sigurisë së gazetarëve mund të përdoret për fillimin dhe
mbështetjen e fushatave të ndërgjegjësimin, por mund të përdoret edhe
për të angazhuar organizata mediatike, politikëbërësit dhe aktorë të tjerë
kyç, gjithnjë në transparencë të plotë dhe me pëlqimin e gazetarit i cili
është cak i sulmit. Bashkëpunimi midis këtyre grupeve të aktorëve mund
të rrisë ndikimin e nismave të sigurisë.

Shembuj

Mbledhja e informatave: Sindikata e Gazetarëve në Finlandë ka përgatitur një anketë për të parë se në ç'përmasë janë gazetarët cak i sulmeve; anketa ka ndihmuar për të kuptuar më mirë problemin dhe për të ndërmarrë veprime për ta trajtuar atë.¹⁰

Krijimi i aleancave për monitorim: Në Evropën Juglindore, gjashtë shoqata gazetarësh dhe sindikata të medias bashkuan forcat me nismën [Gazetarë të sigurt](#).¹¹ I nisur në vitin 2016, projekti monitoron sigurinë e gazetarëve në rajon nga perspektiva ligjore dhe politike. Ai bën po ashtu vetëdijesim në lidhje me sulmet dhe avokon për sigurinë e gazetarëve. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, aleanca ka ngritur mes tjerash një linjë telefonike ndihme dhe një rrjet për gratë gazetare.

Krijimi i aleancave ndërsektoriale: Sindikata më e madhe e sektorit privat të Kanadasë, Unifor, ka bërë vetëdijesim në lidhje me ngacmimet seksuale dhe abuzimin në internet kundër grave punonjësve të mediave në një [video fushatë](#) të vitit 2018, duke treguar se sindikatat dhe shoqatat profesionale, të cilat përfaqësojnë një gamë më të gjerë sektorësh sesa vetëm sektori i mediave, mund t'i bashkojnë forcat për të luftuar sulmet me bazë gjinore në internet.¹²

Fushata për raportim më të madh: Në vitin 2019, FNG filloi [fushatën #YouAreNotAlone](#) për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me ngacmimet dhe abuzimet gjinore dhe të seksualizuara në internet ndaj gazetarëve, si dhe për t'i inkurajuar gazetarët që të solidarizohen me kolegët e tyre që janë cak i sulmeve.¹³ FNG dhe grupi i tij partner, Rrjeti i Solidaritetit të Mediave në Azinë Jugore (SAMSN) krijuan [Fushatën ByteBack](#), e cila çoi në publikimin e vitit 2017 të [Udhëzuesit të gazetarit për të luftuar ngacmimet kibernetike në Azinë Jugore](#).¹⁴

Bashkëpunimi me autoritetet kur është e nevojshme: Në Maqedoninë e Veriut, Shoqata e Gazetarëve dhe Ministria e Punëve të Brendshme nënshkruan një Memorandum për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për të rritur ndërgjegjësimin për çështjen e mosndëshkimit për krimet kundër gazetareve dhe për të bashkëpunuar në rastet e sulmeve.¹⁵

› **Të promovohet përfshirja e çështjeve të sigurisë dhe barazisë gjinore në punën e organeve vetërregulluese**

Koncepti i kornizës vetërregulluese për mediat i referohet disa aktorëve, institucioneve dhe organizatave të një vendi që u përmbahen standardeve ndërkombëtare për media dhe gazetari dhe që, në praktikë, kontribuon për një kulturë dhe mjedis që shtyn përpara mediat e pavarura dhe cilësore.

Lloji i aktorëve që kanë një rol zyrtar ose jozyrtar për vetërregullimin e mediave mund të përfshijë, ndër të tjera, mediat e shquara, këshillat e mediave dhe shtypit, shoqatat e redaktorëve, ombudspersonët, sindikatat dhe institucionet e trajnimit.¹⁶ Ndonjëherë të krijuara përmes negociatave me shtetin, mekanizmat zyrtarë vetërregullues duhet që në parim të krijohen në baza vullnetare, të veprojnë në mënyrë transparente dhe të jenë të qasshëm për publikun. Ombudspersonët dhe mekanizmat e ankesave në kuadër të organeve që përfaqësojnë mediat (të tilla si këshillat e mediave ose bordet e etikës së mediave) janë jetësuar në disa raste, pas negociatave me shtetin, për të lehtësuar rregulloret shtetërore shtypëse.

Standardet profesionale të mediave dhe etika e mediave ofrojnë një hapësirë efektive për nismat për sigurinë dhe çështjet e barazisë gjinore. Një gamë e gjerë e kompanive, institucioneve dhe organizatave mund të

përdorin etikën e mediave për të kontribuar për një kulturë dhe një mjedis që shtyn përpara mediat e pavarura dhe mbështetë cilësinë e mediave.

Etika mediale shërben po ashtu si bazë për krijimin e mekanizmave zyrtarë të vetërregullimit, të tillë si këshillat për media dhe shtypin, që mund të jenë të dobishëm për lehtësimin e rregullimit shtetëror. Ndonjëherë të krijuara përmes negociatave me shtetin, mekanizmat zyrtarë të vetërregullimit, në parim, duhet të jenë të formuara në baza vullnetare, të funksionojnë në mënyrë transparente dhe të jenë të qasshme për publikun.

Organet vetërregulluese mund të luajnë një rol me ndikim për barazinë gjinore dhe sigurinë në media pasi që ato pranojnë informata për incidentet nga palët e tyre të interesit, flasin me kolegët e tyre, dhe aktorët e mediave shpesh i pranojnë këto organe. Kur ka një ndryshim të planifikuar të politikës, këta aktorë mund të parashtrojnë informata kthyesë të përbashkëta në bazë në ekspertizës së nivelit të lartë. Gjithashtu, ato mund të tërheqin vëmendjen në situatat e sigurisë dhe t'u sugjerojnë masa organeve ekzekutive dhe legjislative, në përputhje me lirinë e mediave.

Roli i organeve vetërregulluese të mediave shtrihet, për shembull, në zhvillimin dhe promovimin e një kodi të etikës që, nën emërtime të ndryshme, mund të dëshmohet të jetë një pikë themelore referimi, duke i udhëzuar gazetarët për rolin, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dhe se si ata mund ta bëjnë më së miri punën e tyre. Ky kod i etikës duhet të jetë i përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe të hartohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e grave.

Siç u diskutua më parë, siguria e grave në punë varet edhe nga kolegët dhe menaxherët. Një kornizë e konsoliduar e vetërregullimit të medias supozon jo vetëm zhvillimin e një kodi të etikës, por edhe ekzistencën

e një organi ekonomik që është i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të tij dhe format për sanksionimin e atyre që nuk e respektojnë atë.¹⁷ Organet vetërregulluese të mediave mund të sigurojnë që praktikat më të mira rreth ngacmimit dhe abuzimit ma bazë gjinore integrohen në konstatimet kolektive për standardet dhe praktikat e rekomanduara në përdorim për gazetarët në zonën gjeografike përkatëse.

Mediat kontribuojnë në vetërregullim duke zbatuar normat dhe standardet kolektive brenda tyre, por gjithashtu duke komunikuar me publikun si, për shembull, duke publikuar informatën kur ata kanë bërë një gabim, duke dhënë informata transparente në lidhje me punën dhe politikën e tyre editoriale, dhe duke siguruar një ombudsperson në kuadër të tyre. Ky funksion dallon nga njëra media në tjetrën, por në përgjithësi, një ombudsperson i brendshëm vepron si ndërmjetës midis personelit të një shtëpie mediale duke nxitur dialogun midis dy palëve.

Aktorët që kontribuojnë në kornizën e pavarur vetërregulluese mund t'u kushtojnë më shumë vëmendje çështjeve që prekin sigurinë e grave. Për shembull, ata mund të trajtojnë mënyrën e monitorimit dhe zbutjes së dhunës me bazë gjinore në përgjithësi, dhe ngacmimi e abuzimi me bazë gjinore në internet në veçanti.

Shembuj

Fushatë e përbashkët kundër mosndëshkimit për diskriminimin

gjinor: Një gazetarë në Rusi u turpërua publikisht pasi bëri një ankesë kundër një deputeti të Këshillit të Federatës (dhoma e lartë e Parlamentit Rus) për ngacmim seksual. Shoqatat e medias dhe një sindikatë bashkuan forcat për t'i dhënë fund si sjelljes abuzuese ashtu dhe sjelljes mospërfillëse. Aktorët e bashkuar vunë në dyshim

legjitimitetin e mandatit të deputetit dhe i dërguan një letër Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës duke bërë thirrje për bojkot të të gjithë deputetëve rusë.¹⁸

Përdorimi i mekanizmave të ankesave ndërsektoriale: Pas incidenteve të ngacmimit të gazetareve në internet në Finlandë, u parashtruan ankesa pranë Ombudspersonit Parlamentar të vendit dhe Këshillit për Media.¹⁹

Aranzhimi standard për industrinë e medias nga industria e medias: Rrjeti i Gazetarisë Etike është një referencë solide për etikën e medias. Ky koalicion i përbërë prej më shumë se 70 grupe gazetarësh, redaktorësh, pronarë shtypi dhe grupe mbështetëse të mediave nga e gjithë bota ka botuar një raport të titulluar [Shpëtimi i lajmit](#), i cili adreson dhunën me bazë gjinore ndaj gazetareve, duke përfshirë ngacmimin në internet.²⁰

Vendosja e standardeve morale për mediat: Pronarët e mediave dhe shoqatat e gazetareve themeluan Bordin e etikës së medias në Suedi në 1916, me qëllim që të mundësohet më shumë vetë-kontroll në këtë profesion.²¹ Bordi dhe Ombudspersoni i tij për Media zgjedhin artikuj medial që mund të adresohen nga bordi ose nga Ombudspersoni, në lidhje me histori mbi diskriminimin, përfshirë rastet kur një grua akuzon një burrë për ngacmim.

Vendimet e bordit sugjerojnë kufij moralë të mirë-argumentuar për mediat dhe duke qenë të tillë, potencialisht e kufizojnë rrezikun e gjykimeve arbitrare për çështje të ngjashme në të ardhmen.

Forcimi aktiv i organizatave simotra: Rrjetet për këshillat e mediave dhe sindikatat mbështesin zhvillimin e praktikave digjitale dhe ndihmojnë këshillat e rinj për të krijuar aktivitete të edukimit

medial, mekanizma ankesash dhe dokumente normative mbi etikën dhe legjislacionin.²² Këshillat që kanë mbështetur në mënyrë aktive gratë e shënjestruara nga shkelësit digjitalë kanë ndarë përvojat e tyre me këshillat e tjerë brenda rrjeteve.

Trajnimi i aktorëve vetërregullues: Duke qenë pjesë e llojeve të ndryshme të organizatave me fusha të ndryshme të përgjegjësisë, aktorët brenda kornizës vetërregulluese shpeshherë nuk kanë platforma për t'u takuar dhe mësuar në mënyrë rutinore nga njëri-tjetri. Në një program trajnimi ndërkombëtar të financuar nga Suedia, efekti kryesor ka qenë që aktorët të mësojnë rreth politikëbërjes mediatike paralelisht me shkëmbimin e pikëpamjeve mbi kërcënimet e konsiderueshme ndaj burrave dhe grave, dhe vendosjen e rutinës së komunikimit për të përmirësuar sigurinë e gazetarëve.²³

Burime

- Aleanca e Këshillave të Pavarur të Shtypit të Evropës (AIPCE) publikoi një [raport lidhur me rolin e organeve vetërregulluese në epokën digjitale](#).²⁴
- Ekzistojnë dy udhëzues të botuar nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias mbi rolin e vetërregullimit: [Libri udhëzues për vetërregullimin e medias dhe Libri udhëzues për vetërregullimin e mediave në internet](#).²⁵
- Këshilli i Evropës identifikon praktikën e mira në raportin analitik mbi rezolutën e vitit 2013 për barazinë gjinore dhe diskuton sesi organet vetërregulluese në Shtetet anëtare kanë zbatuar rekomandimet e Këshillit mbi barazinë gjinore.²⁶

Shënime fundore

- 1 Johanna Vehkoo and Emmi Nieinen, "Hate campaigns – What you should do", Suomen Journalistiliitto, Finlands Journalistförbun, https://journalistiliitto.fi/wp-content/uploads/2019/01/Hate_Campaigns_web.pdf.
- 2 International Labour Organization, "C190 – Violence and Harassment Convention" (No. 190), 2019, https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEX-PUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C190.
- 3 "16 Days of activism: Ratify Convention 190", International Federation of Journalists (IFJ), <https://www.ifj.org/media-centre/news/detail/category/new-campaign-on-violence/article/16-days-of-activism-ratify-convention-190.html>.
- 4 "NUJ policy", <https://www.nuj.org.uk/rights/women-in-the-nuj/nuj-policy/>.
- 5 "Guidelines for media and unions to combat online harassment of women journalists", IFJ, 2019, https://www.ifj.org/fileadmin/user_upload/guidelines_EN_final.pdf.
- 6 Ibid.
- 7 International Association of Women in Radio and Television (IAWRT), "What if...? Safety Handbook for Women Journalists", 2017, <https://www.iawrt.org/sites/default/files/field/pdf/2017/11/IAWRT%20Safety%20Manual.Download.10112017.pdf>.
- 8 "Journalists' organizations on the front line to tackle gender equality and online harassment", International Federation of Journalists news item, 6 June 2019, <https://european-journalists.org/blog/2019/06/06/journalists-organisations-on-the-front-line-to-tackle-gender-equality-and-online-harassment/>.
- 9 "Handbook on Gender Equality Best Practices in European Journalists' Unions", IFJ, https://www.ifj.org/what/gender-equality.html?tx_wbresources_list%5Bresource%5D=16&cHash=d1c-c3c8a3d9f6eed57baf82b524c45ad.
- 10 Barbara Trionfi and Javier Luque Martínez, "Newsroom Best Practices for Addressing Online Violence against Journalists Perspectives from Finland, Germany, Poland, Spain and the United Kingdom", IPI, in cooperation with the OSCE RFoM, <https://ipi.media/wp-content/uploads/2019/06/IPI-report-online-harassment-06032019.pdf>.
- 11 Regional Platform for advocating media freedom and journalists' safety, <https://safejournalists.net>.
- 12 "It's Not Okay! Sexual harassment must stop!", Unifor Canada's YouTube Channel, <https://www.youtube.com/watch?v=od7vVtwzTDA&feature=youtu.be>.
- 13 "Online Trolling: You are NOT alone", IFJ, <https://www.ifj.org/actions/ifj-campaigns/online-trolling-you-are-not-alone.html>.
- 14 Byte Back Campaign, IFJ and SAMSN, 2017, https://samsn.ifj.org/wp-content/uploads/2017/03/Byte_Back_Handbook.pdf.
- 15 Besim Nebiu et al., "Indicators on the level of media freedom and journalists' safety in Macedonia, Association of Journalists of Macedonia", Skopje, 2018, <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2018/12/Indicators-on-the-level-of-media-freedom-and-journalists-safety-in-Macedonia.pdf>.
- 16 "The Media Self-Regulation Guidebook", OSCE RFoM, 2008, <https://www.osce.org/files/f/documents/1/d/31497.pdf>. The website of the Press Council of Ireland, independent from the State, presents work areas that media councils often work with: <https://www.presscouncil.ie/>.
- 17 Ibid.
- 18 Nadezhda Azhgikhina's article in The Nation, PEN Moscow Center's website, 4 May 2018, <https://penmoscow.ru/our-news-2/516>.
- 19 Scott Griffen (ed.), "Legal Responses to Online Harassment and Abuse of Journalists: Perspectives from Finland, France and Ireland", OSCE RFoM and IPI, 7 March 2019, <https://www.osce.org/files/f/documents/8/9/413549.pdf>.

- 20 Hannah Storm, “Gender on the agenda for the future of ethical journalism”, <https://www.journalism.co.uk/news/gender-on-the-agenda-for-the-future-of-ethical-journalism-not-just-for-women/s2/a737953/>.
- 21 Swedish Media Ombudsperson, <https://medieombudsmannen.se/>. About the Media Ombudsperson, <https://www.presscouncils.eu/members-sweden>.
- 22 Alliance of Independent Press Councils of Europe and European Federation of Journalists, “Media Councils in the Digital Age”, <https://www.presscouncils.eu/Media-Councils-in-the-Digital-Age> and <https://europeanjournalists.org/media-councils-in-the-digital-age/>. The Media Self-Regulatory Organizations Network (Armenia, Azerbaijan, Belarus, Georgia, Moldova, Ukraine and Russia). <https://www.mediacouncils.org/about-us/>.
- 23 NIRAS, “Media Development in a Democratic Framework”, 2020, <https://www.niras.com/development-consulting/international-training-programmes/media-development-in-a-democratic-framework/>. “Media regulation in a democratic framework: Eastern Europe” (in Russian), Sida, International Training Programmes, 2020: <https://itp.sida.se/itp/Programcatalog.nsf/01C73DB9D0D9257B6C125839300475B4B?opendocument>.
- 24 Raymond A. Harder and Pieter Knapen, Media Councils in the Digital Age: An inquiry into the practices of media self-regulatory bodies in the media landscape today, University of Antwerpen, <https://www.presscouncils.eu/userfiles/files/Media%20Councils%20in%20the%20Digital%20Age.pdf>.
- 25 OSCE RFoM, “The Media Self-Regulation Guidebook”, 2008, <https://www.osce.org/fom/31497>; OSCE RFoM, The Online Media Self-Regulation Guidebook. 2013, <https://www.osce.org/files/f/documents/d/b/99560.pdf>.
- 26 Council of Europe, Committee of Ministers, “Draft analytical report on the follow-up on the implementation of Recommendation CM/Rec(2013)1 of the Committee of Ministers of the Council of Europe on gender equality and media”, GEC(2019)10, CDMSI (2019)04, 8 November 2019, <https://rm.coe.int/gec-2019-10-cdmsi-gec-analytical-report-cm-gender-equality-and-media/168098bce5>.



**Organizatat e
shoqërisë civile dhe
institucionet arsimore**

Veprimet e propozuara

1. Të shtohen të dhënat, njohuritë dhe ndërgjegjësimi i aktorëve kyç dhe shoqërisë në përgjithësi mbi ngacmimin dhe abuzimin me bazë gjinore në internet;
2. Të bashkohen forcat për të avancuar zbatimin e standardeve të sigurisë dhe kushteve të tjera të punës për gazetaret në nivel kombëtar;
3. Të zhvillohen trajnime dhe materiale edukuese për mbrojtje tërësore;
4. Të integrohet siguria e gazetarëve dhe barazia gjinore në aktivitetet e edukimit dhe trajnimit për gazetari.

9. Organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore

Mobilizimi, hulumtimi dhe shkëmbimi i praktikave të mira

Ky kapitull shikon se si aktivistët, trajnerët, arsimtarët dhe akademia mund të bashkëpunojnë dhe forcojnë punën e tyre për t'iu kundërvënë ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj grave gazetare.

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC), në veçanti aktorët joqeveritarë që punojnë për lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit, zhvillimin e medias dhe të drejtat e grave, mbështesin gazetarët në shumë mënyra të ndryshme: duke filluar nga avokimi kundër sulmeve dhe pandëshkueshmërisë, e deri te zhvillimi i trajnimeve praktike për sigurinë. Viteve të fundit, OSHC-të kanë raportuar gjithnjë e më shumë, dhe në mënyra të tjera iu kanë përgjigjur, kërcënimit në rritje të ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetareve.

Meqë universitetet dhe institucionet e tjera arsimore janë përgjegjëse për edukimin dhe trajnimin e gazetarëve dhe menaxherëve të mediave të tanishëm dhe të ardhshëm, këto organizata mund të kontribuojnë në rritjen e vetëdijesimit dhe njohurive mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjet e barazisë gjinore. Universitetet janë gjithashtu në gjendje të ngrenë diskutime publike mbi çështjet e politikave dhe zbatimin e tyre. Për më tepër, roli i tyre në kryerjen e hulumtimeve mund të kontribuojë në kuptim më të mirë të sfidave të ngacmimit dhe abuzimit në internet ndaj gazetareve.

Në [Vendimin nr. 3/18 e Këshillit Ministror të OSBE-së](#), 57 Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë “thellësisht të brengosura nga të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut dhe abuzimet e bëra në lidhje me sigurinë e gazetarëve, duke përfshirë ato ku përfshihet vrasja, tortura, zhdukja e detyrueshme, arrestimet arbitrare, ndalimet arbitrare dhe dëbimet arbitrare, frikësimet, ngacmimet dhe kërcënimet e të gjitha formave, si ato fizike, ligjore, politike, teknologjike ose ekonomike, me qëllim shtypjen e punës së tyre.”

› **Të shtohen të dhënat, njohuritë dhe ndërgjegjësimi i aktorëve kyç dhe shoqërisë në përgjithësi mbi ngacmimin dhe abuzimin me bazë gjinore në internet**

Hapi i parë në adresimin e një problemi të identifikuar është krijimi i një pasqyre të përgjithshme të çështjes në fjalë. Monitorimi në një mënyrë sistematike i ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj gazetarëve mund të jetë sfidues. Numri i rasteve dhe mënyrat e kanalet përmes të cilave manifestohen këto çështje janë të shumta. Në të njëjtën kohë, hulumtimet tregojnë se sulmet me bazë gjinore në shumë raste nuk raportohen për shkak të stigmave shoqërore dhe profesionale, si dhe potencialit për trauma të shoqëruara me sulmet.¹ Shumë grupe të shoqërisë civile që monitorojnë dhe paraqesin të dhëna për sulmet kundër gazetarëve mund të punojnë në bashkëpunim me shoqatat profesionale, sindikatat, organet e medias, akademinë dhe organet publike të angazhuara në dokumentimin e rasteve të ngacmimit dhe abuzimit në internet. E gjithë kjo duhet të bëhet me një qasje konsideruese ndaj gjinisë që gjurmon informacionin bazë të kategorizuar sipas gjinisë dhe faktorë e specifika të tjera, siç është raportimi i ngjarjeve që i paraprinë një sulmi.

Dokumentimi me një qasje të përgjegjshme gjinore nuk i referohet vetëm asaj "çfarë" monitorohet, por gjithashtu edhe "si" monitorohen rastet. Procesi i hulumtimit duhet të synojë jo vetëm mbledhjen e të dhënave, por gjithashtu të bëhet me pjesëmarrje të gazetareve. Duhet të jetë e qartë gjatë gjithë procesit, për shembull, se ngacmimi dhe abuzimi në internet është pjesë e një grupi më të gjerë kërcënimesh ndaj gazetarisë dhe jo një barrë private e individit specifik.

Kjo kërkon përpjekje thelbësore dhe të koordinuara për të rritur njohuritë e publikut për çështjen e ngacmimeve në internet me bazë gjinore. Ndonëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në hulumtim mbi këtë temë, është e rëndësishme të identifikohen boshllëqet e kërkimit dhe të prodhohen raporte shtesë që mbulojnë tema të ndryshme dhe një përfaqësim të larmishëm të vendeve. Një mundësi e pashfrytëzuar është bashkëpunimi midis institucioneve akademike dhe OSHC-ve të shumta që kryejnë kërkime dhe monitorime. Edhe këtu, mënyra "si" është e rëndësishme. Çdo formë e hulumtimit duhet t'i përfshijë gazetaret, zërat, pikëpamjet dhe perspektivat e tyre, dhe duhet të prodhohet dhe shkruhet në mënyrë të tillë që praktikuesit ta përdorin atë për të forcuar sigurinë e gazetareve në internet.

Pavarësisht nëse përfshihen në kërkime drejtpërdrejt ose jo, shumë OSHC luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe mobilizimin e politikë-bërësve, komunitetit të medias dhe shoqërisë në tërësi. Kjo mund të çojë në një mobilizim më të madh kolektiv për të trajtuar ngacmimet dhe abuzimet në internet. Koordinimi midis OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë është thelbësor për të shfrytëzuar ndikimin dhe për të shmangur mbivendosjen e përpjekjeve. Një bashkëpunim i tillë mund të marrë forma të ndryshme dhe mund të zhvillohet në nivele të ndryshme: niveli global, rajonal, kombëtar ose lokal.

Shembuj

Mbledhja e të dhënave: Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve (KMG) mban një [bazë të dhënash](#) globale në internet të gazetarëve të vrarë, të burgosur dhe të zhdukur, që përmban të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë.³ Në vitin 2019, KMG gjithashtu publikoi sondazhin [Kërcënimet na ndjekin në shtëpi](#), duke dokumentuar ngacmimet dhe abuzimet ndaj gazetarëve në internet në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.³

Mundësimi i raportimit të sigurt dhe anonim: Platforma en Defensa de la Libertad de Información (PDLI) në Spanjë krijoi platformën në internet [Observatorio contra el acoso online a mujeres periodistas](#) për të dokumentuar ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj grave gazetare dhe për të tërhequr vëmendjen ndaj këtij problemi.⁴ Gazetarët që vuajnë nga ngacmimet në internet mund të paraqesin një raport anonim në organizatë përmes një formulari në internet.

Kryerja e hulumtimit për të kuptuar dhe adresuar më mirë sfidat: Studimi global [Sulmet dhe ngacmimet: Ndikimi në gratë gazetare dhe raportimi i tyre](#) nga Fondacioni Ndërkombëtar i Mediave të Grave (FNMG) dhe TrollBusters tregon se gati dy të tretat e grave gazetare në një moment janë kërcënuar ose ngacmuar në dhe jashtë internetit.⁵

Raporti i vitit 2019 [Shënjestrimi i lajmëtarit: Gazetarët përballen me një sulm të ngacmimit në internet](#) ofron një pamje të situatës në Evropë bazuar në një shqyrtim të 162 raporteve të abuzimit digjital të paraqitura në Indeksin e projektit Hartimi i Lirisë së Mediave.⁶ Qendra Evropiane për Shtyp dhe Lirinë e Mediave dhe Federata Evropiane e Gazetarëve gjithashtu bashkëpunuan në raport.

Studimi [Mos lexoni komentet: Rritja e sigurisë në internet për të punuar në media](#), nga Gen Vic dhe Media Arts and Entertainment Alliance, shikon ngacmimet në internet të grave gazetare në Australi.⁷

Aleanca Globale për Mediat dhe Gjininë (AGMGJ) përpiloi një koleksion të dokumenteve të politikave në raportin e saj [Vendosja e agjendës gjinore për politikën e komunikimit](#). Publikimi përfshin një kapitull mbi sigurinë e gazetareve në internet.⁸

Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias në Institutin e Universitetit Evropian prodhon [Monitorin e pluralizmit të mediave](#) në një përpjekje për të dokumentuar shëndetin e ekosistemeve të medias dhe kërcënimet ndaj lirisë së medias dhe gazetarëve në Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe disa vende kandidatë.⁹

Observatori Evropian i Gazetarisë në bashkëpunim me universitetet evropiane zhvilluan studimin [Ku gjinden gazetaret në mediat evropiane?](#)¹⁰

Instituti i Mediave Fojo i ka shikuar gjithashtu [aspektet gjinore të punësimit dhe karrierës në sektorin e mediave të Armenisë, Gjeorgjisë, Moldavisë, Ruisë dhe Ukrainës](#).¹¹

Prezantimi i hulumtimit dhe praktikave të dobishme në një platformë të përbashkët: Projekti [Avancimi i barazisë gjinore në industrinë e medias](#) është një bashkëpunim midis universiteteve dhe shoqatave të gazetarëve që bashkërisht mbledhin hulumtime dhe praktika të mira për çështje të ndryshme lidhur me barazinë gjinore në media në Evropë.¹²

Analizimi dhe ngritja e vetëdijes: Në raportin e tij [Ngacmimi në internet i gazetarëve - Sulmi i trollëve](#), Reporterët pa Kufij ka analizuar rastet e sulmeve në internet kundër gazetarëve nga rrjeti i saj në të gjithë botën duke bërë edhe një analizë të rasteve specifike të grave punëtore të medias.¹³

Burime

- [Integrimi i gjinisë në monitorimin e të drejtave të njeriut nga Komisioneri i Lartë i OKB për të Drejtat e Njeriut](#) ofron udhëzime se si të monitorohen shkeljet e të drejtave të njeriut nga perspektiva gjinore.¹⁴
- [Dokumentimi i përfshirjes së perspektivës gjinore: Doracak për dhe rreth mbrojtësve të të drejtave të grave nga Koalicioni Ndërkombëtar Mbrojtja e Grave - Mbrojtja e të Drejtave](#) ofron këshilla të mira rreth mënyrës së integritimit gjinor në punën e dokumentimit të sulmeve kundër grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut.¹⁵

› Të bashkohen forcat për të avancuar zbatimin e standardeve të sigurisë dhe kushteve të tjera të punës për gazetaret në nivel kombëtar

Kur bëhet fjalë për sigurinë e gazetarëve, një nga aspektet më të rëndësishme është zbatimi në nivelin kombëtar i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe angazhimet e tjera të bëra në nivelin ndërkombëtar nga Shtetet. Ndërsa një organizatë e vetme

ka një aftësi të kufizuar për t'i mbajtur qeveritë përgjegjëse, përpjekjet e bashkërenduara nga shumë mund të kenë një ndikim thelbësor. OSHC-të, institucionet arsimore për gazetari dhe organizata të tjera që dëshirojnë të ndikojnë në sektorin e medias duhet të kërkojnë mundësi për të zhvilluar dhe zbatuar strategji të koordinuara për të siguruar që Shtetet të marrin masa për t'i përmbushur detyrimet e tyre lidhur me sigurinë e gazetareve në internet dhe jashtë tij.

Për ta bërë sigurinë e grave gazetare prioritet në sferën ndërkombëtare, shoqëria civile mund të rrisë nivelin e angazhimit në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale ndërqeveritare (shih gjithashtu Kapitullin pesë). Mekanizmat e OKB dhe rajonale për të drejtat e njeriut mund të përdoren në mënyrë më efektive nga OSHC-të dhe organizatat e tjera nëse ato bashkërendojnë angazhimin e tyre në lidhje me ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj grave gazetare në mënyrë më efektive. Ekziston një mundësi e mirë për bashkëpunim, për shembull, rreth parashtresave në procedurat speciale të Këshillit të OKB për të Drejtat e Njeriut, rreth rishikimeve periodike universale dhe gjatë adresimit tek Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave.

Angazhimi në mënyrë efektive në sferën ndërkombëtare, si dhe monitorimi dhe raportimi mbi pajtueshmërinë e Shteteve me angazhimet ndërkombëtare, kërkojnë njohuri të specializuara. OSHC-të ndërkombëtare dhe kombëtare duke e pasur këtë ekspertizë mund të zhvillojnë ose promovojnë punëtori trajnimi mbi standardet ndërkombëtare dhe zotimet e zbatueshme për çështjen e ngacmimit dhe abuzimit me bazë gjinore në internet.

Shembuj

Krijimi i grupeve të punës për çështje gjinore dhe të sigurisë: [Forumi Global për Zhvillimin e Mediave](#), një rrjet ky i grupeve për zhvillimit të mediave, si dhe [Aleanca ACOS](#), koalicioni i mediave dhe grupeve të lirisë së shtypit që promovojnë sigurinë e gazetarëve të pavarur, kanë grupe pune gjinore. Koalicioni Ndërkombëtar i OSHC-ve është një rrjet prej 26 organizatash që bashkërendojnë punën e tyre për sigurinë e gazetarëve dhe bashkojnë forcat për iniciativa të sigurisë së gazetarëve.¹⁶

Bashkimi i forcave dhe kërkimi i përbashkët i mbështetjes financiare: [Reagimi i shpejtë i lirisë së medias për sigurinë e gazetarëve në Bashkimin Evropian](#) është koalicioni i organizatave të lirisë së shprehjes.¹⁷ Koalicioni përgjigjet me mbështetje praktike, ligjore dhe avokuese për gazetarët në rrezik. Ngacmimi në internet ndaj gazetarëve është një nga temat kryesore të tij..

Demistifikimi i standardeve ndërkombëtare: ‘ARTICLE 19’ publikoi [Fundi i mosndëshkimit: Udhëzues për të vepruar në përputhje me standardet e OKB-së për sigurinë e gazetarëve](#) për të lehtësuar të kuptuarit e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi sigurinë e gazetarëve.¹⁸ Për më tepër, për të përmirësuar kapacitetin e anëtarëve të tij për t’u angazhuar me organizatat ndërqeveritare, IFEX, rrjet mbarë botëror i OJQ-ve të lirisë së shprehjes, publikoi një seri [shpjeguesish 5 minutësh](#) mbi përdorimin e disa mekanizmave ndërkombëtarë për të monitoruar zbatimin e standardeve të sigurisë së gazetarëve.¹⁹

Burime

- Seria e publikimeve [Mbrojtja e gazetarisë](#) e Mbështetjes Ndërkombëtare për Mediat vë në pah mësimet e nxjerra nga vendet e ndryshme kur strukturat bashkëpunues – koalicione, partneritete dhe mekanizma të sigurisë – po punojnë për ta promovuar sigurinë e gazetarëve. Seria në fjalë përmban një [raport](#) që përqendrohet ekskluzivisht tek gazetarët.²⁰

› Të zhvillohen trajnime dhe materiale edukuese për mbrojtje tërësore

Organizatat e afërta me gazetarët dhe të afta për t'i identifikuar trendet në internet po e avancojnë trajnimin mbi sigurinë e gazetarëve në mënyrë thelbësore. OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e materialeve trajnuese dhe edukative që mund të forcojnë mbrojtjen e grave gazetare të shënjestruara në internet.

Për shkak të natyrës së ngacmimit dhe abuzimit në internet, është e rëndësishme që trajnimi të sigurojë një qasje tërësore që përfshin aspekte të ndryshme, siç janë të drejtat ligjore dhe nevojat psikosociale, krahas sigurisë digjitale. Trajnimi i grave gazetare se si t'i adresojnë ngacmimet dhe abuzimet me bazë gjinore në internet duhet të jetë një proces fuqizues, i cili ua mundëson grave të shprehen dhe të vazhdojnë në profesionin e tyre.

Për t'i kuptuar të drejtat që i gëzon, është e rëndësishme të kuptosh se çfarë përfshijnë këto të drejta dhe në cilat situata shkelen ato. Me qëllim të rritjes së ndihmës për gratë gazetare që kanë nevojë për mbështetje ligjore, mund të jetë e dobishme për OSHC-të që ta forcojnë punën e tyre

dhe bashkëpunimin me odat e avokatëve dhe avokatët. Duke punuar me institucione të arsimit për gazetari dhe ekspertë ligjorë, grupet e lirisë së shprehjes mund të rrisin edhe kapacitetin e profesionistëve aktualë të medias dhe gazetarëve të brezit të ardhshëm për t'u përballuar me dhe adresuar ngacmimet dhe abuzimet në bazë gjinore.

Shembuj

Video-udhëzime: Instituti Ndërkombëtar i Shtypit (INSH) zhvilloi [video-mësime](#) për gratë gazetare se si t'i adresojnë ngacmimet në internet nga këndvështrimi ligjor dhe psikosocial.²¹

Doracaku për punën në terren: [Doracaku i terrenit për ngacmimet në internet](#) i PEN America për shkrimtarët dhe gazetarët ofron një seri rekomandimesh praktike, që në fokus kanë gjithashtu gratë gazetare.²²

Mbështetja psikosociale: Qendra Dart për Gazetari dhe Traumë ka burime për gazetarët të cilët përjetojnë ose janë në rrezik të përjetimit të traumës. Në blogun e saj, [Pesë mënyra për të mbrojtur veten nga urrejtja kibernetike dhe trollët](#), theksohen mënyrat për t'u mbrojtur nga ndikimi psikosocial i ngacmimit dhe abuzimit në internet.²³

Trajnim mbi sigurinë në internet: Free Press Unlimited krijoi platformën në internet [Totem](#) për kurse të sigurisë digjitale.²⁴ Ai përfshin kursin e krijuar nga IWMF [Know Your Trolls](#), për t'ju ndihmuar gazetarëve që të identifikojnë abuzimin që iu bëhet në internet dhe se kush mund të jetë prapa tij, si dhe ofrojnë disa strategji kryesore për tu përgatitur më mirë për përballimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet.

[Kurrikula Gandersec](#) në internet nga Tactical Tech në Gjermani, është një burim që mbulon mbi 20 tema të vlefshme edhe për gazetarët, siç janë përballja me “gjuhën e urrejtjes”; strategjitë e rezistencës; përdorime kreative të mediave sociale; sovraniteti teknologjik; luftimi i ankthit; çlirimi i stresit fizik; dhe hartimi i informacionit dhe identifikimi i rreziqeve.²⁵

[Akademia e Sigurisë së Medias Orkhan Dzhemal](#), pranë Fondacionit Drejtësi për Gazetarët, ofron kurse trajnimi në internet mbi çështjet e sigurisë së gazetarëve në rusisht.²⁶

Disa OSHC ofrojnë gamë të larmishme kursesh trajnimi për mbrojtjen e gazetarëve, në disa raste me qasje të fortë gjinore dhe adresim të ngacmimeve në internet. Rrjeti Global i Gazetarisë Hulumtuese boton një listë në [faqen e saj](#) të internetit.²⁷

Doracakët për trajnim dhe mbështetja për trajnerët: Grupi Hollaback kundër ngacmimit! ofron trajnim dhe ka botuar disa [doracakë](#) trajnimi. Ai gjithashtu koordinon iniciativën [HeartMob](#) për të promovuar mbështetjen mes kolegëve.²⁸

TrollBusters ka prodhuar infografinë “[A ju ngacmojnë në internet](#)”? për t’i informuar njerëzit se çfarë duhet bërë kur ngacmohen dhe abuzohen në internet.²⁹

› **Të integrohet siguria e gazetarëve dhe barazia gjinore në aktivitetet e edukimit dhe trajnimit për gazetari**

Institucionet arsimore të gazetarisë dhe institucionet e trajnimit të vazhdueshëm janë thelbësore në edukimin e gazetarëve. Prandaj, ato mund

të luajnë një rol të rëndësishëm për të siguruar që studentët të trajnohen për çështje të sigurisë dhe, në veçanti, për ngacmimet dhe abuzimet në internet. Institucionet e trajnimit të vazhdueshëm mund gjithashtu të bëjnë të mundur përditësimin e njohurive të profesionistët aktualë mbi ndikimin e teknologjive të reja, përfshirë ngacmimet dhe abuzimet në internet.

Temat e sigurisë dhe gjinisë mund të jenë fokusi i seminareve dhe punëtorive specifike për të siguruar një forum për debat publik lidhur me rolin e mediave dhe për t'i promovuar praktikave të mira. Për ta pasuruar qasjen e studentëve në këtë lloj dije, institucionet e gazetarisë dhe ato të trajnimit mund të angazhohen me OSHC, gazetarë dhe aktorë të tjerë kryesorë që sjellin mjete të azhurnuara dhe përvojë praktike të sigurisë, në veçanti të grave gazetare.

Shtimi i njohurive është thelbësor për të kuptuar mënyrat më të mira për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet ndaj grave gazetare. Në rolin e tyre kërkimor, institucionet arsimore të gazetarisë mund ta shtojnë punën kërkimore akademike në këtë fushë si dhe të organizojnë konferenca dhe ngjarje akademike.

Bashkëpunimi dhe partneriteti midis akademisë dhe praktikuesve është gjithashtu thelbësor për pasurimin e kërkimit, siç u theksua gjatë takimit pasues të vitit 2017 të Planit të veprimit të OKB për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit.³⁰

Shembuj

Integrimi i sigurisë së gazetarëve në kurrikulë: UNESCO, [Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë në Liban](#) botuan një Kurs model mbi sigurinë e gazetarëve.³¹

UNESCO gjithashtu publikoi Kurrikulën model për arsim në gazetari - Përmbledhje e plan-programit të ri mësimor.³³ Fakulteti i Gazetarisë i Universitetit Shtetëror të Baku në Azerbajxhan krijoi një program mësimor mbi barazinë gjinore dhe lirinë e mediave.³³

Organizimi i trajnimeve specifike: Qendra 'Knight' për Gazetari në Universitetin e Teksasit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës organizon trajnim në internet për çështje që lidhen me sigurinë e gazetarëve.³⁴

Organizimi i konferencave akademike mbi sigurinë e gazetarëve: Janë dy konferenca akademike globale kushtuar sigurisë së gazetarëve. UNESCO e organizon një në vit, paralelisht me Konferencën për Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit.³⁵ Qendra Ndërkombëtare e Gazetarisë dhe Medias në Universitetin Metropolitan të Oslos në Norvegji e organizon tjetrën çdo nëntor.³⁶ Abstraktet mund të shikohen e lexohen në faqet e tyre të internetit.³⁷ Për më tepër, konferenca vjetore e Shoqatës Ndërkombëtare për Kërkim në Media dhe Komunikim përfshin një panel mbi sigurinë e gazetarëve në kuadër të grupit të punës për kërkim dhe edukim në gazetari.³⁸

Avancimi i punës kërkimore akademike mbi sigurinë e gazetarëve: Në vitet e fundit, ka pasur kërkime akademike në rritje për çështje që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe konkretisht për ngacmimet dhe abuzimet në internet. Për shembull, në vitin 2017, si rezultat i Konferencës së parë akademike të UNESCO-s mbi sigurinë e gazetarëve, u botua libri [Sulmi ndaj gazetarisë: Ngritja e njohurive për të mbrojtur lirinë e shprehjes](#), me qëllim të përmbledhjes së punimeve të përzgjedhura të paraqitura.³⁹ UNESCO ka botuar një [Agjendë kërkimore mbi sigurinë e gazetarëve](#) për të promovuar kërkime akademike në këtë fushë.⁴⁰ Revista Media dhe Komunikimi

që është dhe me qasje të hapur publikoi një botim tematik me titull [Rimendimi i sigurisë së gazetarëve](#) duke shfaqur dy artikuj mbi dhunën ndaj grave gazetare në Norvegji dhe Nepal.⁴¹

Rritja e bashkëpunimit në punë kërkimore: Qendra për Lirinë e Medias (QLM) në Universitetin e Sheffield në Mbretërinë e Bashkuar promovoi krijimin e [Rrjetit të Kërkimit të Sigurisë së Gazetarëve](#) për të avancuar bashkëpunimin dhe shkëmbimet midis akademikëve që punojnë në sigurinë e gazetarëve.⁴² Rrjeti ka një faqe të mbyllur në Facebook që shërben për t'i lidhur anëtarët e tij.


Krijimi i hapësirave për studimin e sigurisë së gazetarëve: Në vitin 2018, QLM-së iu dha kryesimi i parë në UNESCO për lirinë e mediave, sigurinë e gazetarisë dhe çështjen e mosndëshkimit.⁴³ Kryesuesi i UNESCO-s për Liri të Shprehjes në Universitetin e Goteborgut në Suedi dhe kryesuesi i UNESCO-s për Komunikim i Universitetit të Malagës në Spanjë gjithashtu janë angazhuar në çështjen e sigurisë së gazetarëve.⁴⁴ Shkolla Annenberg për Komunikim në Universitetin e Pensilvanisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijoi Qendrën për Rrezik të Mediave me qëllim të hulumtimit dhe shtimit të njohurive për gazetarët në rrezik.⁴⁵ Iniciativa “Liria globale e shprehjes” në Universitetin Columbia ka krijuar një bazë të dhënash të praktikës gjyqësore, e cila përfshin raste të sulmeve kundër gazetarëve.⁴⁶

Shënime fundore

- 1 Michelle Ferrier, “Attacks and Harassment: The Impact on Female Journalists and Their Reporting”, International Women’s Media Foundation, TrollBusters, 2018, <https://www.iwmf.org/wp-content/uploads/2018/09/Attacks-and-Harassment.pdf>.
- 2 “1370 Journalists Killed between 1992 and 2020 / Motive Confirmed”, Committee to Protect Journalists (CPJ), https://cpj.org/data/killed/?status=Killed&motiveConfirmed%5B%D=Confirmed&type%5B%D=Journalist&start_year=1992&end_year=2020&group_by=year. Lucy Westcott, “‘The threats follow us home’: Survey details risks for female journalists in U.S., Canada”, CPJ news item, 4 September 2019, <https://cpj.org/2019/09/canada-usa-female-journalist-safety-online-harassment-survey/>.
- 3 Lucy Westcott, “‘The threats follow us home’: Survey details risks for female journalists in U.S., Canada”, CPJ news item, 4 September 2019, <https://cpj.org/2019/09/canada-usa-female-journalist-safety-online-harassment-survey/>.
- 4 “La PDLI lanza el ‘Observatorio contra el acoso online a mujeres periodistas’”, Plataforma en Defensa de la Libertad de Información news item, 2 June 2018, <http://libertadinformacion.cc/la-pdli-lanza-el-observatorio-contra-el-acoso-online-a-mujeres-periodistas/>.
- 5 Op. cit. endnote 1.
- 6 Valeria Costa-Kostritsky, “Targeting the messenger - Journalists face an onslaught of online harassment”, Mapping Media Freedom, 2019, <https://www.indexonensorship.org/wp-content/uploads/2019/01/index-report-online-harassment-webv3.pdf>.
- 7 “Don’t read the comments: Enhancing Online Safety for Women Working in the Media”, Media Entertainment and Arts Alliance, Gender Equity Victoria, 2019, https://www.genvic.org.au/wp-content/uploads/2019/10/GV_MEEA_PolicyDoc_V5_WEB.pdf.
- 8 Julie Posetti and Hannah Storm, “Violence Against Women Journalists - Online and Offline”, GAMAG, 2019, <https://gamag.net/wp-content/uploads/2019/09/Chapter-7.pdf>.
- 9 “Media Pluralism Monitor”, Centre for Media Pluralism and Media Freedom, <https://cmpf.eui.eu/mpm2020-results>.
- 10 European Journalism Observatory, “Where are the women journalists in Europe’s media?”, May 15 2018, <https://en.ejo.ch/research/where-are-all-the-women-journalists-in-europes-media>
- 11 Fojo Media Institute, “Gender aspects of employment and career in the media sector of Armenia, Georgia, Moldova, Russia and Ukraine”, 2020, <https://fojo.se/wp-content/uploads/2020/08/Gender-report-2020-ENG.pdf>.
- 12 Advancing Gender Equality in Media Industries (AGEMI), “A Resources Bank of good practices”, <https://www.agemi-eu.org/mod/page/view.php?id=519>.
- 13 Reporters Without Borders. “Online Harassment of Journalists – Attack of the Trolls”, 2018, https://rsf.org/sites/default/files/rsf_report_on_online_harassment.pdf.
- 14 UN Human Rights, “Integrating Gender into Human Rights Monitoring”, <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/Chapter15-2opp.pdf>.
- 15 Cynthia Rothschild, “Gendering Documentation: A Manual For and About Women Human Rights Defenders”, Women Human Rights Defenders International Coalition, 2015, http://www.ishr.ch/sites/default/files/documents/whrd_ic_gendering_documentation_manual_1_1.pdf.
- 16 The informal network can be reached via the address sojcoalition@lists.riseup.net.
- 17 Media Freedom Rapid Response, <https://www.mfrr.eu>.
- 18 Ending impunity: Guide to acting on UN standards on the safety of journalists, ARTICLE 19 news item, 2 November 2019, <https://www.article19.org/resources/ending-impunity-guide-to-acting-on-un-standards-on-safety-of-journalists/>.
- 19 IFEX 5-minute Explainers, <https://ifex.org/resources/5-minute-explainers/>.
- 20 International Media Support (IMS), “The safety of women journalists: Breaking the cycle of silence and violence”, IMS Defending Journalism book series, October 2019, <https://www.>

mediasupport.org/publication/the-safety-of-women-journalists/.

- 21 "Tutorials", Ontheline Newsrooms, <https://newsrooms-ontheline.ipi.media/tutorials/>.
- 22 "Online Harassment Field Manual", PEN America, <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org>.
- 23 Ginger Gorman, "Five Ways to Protect Yourself Against Cyberhate and Trolls", Dart Center for Journalism and Trauma news item, 26 June 2017, <https://dartcenter.org/resources/five-ways-protect-yourself-against-cyberhate-and-trolls>.
- 24 Totem project, <https://totem-project.org/>
- 25 Gendersec, <https://gendersec.tacticaltech.org>
- 26 Orkhan Dzhemal Media Safety Academy, <https://ifj.academy>
- 27 "Safety and Security", Global Investigative Journalism Network, <https://gijn.org/safety-and-security-organizations/>
- 28 Heart Mobinitiative, "Hollaback!", <https://www.ihollaback.org/>
- 29 Online Pest Control for Journalists, "What to Do? Where to Go? Infographic", TrollBusters, <https://yoursosteam.wordpress.com/what-to-do-infographic/>.
- 30 UNESCO, "Strengthening the Implementation of the UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity", 2017, <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Journalists/OutcomeDocument.pdf>
- 31 Michael Foley, Clare Arthurs, Magda Abu-Fadil, "Model course on safety of journalists: a guide for journalism teachers in the Arab States", 2017, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000248297>
- 32 UNESCO, "Model Curricula for Journalism Education – a Compendium of New Syllabi", 2013, <https://bit.ly/3hJMUU3>
- 33 "Baku State University Journalism Faculty approves curriculum on gender equality and media", Council of Europe, 1 April 2019, <https://bit.ly/2ZXMtjl>.
- 34 Knight Center for Journalism at the University of Texas, <https://knightcenter.utexas.edu/>.
- 35 "World Press Freedom Day Conference 2020" website, UNESCO, <https://en.unesco.org/commemorations/worldpressfreedomday>.
- 36 Journalism and Media International Center, Oslo Metropolitan University, <https://uni.oslomet.no/jmic/>
- 37 "Book of Abstracts 2019", MEKK, Oslo Metropolitan University, <https://uni.oslomet.no/mekkkonferences/safety-of-journalists-digital-safety-2019/book-of-abstracts-2019-conference/>.
- 38 International Association of Media and Communication Research, IAMCR, <https://iamcr.org/>.
- 39 Ulla Carlsson and Reeta Pöyhtäri, "The Assault on Journalism: Building knowledge to protect freedom of expression", Nordicom, 2017, <https://www.nordicom.gu.se/en/publikationer/assault-journalism>.
- 40 UNESCO, Research Agenda on the Safety of Journalists, 2015, https://en.unesco.org/sites/default/files/draft_research_agenda_safety_of_journalists_06_2015.pdf.
- 41 Kristin Skare Orgeret and William Tayeebwa, "Rethinking Safety of Journalists, In Media and Communication", Open Access Journal, Volume 8, Issue 1 2020, <https://www.cogitationpress.com/mediaandcommunication/issue/view/issue/161/PDF161>
- 42 "Journalism Safety Research Network", Centre for Freedom of the Media - University of Sheffield, <http://www.cfom.org.uk/our-networks/journalism-safety-research-network/>
- 43 "UNESCO Chair on Media Freedom, Journalism Safety and the Issue of Impunity", CFOM, University of Sheffield, <http://www.cfom.org.uk/about/unesco-chair-on-media-freedom-journalism-safety-and-the-issue-of-impunity/>.
- 44 For example, the UNESCO Chair on Freedom of Expression at the University of Gothenburg organized, in co-operation with UNESCO, a conference on the safety of journalists in 2016: https://jmg.gu.se/english/current/news/Nyheter_detalj/safety-of-journalists-international-research-conference-paved-the-way-for-academic-research-cooperation.cid1373726.
- 45 Center for Media @Risk, Annenberg School for Communication, University of Pennsylvania, <https://www.ascmediarisk.org/>.
- 46 Global Freedom of Expression Case Law Database, Columbia University, <https://globalfreedomofexpression.columbia.edu/>



Gazetarët dhe punonjësit e mediave

Veprimet e propozuara

1. Të monitorohet dhe vlerësohet peizazhi i rrezikut për gazetaret;
2. Të praktikohet një qasje tërësore ndaj sigurisë, duke përfshirë sigurinë fizike, ligjore, psikosociale dhe atë digjitale;
3. Të dokumentohen dhe raportohen kërcënimet dhe sulmet;
4. Të mbështeten kolegët që përballen me abuzime dhe ngacmime në internet, dhe ata që janë në rrezik më të lartë të përjetojnë sulme të tilla;
5. Informim më i madh mbi format e mundshme të mbështetjes, përfshirë mekanizmat ligjorë

10. Gazetarët dhe punonjësit e mediave

Prioritizimi i vetëmbrojtjes dhe mbështetjes mes kolegëve

Puna e gazetarit vjen me shumë rreziqe. Megjithatë, gratë gazetare përballen me një shtresë shtesë rreziku vetëm për shkak se janë gra. Ngacmimi dhe abuzimi në internet është një shembull i qartë i një sulmi që shënjestron gratë me një ashpërsi më të madhe se burrat.¹ Gazetarët që kanë përjetuar sulme në internet kanë rol kyç në përcaktimin dhe zbatimin e zgjidhjeve gjithëpërfshirëse. Kjo qasje pasqyrohet në [Vendimin nr. 3/18 e Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve](#). Në këtë vendim, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së njohin që koncepti i sigurisë nuk do të thotë vetëm mungesë e dëmtimit fizik, por gjithashtu nënkupton kushte të duhura të punës dhe siguri psikologjike, ligjore dhe digjitale.² Ndërkohë që aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë kanë angazhimet e tyre lidhur me sigurinë e grave gazetare, siç u paraqit në kapitujt e mësipërm, gratë gazetare praktikojnë vetëmbrojtje gjithëpërfshirëse për të parandaluar, zbutur dhe për t'iu përgjigjur sulmeve. Krahas kësaj, të gjithë gazetarët mund të mbështetësin koleget e tyre në parandalimin, zbutjen ose reagimin ndaj abuzimit në internet.

Në Vendimin nr. 3/18 e Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve,⁵⁷ Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e “njohin që puna e gazetarëve mund t’i ballafaqoj ata dhe familjarët e tyre me situata rreziku nga dhuna, si dhe frikësimi e ngacmimi, duke përfshirë edhe përmes teknologjisë digjitale, e që mund t’i zbraps gazetarët nga kryerja e punës së tyre apo t’i shtyjë drejt vet-censurimit.” Krahas kësaj, Shtetet pjesëmarrëse janë “të brengosur nga rreziku i dallueshëm me të cilin ballafaqohen gazetarët që lidhet me punën e tyre, duke përfshirë përmes teknologjive digjitale, dhe duke nënvizuar rëndësinë e garantimit të sigurisë më të lartë të mundshme për ato dhe se përjetimet dhe brengat e gazetarëve të adresohen në mënyrë efektive.”

› Të monitorohet dhe vlerësohet peizazhi i rrezikut për gazetarët

Vlerësimet e rrezikut janë të mirënjohura tashmë si praktikë e mirë në fushën e sigurisë së gazetarëve. Për të siguruar mbrojtje gjithëpërfshirëse, mediat së bashku me gazetarë individuale, duhet të kryejnë vlerësime të rregullta të rrezikut ku përfshihen rreziqe që materializohen si rezultat i profesionit, si dhe rreziqe që lidhen me të qenurit grua, si dhe forma të tjera të identitetit të tyre.

Para se të fillojnë me një detyrë, gazetarët duhet të plotësojnë formularët e vlerësimit të rrezikut të siguruara nga media për të përcaktuar bashkërisht se çfarë masa paraprake mbrojtëse janë të nevojshme për të kryer detyrën në mënyrë të sigurt. Vlerësime të tilla të rrezikut duhet të përshtaten dhe azhurnohen për çdo detyrë.

Më gjerësisht, gazetarët mund të qëndrojnë në hap me hulumtimet mbi ngacmimet dhe abuzimet në internet. Gazetarët që janë më pak të

rrezikuar nga këto lloj sulmesh duhet të zhvillojnë mënyra për t'u bërë aleatë me ata që janë në rrezik më të lartë, për shembull duke u përfshirë në kërkime dhe monitorime. Kjo mënyrë veprimi mbështet promovimin e një kulture pune ku sulmet ndaj grave gazetare, si ngacmimi dhe abuzimi në internet, kuptohen si sulme kundër gazetarisë. Duke iu kundërvënë kështu normalizimit të abuzimit, kjo ua mundëson grave gazetare vlerësimin, gjegjësisht matjen më të mirë të rrezikut, identifikimin e kërcënimeve dhe raportimin e sulmeve.

› **T ale dhe atë digjitale**

Vështrimi tërësor i sigurisë së gazetarëve përfshin sigurinë fizike, sigurinë digjitale dhe kujdesin psikosocial, por dhe kurse trajnimi për njohjen e të drejtave që gëzoni. Për gratë gazetare, kjo duhet të përfshijë në veçanti informacionin dhe zhvillimin profesional mbi mënyrën se si të qëndrojnë të sigurt nëse janë objekt i ngacmimeve dhe abuzimeve me bazë gjinore.

Gazetarët inkurajohen të marrin pjesë në kurse trajnimi për sigurinë, veçanërisht në tema si pikasja e manifestimeve të ngacmimit dhe abuzimit në internet, përdorimi i mjeteve digjitale të sigurisë dhe navigimi i sigurt në internet. Si hap përgatitor, rekomandohet që gazetarët t'i kenë shumë të qarta opsionet në dispozicion sa i përket sigurisë dhe raportimit në platformat e mediave sociale që ato përdorin.

Ngacmimi dhe abuzimi në internet shpeshherë ka natyrë përshkallëzuese, duke filluar nganjëherë me mikro-agresione - me ofendime dhe fyerje më të lehta - e që shpejtë përshkallëzohen në kërcënime të rënda. Ndonëse në dukje jo dhe aq kërcënuese, mikro-agresionet individuale mund të grumbullohen për të krijuar pasoja serioze psikologjike për gazetarët, ose mund të jenë paralajmërim i sulmeve më të dëmshme. Për gazetarët, është e rëndësishme që t'i japin përparësi shëndetit psikosocial duke i

denormalizuar mikro-agresionet, duke mësuar të identifikojnë traumën dhe duke u fuqizuar në ushtrimin e vetëkujdesit.

Mënyra të tjera në të cilat gazetarët mund të kontribuojnë në sigurinë gjithëpërfshirëse të grave gazetare është duke qenë të informuar lidhur me udhëzimet e organizatës mediale për sigurinë në internet, të cilat mund të ndryshojnë herë pas here, dhe duke kërkuar jetësimin e politikave dhe protokolleve për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet, nëse nuk ka të tilla. Ata gjithashtu mund të punojnë me gratë gazetare për të bërë vlerësime të rrezikut dhe për të jetësuar plane sigurie që adresojnë ngacmimet dhe abuzimet në bazë gjinore.

› **Të dokumentohen dhe raportohen kërcënimet dhe sulmet**

Gjatë përjetimit të sulmeve, gratë gazetare duhet të provojnë ta dokumentojnë situatën sapo të ndodhë, nëse ndjehen se mund ta bëjnë këtë dhe, po qe e mundur, ta ndajnë këtë informacion me autoritetin përkatës për përkrahje brenda medias. Kolegët mund të ndihmojnë dhe t'i bëjnë këto veprime, nëse gazetarja nuk është në gjendje ta bëjë atë vet. Gjithashtu, raportet e incidenteve mund të paraqiten zyrtarisht te punëdhënësi, në platformat e mediave sociale dhe organet e zbatimit të ligjit, varësisht nga natyra e agresionit.

Në disa rrethana, ka mundësi që gazetarët të zgjedhin të kundërvihen zëshëm si reagim ndaj një sulmi, qoftë duke folur gjerësisht kundër sulmit apo duke iu drejtuar sulmuesit drejtpërdrejt. Kundërvënja me fjalë mund të jetë një mënyrë e fuqishme për t'i ndaluar ngacmimet dhe abuzimet në internet por, në raste të caktuara, kjo mund të rezultojë në më shumë sulme. Prandaj, një taktikë e tillë duhet të ndërmerret bashkë me një vlerësim të rrezikut. Konsultimi i rrjeteve mbështetëse simotra, redaktorëve dhe/ose

këshilltarëve të sigurisë mund të ndihmojë gjithashtu në përcaktimin nëse kundërvënia me fjalë është mënyra më e mirë e veprimit.

› **Të mbështeten kolegët që përballen me abuzime dhe ngacmime në internet, dhe ata që janë në rrezik më të lartë për të përjetuar sulme të kësaj natyre**

Si kolegë, gazetarët individualë mund të jenë aleatë në luftën kundër ngacmimeve dhe abuzimeve me bazë gjinore. Gazetarët dhe punonjësit e medias mund të ndihmojnë në formësimin e kulturës gjithëpërfshirëse organizative (shih edhe Kapitullin shtatë) për të qenë më mbështetës dhe fuqizues për ata që mund të jenë objekt sulmi, ose për ata brenda grupit me rrezik më të lartë për shkak të identitetit ose punës së tyre.

Gazetarët mund të solidarizohen me gratë gazetare që përjetojnë sulme dhe t’ju ofrojnë siguri dhe mbështetje të menjëhershme. Ata mund të ndihmojnë në krijimin e grupeve për mbështetje të kolegëve, të dokumentojnë abuzimin dhe ngacmimin në internet kundër kolegëve të tyre dhe t’i raportojnë këto sulme përmes kanaleve të ndryshme- me kusht që gazetarja e shënjestruar shfaq dëshirë dhe e pranon atë ndihmë.

Rrjetet e komunitetit mund të ofrojnë mbështetje të menjëhershme për gazetarët që përjetojnë ngacmime dhe abuzime me bazë gjinore. Gazetarët mund të formojnë rrjete për mbështetjen e kolegëve të përbërë nga individë të besuar, siç janë kolegët e tjerë, familjarët dhe miqtë. Rrjeti mund të jetë një vend ku futesh dhe merr mbështetje nëse ndodhin sulme. Gazetarët inkurajohen të shkëmbejnë përvoja dhe këshilla, të punojnë së bashku për të krijuar udhëzues sigurie për kolegët gazetarë dhe për të krijuar aleanca me audiencën e tyre në internet.

› Informim më i madh mbi format e mundshme të mbështetjes, përfshirë mekanizmat ligjorë

Natyrë e ngacmimeve dhe abuzimeve në internet është komplekse dhe e shtresëzuar. Ajo shkel disa fusha të të drejtave të njeriut, të mbrojtura në mënyra të ndryshme përmes legjislacionit kombëtar, trupave rajonale dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Gratë gazetare mund të bëhen të shkathëta për të naviguar në hapësirën në internet dhe rreziqet e shtresëzuara të saj duke u informuar rregullisht për të drejtat e tyre ligjore sipas kornizave të përcaktuara kombëtare dhe ndërkombëtare për barazi gjinore, siguri të gazetareve, liri të shprehjes, komunikime digjitale dhe fusha të tjera përkatëse. Në këtë mënyrë, gazetaret mund t'i identifikojnë mekanizmat e ndryshëm në dispozicion për mbështetje në raste kur përballen me ngacmime dhe abuzime në internet.

Krahas mbrojtjes të mundshme të ofruar nga organet shtetërore dhe ndërqeveritare, gratë gazetare mund të përfitojnë nga njohja me kushtet dhe udhëzimet e komunitetit të platformave në internet që ato përdorin, si dhe politikat përkatëse të punëdhënësve të tyre për punën në internet.

Në raste të caktuara, gratë gazetare mund të marrin në konsideratë përdorimin e organizatave dhe rrjeteve për mbështetje ligjore.

Burime

- TrollBusters ka krijuar grafikonin informativ, [A po të ngacmojnë në internet?](#), ku jepen hollësi rreth veprimeve që gazetaret mund t'i ndër marrin varësisht nga natyra e sulmeve që u bëhen në internet.³

- [Doracak terreni për ngacmimet në internet](#) i PEN America për shkrimtarët dhe gazetarët ofron një sërë rekomandimesh dhe këshillash praktike, në fokus të të cilave janë po ashtu dhe gratë.⁴
- [Video-udhëzimet](#) e përgatitura nga Instituti Ndërkombëtar i Shtypit udhëzojnë gratë gazetare mbi mënyrat se si të adresojnë ngacmimet në internet nga perspektiva ligjore dhe psikosociale.⁵
- [Hollaback!](#) ofron trajnime dhe ka publikuar disa burime me vegla praktike me anë të të cilave gazetarët mund të intervenojnë kur janë objekt i sulmeve.⁶ Ajo lehtëson gjithashtu komunitetet mbështetëse nëpërmjet projektit [HeartMob](#).
- Free Press Unlimited ka krijuar platformën në internet të quajtur [Totem](#) me materiale trajnimi për sigurinë digjitale.⁷ Këtu përfshihet uebinari [Njhi trollët e tu](#), i zhvilluar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Mediat e Grave.
- Tactical tech ka krijuar [XYZ](#), hapësirë kjo e dedikuar për shkëmbimin e veglave praktike për navigim të sigurisë digjitale për gratë.⁸ Kjo kompani ka krijuar po ashtu dhe aplikacionin [Me and My Shadow App Centre](#), koleksion i veglave, aplikacioneve dhe shërbimeve me burime të hapura që shërbejnë për privatësi më të madhe dhe menaxhim të gjurmëve digjitale.⁹
- CHAYN, rrjet global i vullnetarëve që adreson dhunën me bazë gjinore, ka përpiluar [CHAYN DIY](#), një udhëzues për siguri në internet për gratë.¹⁰
- Këshilla dhe vegla për komunikim më të sigurt në internet mund të gjenden në [faqen e internetit Vetëmbrojtja nga përgjimi](#) i Fondacionit të Frontit Elektronik.¹¹

- [Pakoja e ndihmës së parë digjitale](#) e Partneritetit të Mbrojtësve Digjitalë ofron këshilla për mënyrat në të cilat mund të adresohen llojet më të shpeshta të kërcënimeve digjitale.¹²
- Disa organizata ofrojnë mbështetje urgjente dhe ligjore, si edhe specializime për gazetarët që janë cak i sulmeve, siç janë anëtarët e [IFEX](#) dhe grupet që marrin pjesë në [Rrjetin Gazetarët në Vështirësi](#).¹³ Organizatat tjera përfshijnë [Fondin për Liri Digjitale](#), [Qasu Tani](#) dhe [Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe të Medias](#).
- Në Mbretërinë e Bashkuar, [Burimi i dytë](#) u krijua si rrjet profesional i grave gazetare për ta trajtuar ngacmimin në media dhe për të promovuar vetëdijesim rreth të drejtave.¹⁴
- [OnlineSOS](#) fuqizon njerëzit që përballen me ngacmime në internet duke u vënë në dispozicion vegla dhe ndarë ekspertizë e praktika të mira.¹⁵

Shënime fundore

- 1 Mozilla Foundation, “Women journalists feel the brunt of online harassment”, April 2019, <https://internethealthreport.org/2019/women-journalists-feel-the-brunt-of-online-harassment/>.
- 2 OSCE, Ministerial Council Decision No. 3/18, “Safety of Journalists”, 7 December 2018, <https://www.osce.org/chairmanship/406538?download=true>.
- 3 “What to Do? Where to Go? Infographic”, TrollBusters, <https://yoursosteam.wordpress.com/what-to-do-infographic/>.
- 4 “Online Harassment Field Manual”, PEN America, <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>.
- 5 “Tutorials”, On the Line Newsrooms, <https://newsrooms-ontheline.ipi.media/tutorials/>.
- 6 Hollaback!, <https://www.ihollaback.org/>.
- 7 Totem Project, <https://totem-project.org/>.
- 8 XYZ, <https://xyz.informationactivism.org/>.
- 9 “Alternative App Centre”, Me and My Shadow, <https://myshadow.org/resources>.
- 10 “Do it yourself online safety”, <https://chayn.co/safety/>.
- 11 “Tips, Tools and How-tos for Safer Online Communications”, Surveillance Self-Defense, <https://ssd.eff.org/>.
- 12 “Digital First Aid Kit”, Digital Defenders Partnership, <https://www.digitaldefenders.org/digitalfirstaid/>.
- 13 Committee to Protect Journalists, Journalists in Distress (JID) Network, <https://cpj.org/emergency-response/journalists-in-distress-network.php>.
- 14 The Second Source, <http://www.thesecondsource.co.uk>.
- 15 Online SOS, <https://onlinesos.org/>.

Rreth autorëve

Dr. Silvia Chocarro është gazetare dhe avokuese e lirisë së shprehjes. Ajo është udhëheqëse e mbrojtjes në ARTICLE 19. Është anëtare aktuale në Këshillin e IFEX dhe anëtare e organeve të specializuara në Universitetin e Sheffield dhe Universitetin e Evropës Qendrore. Gjatë 20 viteve të fundit, ajo ka punuar për media, grupe të shoqërisë civile dhe organizata ndërqeveritare, si UNESCO ku punoi në hartimin e Planit të veprimit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit. Është autore e disa botimeve mbi gjininë dhe mediat. @silviachocarro

Sarah Clarke është kryesuese e ekipit të Evropës dhe Azisë Qendrore në ARTICLE 19. Ajo është ekspert në 'Columbia Free Expression' dhe anëtare aktuale në Komitetin për Çështje Ligjore të Qendrës Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias. Për gjashtë vjet, ajo udhëhoqi punën për politika dhe avokim të PEN International, duke mbikëqyrur angazhimin e PEN International me OKB dhe mekanizmat rajonale të të drejtave të njeriut. Sarah ka shërbyer si këshilltare për OHCHR, UNHCR, OSBE dhe universitetet e Oksfordit dhe Harvardit për çështje që lidhen me lirinë e shprehjes, azilin dhe migracionin. @sarah_m_clarke

Paulina Gutiérrez është avokate ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, avokate e lirisë së shprehjes dhe e barazisë gjinore. Ajo drejton dikasteret e Hapësirës Qytetare dhe Mbrojtjes në Programin për Ligj dhe Politika në ARTICLE 19, që përfshin çështje të gjuhës së urrejtjes, gjinisë, protestës, dhe mbrojtjes së gazetarëve. Para kësaj, ajo udhëhoqi strategjinë e të drejtave digjitale në ARTICLE 19, Zyrën Rajonale në Meksikë. Përvoja e saj përfshin 12 vjet punë në hulumtimin e politikave të të drejtave të njeriut dhe këshillimin ligjor në shkelje të të drejtave të njeriut në Amerikën Latine. @paulinagtzr

Judy Taing është udhëheqëse për Gjini dhe Seksualitet në ARTICLE 19. Ajo zhvilloi dhe zbaton strategjinë e saj ndërsektoriale gjinore, metodën Mx. Ajo gjithashtu është anëtare e Bordit Këshillëdhënës për ngacmimin në internet të Fondacionit Ndërkombëtar për Gratë në Media. Para se t'i bashkohej ARTICLE 19, ajo punoi në Zyrën e Gjyqtarëve Bashkëhetues në Asistencën e Kombeve të Bashkuara për Gjykimet e Kmerëve të Kuq në Kamboxhia. @judytaing

Shtojca

Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve¹

Këshilli i Ministrave,

Duke i ripohuar të gjitha zotimet relevante të OSBE-së për të drejtën e lirisë së shprehjes, lirisë së mediave, dhe rrjedhës së lirë të informacionit, përfshirë këtu Aktin Final të Helsinkit të vitit 1975, si dhe Dokumentin e Kopenhagës të 1990, ku Shtetet pjesëmarrëse e ripohojnë që e drejta e lirisë së shprehjes përfshin lirinë për opinion, marrjen dhe shpërndarjen e informacioneve dhe ideve pa u penguar nga autoritetet publike dhe pavarësisht kufijve,

Të vetëdijshëm se çdonjëri ka të drejtë në liri të mendimit dhe të shprehjes, në përputhje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, në veçanti neni 19, dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), në veçanti neni 19, dhe se kjo përbën njëri prej bazave themelore të një shoqërie demokratike dhe njëri prej kushteve themelore për zhvillimin dhe progresin e saj,

Të vetëdijshëm gjithashtu se çfarëdo kufizimesh në të drejtën e lirisë së shprehjes mund të realizohen vetëm përmes ligjit dhe kur janë të domosdoshme mbi bazat e përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 19 të PNDCP,

Duke e ripohuar se mediat e pavarura janë esenciale për një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe sisteme llogaridhënese të qeverisjes dhe janë të rëndësishme në veçantë në ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siç thuhet në Dokumentin e Takimit të Moskës të vitit 1991 të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) për Dimensionin Njerëzor,

Duke e pranuar që gazetaria dhe teknologjia kanë evoluuar dhe se kjo i kontribuon debatit publik, ndonëse edhe mund të zgjerojë gamën e rreziqeve që e minojnë sigurinë e gazetarëve,

Duke e marrë në konsideratë rëndësisë e promovimit dhe mbrojtjes së sigurisë së gazetarëve për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Synimeve relevante të Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 të Kombeve të Bashkuara,

Duke e njohur që puna e gazetarëve mund ti ballafaqoj ata dhe familjarët e tyre me situata rreziku nga dhuna, si dhe frikësimi e ngacmimi, duke përfshirë edhe përmes teknologjisë digjitale, e që mund t'i zmbars gazetarët nga kryerja e punës së tyre apo t'i shtyjë drejt vet-censurimit,

Duke e vënë re me shqetësim se përdorimi i masave të papërshtatshme kufizuese kundër gazetarëve mund të ndikojnë në sigurinë e tyre dhe i parandalon ata nga ofrimi i informacioneve për publikun, duke ndikuar rrjedhimisht në mënyrë negative në ushtrimin e së drejtës për liri të shprehjes,

Duke e ripohuar që mediat në territorin e tyre duhet të gëzojnë qasje të pakufizuar në lajme dhe shërbimet e lajmeve të jashtme, se publiku do të gëzojë të liri të ngjashme për të pranuar dhe shpërndarë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike pavarësisht kufijve, duke përfshirë përmes publikimeve të jashtme dhe transmetimit të jashtëm, dhe se çfarëdo kufizimesh në ushtrimin e kësaj të drejte do të parashihen me ligj dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, siç thuhet në Dokumentin e Takimit të Moskës të 1991 të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) për Dimensionin Njerëzor,

Të brengosur se shkeljet dhe abuzimet e së drejtës për të qenë të lirë nga ndërhyrja e arbitrare dhe e paligjshme në privatësi mund të ndikojë në sigurinë e gazetarëve,

Thellësisht të brengosur nga të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut dhe abuzimet e kryera lidhur me sigurinë e gazetarëve, duke përfshirë ato ku përfshihet vrasja, tortura, zhdukjet e detyrueshme, arrestimet arbitrare, paraburgimet arbitrare dhe dëbimet arbitrare, frikësimet, ngacmimet dhe kërcënimet e të gjitha llojeve, si ato fizike, ligjore, politike, teknologjike apo ekonomike, me qëllim shtypjen e punës së tyre,

Të brengosur nga rreziku i dallueshëm me të cilin ballafaqohen gazetarët që lidhet me punën e tyre, duke përfshirë përmes teknologjive digjitale, dhe duke nënvizuar rëndësinë e garantimit të sigurisë më të lartë të mundshme për ato dhe se përjetimet dhe brengat e gazetarëve të adresohen në mënyrë efektive,

Duke e njohur rolin jetik të gazetarëve në mbulimin e zgjedhjeve, në veçanti informimin e publikut për kandidatët, platformat e tyre dhe debatet vazhduese, si dhe duke shprehur shqetësimin serioz për kërcënimet dhe sulmet e dhunshme me të cilat mund të ballafaqohen gazetarët në këtë kuptim,

Duke e njohur rëndësinë e gazetarisë hulumtuese dhe se aftësia e medias për të hulumtuar dhe për t'i publikuar rezultatet e hulumtimit, duke përfshirë në internet, pa frikë nga hakmarrja mund të luaj rol të rëndësishëm në shoqëritë tona, duke përfshirë llogaridhënie të institucioneve publike dhe zyrtarëve,

Të alarmuar me shtimin e fushatave shënjestruese që minojnë punën e gazetarëve, duke e prishur besimin e publikut në kredibilitetin

e gazetarisë, e duke e kuptuar se kjo mund të shtojë rrezikun e kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve,

Gjithashtu të alarmuar nga rastet ku udhëheqësit politikë, zyrtarët publikë dhe/ose autoritetet i frikësojnë, kërcënojnë, lejojnë apo dështojnë t'i dënojnë aktet e dhunës ndaj gazetarëve,

Duke shprehur shqetësimin e thellë ndaj kërcënimit në rritje të sigurisë së gazetarëve të shkaktuar, mesë tjerash, nga grupet terroriste dhe organizatat kriminale,

Duke e theksuar edhe rrezikun e veçantë sa i përket sigurisë së gazetarëve në epokën digjitale, duke e përfshirë këtu cenueshmërinë e veçantë të gazetarëve për t'u shndërruar në caqe sulmi të hakerëve ose vëzhgimit apo përgjimit të paligjshëm dhe arbitrar, duke e minuar të drejtën e tyre për liri të shprehjes dhe të drejtën e tyre për të qenë të lirë nga ndërhyrjet arbitrare dhe të paligjshme në privatësi,

Duke e përsëritur që Shtetet pjesëmarrëse i dënojnë të gjitha sulmet dhe ngacmimet ndaj gazetarëve dhe se do të angazhohen që t'i mbajnë përgjegjës të gjithë ata që janë përgjegjës për sulme dhe ngacmime të tilla, siç thuhet në Samitin e Budapestit të KSBE-së në 1994, dhe gjithashtu duke e njohur që përgjegjësia për krime kundër gazetarëve është element kyç për parandalimin e sulmeve të ardhshme,

Duke e theksuar rëndësinë e përkujtimit të 2 nëntorit si Dita Ndërkombëtare për Përfundimin e Mosndëshkueshmërisë për Krimet kundër Gazetarëve (IDEI) të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara,

Duke vënë re me shqetësim klimën e mosndëshkueshmërisë që

mbizotëron kur sulmet e dhunshme të kryera kundër gazetarëve mbesin pa u ndëshkuar, dhe duke e njohur rolin e qeverive, ligjvënësve dhe gjyqësorit në mundësimin e një mjedisi të sigurt të punës dhe sigurimin e sigurisë së gazetarëve, mes tjerash, duke dënuar publikisht dhe duke i sjellë para drejtësisë të gjithë ata që janë përgjegjës për krime kundër gazetarëve,

Duke rikujtuar rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1738 (2006) dhe 2222 (2015), të cilat dënojnë të gjitha shkeljet dhe abuzimet kundër gazetarëve, profesionistëve të mediave dhe personelit gjegjës në situata të konfliktit të armatosur, e të cilat theksojnë se gazetarët, profesionistët e mediave dhe personeli gjegjës të angazhuar në misione të rrezikshme profesionale në zona të konfliktit të armatosur do të konsiderohen si civilë dhe do të mbrohen si të tillë, me kusht që nuk ndërmarrin kurrfarë veprimesh që ndikon negativisht në statusin që e gëzojnë si civilë,

I bën thirrje shteteve pjesëmarrëse të:

1. Zbatojnë plotësisht zotimet e OSBE-së dhe obligimet e tyre ndërkombëtare lidhur me lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave, duke përfshirë përmes respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së lirisë për të kërkuar, pranuar dhe shpërndarë informacione pavarësisht kufijve;
2. Bëjnë ligjet, politikat dhe praktikat e tyre që lidhen me lirinë e mediave në përputhshmëri të plotë me obligimet dhe zotimet e tyre ndërkombëtare dhe t'i rishikojnë, e sipas nevojës, shfuqizojnë apo ndryshojnë ato ashtu që të mos kufizojnë mundësitë e gazetarëve për të kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje të panevojshme;

3. Dënojnë publikisht dhe pa mëdyshje të gjitha sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve, si vrasjet, tortura, zhdukja me forcë, arrestimi arbitrar, ndalimi arbitrar dhe dëbimi arbitrar, frikësimi, ngacmimi dhe kërcënimet të të gjitha formave, të tilla si fizike, ligjore, politike, teknologjike apo ekonomike, që përdoren për të shtypur punën e tyre dhe/ose detyruar mbylljen e zyrave të tyre, përfshirë në situata konflikti;
4. Dënojnë gjithashtu publikisht e pa mëdyshje sulmet ndaj gazetarëve në lidhje me punën e tyre, siç janë ngacmimi seksual, abuzimi, frikësimi, kërcënimet dhe dhuna, përfshirë përmes teknologjive digjitale;
5. Kërkojnë lirim të menjëhershëm dhe të pakushtëzuar të të gjithë gazetarëve që janë arrestuar ose mbahen në mënyrë arbitrare, që janë marr peng ose që janë viktimë e zhdukjes me forcë;
6. Ndërmarrin masa efektive për t'i dhënë fund mosndëshkimit për krimet e kryera kundër gazetarëve, duke siguruar llogaridhënien si një element kryesor në parandalimin e sulmeve në të ardhmen, përfshirë këtu duke siguruar që agjencitë e zbatimit të ligjit të kryejnë hetime të shpejta, efektive dhe të paanshme për akte dhune dhe kërcënime ndaj gazetarëve, në mënyrë që t'i sjellin para drejtësisë të gjithë ata që janë përgjegjës dhe të sigurojnë që viktimat të kenë qasje në mjete të përshtatshme juridike;
7. Inkurajojnë liderët politikë, zyrtarët publikë dhe/ose autoritetet që të përmbahen nga frikësimi, kërcënimet ose heshtja dhe të dënojnë pa mëdyshje dhunën ndaj gazetarëve, në mënyrë që të zvogëlojnë rreziqet ose kërcënimet me të cilat gazetarët mund të përballen dhe të shmangin dëmtimin e besimit në kredibilitetin e gazetarëve, si

dhe të respektit për rëndësinë e gazetarisë së pavarur;

8. Përbahen nga ndërhyrjet arbitrare ose të paligjshme në përdorimin nga gazetarët të teknologjive koduese dhe anonimitetit dhe të përbahen nga përdorimi i teknikave të paligjshme ose arbitrare të vëzhgimit, duke vërejtur se akte të tilla cenojnë gëzimin e të drejtave të njeriut të gazetarëve dhe mund t'i vendosin ata në rrezik të mundshëm të dhunës dhe kërcënimeve për sigurinë e tyre
9. Inkurajojnë organet shtetërore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit që të përfshihen në aktivitete të vetëdijesimit dhe trajnimit në lidhje me nevojën për të siguruar sigurinë e gazetarëve, dhe të promovojnë përfshirjen e shoqërisë civile në aktivitete të tilla, kur është e përshtatshme;
10. Themelohet ose forcohet, kur është e mundur, mbledhja, analiza dhe raportimi kombëtar i të dhënave për sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve;
11. Sigurojnë që ligjet për shpifje nuk përmbajnë sanksione ose ndëshkime të tepruara që mund të dëmtojnë sigurinë e gazetarëve dhe/ose censurojnë në mënyrë efektive gazetarët dhe ndërhyjnë në misionin e tyre për të informuar publikun dhe, kur është e nevojshme, të rishikojnë dhe shfuqizojnë ligje të tilla, në përputhje me detyrimet e shteteve pjesëmarrëse sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
12. Zbatojnë me efektivitet kornizën ligjore në fuqi për mbrojtjen e gazetarëve dhe të gjitha zotimet relevante të OSBE-së;

13. Bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin e OSBE-së për Liri të Mediave, duke përfshirë këtu çështjen e sigurisë së gazetarëve;
14. Inkurajojnë avokimin e vazhdueshëm dhe promovimin e sigurisë së gazetarëve të përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias në përputhje me mandatin e tij/saj.

Shënime fundore

1 Këshilli i Ministrave i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 7 dhjetor 2018, <https://www.osce.org/chairmanship/406538>.



Ngacmimi dhe abuzimi në internet ndaj grave gazetare është shndërruar në rrezik të madh për profesionin. Rrezik ky që kërcënon aftësinë e grave gazetare për të kryer punën e tyre. Shkel të drejtën e tyre për liri të shprehjes aq sa pengon qasjen e lirë dhe të hapur në informacion për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Ky udhëzues burimesh #SOFJO formulon një përgjigje për këtë kërcënim. Ai synon të ndihmojë shtetet dhe aktorët jo-shtetërorë në të gjithë rajonin e OSBE-së në ndërmarrjen e veprimeve reale për të përmirësuar sigurinë e gazetareve në internet. Praktikata e paraqitura janë të gjithë shembuj të mënyrave se si mund të realizohen standardet dhe zotimet ndërkombëtare.

Ky udhëzues burimesh #SOFJO u ofron aktorëve kryesorë një përzgjedhje të shkurtër të hapave më të rëndësishëm dhe të arritshëm. Së bashku, këto hapa formojnë një strukturë të ndërlidhur në të cilën gazetaret mund të ushtrojnë profesionin e tyre në internet në një mënyrë më të sigurt.

Fatkeqësisht, s'ka asgjë virtuale sa i përket kësaj forme ngacmimi dhe abuzimi. Është një problem real që kërkon zgjidhje reale.

Është koha për të vepruar ashtu siç flasim